



## Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit për periudhën 2022-2031



Maj 2022, Shkup

Projekti: "Arritja e mbrojtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efikas me zonat e mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës", financuar nga Fondi Global për Mjedisin (GEF), dhe zbatuar nga Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara (UNEP), Zyra Rajonale Vjenë dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në Maqedoninë e Veriut si partneri dhe përfituesi kryesor.

## Tabela e Përmbajtjes

<b>1. Përmbledhje ekzekutive</b> .....	<b>9</b>
<b>2. Hyrje</b> .....	<b>17</b>
2.1. Sfondi Ligjor .....	18
2.1.1. Legjislacioni Kombëtar .....	18
2.1.2. Ligji për Shpalljen e Maleve të Sharrit Park Kombëtar .....	18
2.1.3. Marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse .....	18
2.2. Parathënie .....	19
<b>3. Përshkrimi i zonës</b> .....	<b>20</b>
3.1. Informacioni i iërgjithshëm .....	20
3.1.1. Vendodhja gjeografike dhe kufijtë administrativë .....	20
3.1.2. Pronësia mbi tokën .....	21
3.2. Mjedisi jetësor .....	22
3.2.1. Gjeologjia dhe geomorfologjia.....	22
3.2.2. Hidrologjia.....	22
3.2.3. Klima .....	23
3.2.4. Dheu .....	23
3.2.5. Erozioni .....	23
3.2.6. Fauna.....	23
3.2.7. Flora .....	24
3.2.8. Habitatet .....	24
3.2.9. Ekosistemet.....	24
3.2.10. Peizazhet .....	25
3.3. Karakteristikat socio-ekonomike .....	26
3.3.1. Komunitetet dhe popullsitë lokale .....	26
3.3.2. Përdorimi i tokës .....	27
3.3.3. Infrastruktura dhe zhvillimi.....	32
3.3.4. Trashëgimia kulturore.....	35
3.3.5. Rekreacioni dhe turizmi .....	36
3.4. Vlerat e zonës.....	41
3.4.1. Llojet.....	41
3.4.2. Habitatet .....	66
3.4.3. Peizazhet dhe gjeologjia .....	67
3.5. Kërcënimet.....	67
3.6. Efektshmëria dhe efikasiteti i menaxhimit dhe kapacitetet menaxhuese .....	73

<b>4. Strategjia .....</b>	<b>74</b>
4.1. Vizioni.....	74
4.2. Objektivat.....	74
4.3. Kufijtë dhe zonimi .....	75
4.3.1. Kufijtë e jashtëm të propozuar të zonës së mbrojtur .....	75
4.3.2. Kufijtë e propozuar të zonimit të zonës së mbrojtur.....	78
4.3.3. Përcaktimet e Zonës, veprimtaritë e lejuara dhe të kufizuara .....	87
4.3.4. Kategorizimi i zonës me justifikimin .....	91
4.4. Programet e Menaxhimit.....	94
4.4.1. Ruajtja dhe monitorimi i trashëgimisë natyrore.....	94
4.4.2. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.....	95
4.4.3. Menaxhimi i habitateve dhe ekosistemeve.....	96
4.4.4. Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore.....	98
4.4.5. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm.....	99
4.4.6. Zhvillimi Lokal.....	100
4.4.7. Informimi, rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi.....	101
4.4.8. Qeverisja, menaxhimi, organizimi i punës dhe financimi .....	102
<b>5. Plani operativ.....</b>	<b>104</b>
5.1. Ruajtja dhe monitorimi i trashëgimisë natyrore.....	105
5.1.1. Objektivat për trashëgiminë natyrore .....	105
5.1.2. Hartëzimi i llojeve kryesore .....	105
5.1.3. Masat mbrojtëse për llojet .....	107
5.1.4. Monitorimi i llojeve Kryesore.....	108
5.1.5. Kërkimi shkencor për vlera natyrore .....	112
5.1.6. Shkenca Qytetare/e Komunitetit për Monitorim .....	113
5.1.7. Vlerësimi i masave mbrojtëse për llojet dhe peizazhet .....	113
5.2. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.....	114
5.2.1. Përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve.....	115
5.2.2. Përdorimi i qëndrueshëm i kullotave malore .....	116
5.2.3. Përdorimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore në fshatrat përreth .....	119
5.2.4. Përdoimi i qëndrueshëm i bimëve dhe frutave të malit.....	120
5.2.5. Menaxhimi i qëndrueshëm i natyrës së egër .....	122
5.2.6. Përdorimi i qëndrueshëm i ujërave .....	123
5.2.7. Krijimi i Sistemit të Mbrojtjes së Pyjeve nga Zjarri .....	125
5.3. Menaxhimi i habitateve dhe ekosistemeve.....	126

5.3.1.	Hartëzimi i habitateve.....	126
5.3.2.	Masat e menaxhimit të habitatit në bazë të qëllimeve të mbrojtjes .....	127
5.3.3.	Monitorimi i habitateve .....	129
5.3.4.	Menaxhimi i të dhënave për vlerat natyrore.....	131
5.3.5.	Vlerësimi i masave mbrojtëse për habitatet .....	134
5.4.	Menaxhimi i trashëgimisë kulturore.....	134
5.4.1.	Masat për mirëmbajtjen e peizazheve tipike .....	134
5.4.2.	Masat për mirëmbajtjen e vlerave kulturore .....	135
5.5.	Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm.....	136
5.5.1.	Zhvillimi i strategjisë turistike të PK të Sharrit.....	136
5.5.2.	Sistemi i bashkëpunimit me aktorët lokalë dhe sektorin e turizmit.....	138
5.5.3.	Krijimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës për vizitorët.....	141
5.5.4.	Sistemi i menaxhimit të vizitorëve.....	144
5.6.	Zhvillimi lokal .....	147
5.6.1.	Struktura për financimin e zhvillimit Lokal .....	147
5.6.2.	Mirëmbajtja dhe përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të përbashkëta 150	
5.6.3.	Mirëmbajtja dhe përshtatja e arkitekturës tradicionale .....	152
5.6.4.	Raportimi dhe monitorimi i urbanizimit .....	153
5.7.	Informacioni, rritja e ndërgjegjësimit publik dhe edukimi .....	154
5.7.1.	Zhvillimi i infrastrukturës për edukimin mjedisor.....	154
5.7.2.	Programi i komunikimit duke përfshirë veprimtaritë në mediat sociale .....	155
5.7.3.	Programe edukative për grupe të ndryshme të targetuara .....	156
5.8.	Pogrami i qeverisjes, menaxhimit, organizimit të punës dhe programi i financimit 158	
5.8.1.	Forcimi Institucional i zonës së mbrojtur.....	158
5.8.2.	Programi i Drejtimit .....	159
5.8.3.	Programi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.....	160
5.8.4.	Menaxhimi Financiar.....	162
5.8.5.	Raportimi Administrativ dhe Dokumentacioni.....	163
5.8.6.	Komunikimi dhe Bashkëpunimi .....	164
<b>6.</b>	<b>Menaxhimi dhe Qeverisja .....</b>	<b>167</b>
6.1.	Plani për menaxhimin dhe qeverisjen .....	167
6.1.1.	Struktura menaxhuese.....	167
6.1.2.	Mekanizmat dhe procedurat për pjesëmarrjen e aktorëve të përfshirë .....	169
6.1.3.	Administrimi i planit të menaxhimit .....	174

6.2.	Plani për burimet njerëzore dhe burime të tjera .....	174
6.2.1.	Burimet njerëzore .....	174
6.2.2.	Pajisjet dhe infrastruktura .....	180
6.2.3.	Fondet dhe plani i financimit për zbatimin e planit të menaxhimit .....	182
6.3.	Programi vjetor për mbrojtjen e natyrës .....	183
6.4.	Përgatitja e planit vijues të menaxhimit .....	183
<b>7.</b>	<b>Dokumentacioni / Shtojca .....</b>	<b>184</b>
7.1.	Pamjet në hartë në formatin GIS .....	184
7.2.	Referencat .....	184
7.3.	Lista e hidrocentraleve të vogla (statusi Janar 2021) .....	184
7.4.	Vlerësimi METT4 .....	184

## Shkurtesat

KDB	Konventa për Diversitetin Biologjik
SHE	Shërbimet e ekosistemit
BE	Bashkimi Evropian
BE IPA	Instrumenti për ndihmë para aderuese i BE-së
GEF	Fondi global për mjedis jetësor
GIZ	Shoqeria gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar
HD	Direktiva e BE-së për habitatet
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
METT	Mjeti për Gjurmimin e Efektshmërisë së Menaxhimit
MMJPH	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
PM	Plani i Menaxhimit
MTL	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve
PK	Parku kombëtar
ZM	Zonë e Mbrojtur
NP	Ndërmarrje publike
PONT	Fondi për mbrojtje të mjedisit
IP	Institucioni Publik
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
SIDA	Agjencioni suedez për zhvillim dhe bashkëpunim
PKMSH	Parku Kombëtar i Maleve të Sharrit
UNDP	Programi i zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
UNEP	Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencioni për zhvillim ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara

**Citimi i rekomanduar:** Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Malit të Sharr për periudhën 2022-2031. Zyra Rajonale e IUCN-it për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (ECARO): Beograd, Serbi. Projekti i GEF/UNEP: "Arritja e mbrojtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efikas me zonat e mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës".

Autorë: Daniel Bogner, Anela Stavreska-Panajotova dhe Gjorgji Gjorgjevski.

Foto e kopertinës: Daniel Bogner

## Falënderime

Ky Plan i Menaxhimit bazohet në përvojën dhe punën e shumë se 70 ekspertëve të cilët u ngarkuan me përgatitjen e Studimit për Valorizimin dhe Studimin Socio-ekonomik për Malin Sharr. Këto dy studime ofrojnë informacione më të detajuara për faktet dhe vlerat natyrore dhe socio-ekonomike të këtyre zonave .

Gjatë procesit të përpunimit të këtij Plani të Menaxhimit, aktorë të shumtë të përfshirë nga sektorë të ndryshëm dhanë kontributin e tyre në hartimin e programeve dhe veprimtarive gjatë takimeve konsultative që u mbajtën personalisht dhe online.

Ne i shprehim mirënjohjen Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Maqedonisë së Veriut, Sektorit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Drejtorisë të Mjedisit Jetësor për përfshirjen dhe mbështetjen e tyre gjatë procesit.

Ky Plan i Menaxhimit u zhvillua si pjesë e projektit “Arritja e mbrojtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efikas me zonat e mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës”, financuar nga Qendra Globale për Mejdisin (GEF) dhe zbatuar nga Zyra Rajonale në Vienë për Programin për Mjedisin të Kombeve të Bashkuara (UNEP), që i vjen në ndihmë vendit për të pasur politika dhe praktika mjedisore të shëndosha. Zyra Rajonale për Evropën Lindore dhe Azinë Qëndrore e IUCN-it (ECARO) u angazhua për të bashkërenduar procesin e zhvillimit të Planit të Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit, në bazë të standardeve globale për zonat e mbrojtura dhe praktikave më të mira.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin UNEP është agjencia kryesore ekzekutive dhe zbatuese dhe ndihmon vendin që të ketë politika dhe praktika të qëndrueshme mjedisore.

Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës IUCN si partner lokal ka mbështetur koordinimin e këtij aktiviteti të veçantë të projektit dhe ka kontribuar në bazën e njohurive në lidhje me ruajtjen e natyrës dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Tabela e mëposhtme paraqet njerëzit të cilët kontribuan në mënyrë aktive në hartimin e PM-së:

Emri	Institucioni
Naser Nuredini	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Hisen Xhemali	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Ilber Mirta	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Frosina Antonovska	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Dragana Cherepnalkovska	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Arsim Fidani	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Melita Gocevska	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Ibrahim Dehari (Drejtor)	IP Parku Kombëtar i Maleve të Sharrit
Zoran Pavlov	Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore
Sasha Jovanovic	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave
Vojo Gogovski	Ministria Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave
Mare Basova	Ndërmarrja Publike e Pyjeve Kombëtare (NPPK)
Julijana Nikolova	Ndërmarrja Publike e Pyjeve Kombëtare (NPPK)
Tatjana Milcevska	NP Menaxhimi i Kullotave
Nefrus Celiku	NP menaxhimi i Kullotave
Pane Simic	NPPK Tetovë

**Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit për periudhën 2022-2031**

<b>Emri</b>	<b>Institucioni</b>
Milorad Andrijeviski (Drejtor)	NPPK Gostivar
Bajram Kafexholli (Drejtor)	PK Sharri, Kosovë
Bekim Bytyqi	PK Sharri, Kosovë
Maja Zendelska	Delegacioni i BE-së në Shkup
Steffen Hudolin	Delegacioni i BE-së në Shkup
Teuta Arifi	Komuna e Tetovës
Isen Shabani (Kryetar Komune)	Komuna e Vrapçishtit
Bari Ebibi	Komuna e Vrapçishtit
Ibrahim Mamuti	Komuna e Vrapçishtit
Isen Asani (Kryetar Komune)	Komuna e Tearcës
Saladin Zeqiri	Komuna e Tearcës
Besim Imeri	Komuna e Tearcës
Zoran Josifoski	AD ESM
Adem Avziu (Drejtor)	ELEM TURS
Vladimir Krpac	Instituti për Ekologjinë dhe Teknologjinë, Universiteti i Tetovës
Slavco Hristovski	Instituti për Biologjinë, Universiteti i Shkupit
Vladimir Dzabirski	Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimore, Universiteti i Shkupit
Ivan Blinkov	Fakulteti i Shkencave Pyjore, Universiteti i Shkupit
Ana Colovic	Ekosvest
Metodija Veleviski	SHEM (Shoqata Ekologjike e Maqedonisë)
Bogoljub Sterijovski	SHEM
Vasko Avukatov	SHEM
Frosina Pandurska-Dramikjanin	SHEM
Daniela Jovanovska	SHEM
Muhamet Jashari	Veshalla
Zoran Zoksimovski	Gorno Jelovce
Vullnet Adili	Brodec
Amir Hebibi	Vejce
Metodi Chilimanov	SharOutdoor
Mihail Solakov	SharOutdoor
Hashim Hasani	Hotel Scardus
Hajrullah Hasani	Hotel Scardus
Konstantin Gospodinov	IUCN
Pietro Sandini	IUCN
Fjolla Halili	UNEP
Evgenija Jordanovska Nechkovski	UNEP
Iskra Stojanova	UNEP



## 1. Përmbledhje ekzekutive

Malet e Sharrit janë një rajon i rëndësishëm i biodiversitetit Evropian dhe një zonë me vlera të jashtëzakonshme natyrore në zonën kufitare të Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës. Në anën e Kosovës, një Park Kombëtar është shpallur më shumë se një dekadë më parë, ndërsa në anën maqedonase, ka pasur iniciativa të shumta për mbrojtje të Maleve gjatë dekadave të fundit.

Iniciativa e fundit dhe e suksesshme u ndërmorr përmes projektit të financuar nga GEF "Arritja e mbrojtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efikas me zonat e mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës", të zbatuar nga UNEP, me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Maqedonisë së Veriut si partneri dhe përfituesi kryesor. Mbi 70 ekspertë kombëtarë u përfshinë në zhvillimin e Studimit për Valorizimin, si dokumenti kryesor për procesin e shpalljes. Pas procesit të konsultimit gjithëpërfshirës me aktorët, dhe me mbështetjen shtesë të ofruar nga ekspertët ndërkombëtarë, propozimi për Parkun Kombëtar ka arritur konsensusin me votimin njëzëri të Kuvendit Kombëtar për shpalljen e Parkut Kombëtar të Maleve të Sharrit më 30 qershor, 2021. Iniciativa është ndër më të fundit për t'i ofruar botës një zonë të re të mbrojtur prej 62 705 ha duke ndjekur kriteret e IUCN-it të kategorisë II, park kombëtar, me më shumë se 75% të këtij territori në mbrojtje të lartë. Ky Plan Menaxhimi është hartuar në bazë të fushëveprimit të të njëjtit projekt GEF/UNEP/MMJPH, me mbështetjen e ekspertëve të IUCN-it.

Zonat e mbrojtura ditët e sotme përballen me sfidën për të bërë më shumë sesa vetëm të ruajnë vlerat natyrore. Ato kanë detyrën për të përmirësuar mirëqenien e njeriut dhe të sigurojnë përfitime ekonomike përgjatë sektorëve të shumëfishtë, veçanërisht në zonat e mbrojtura me shumë fshatra malore, të tilla si Parku Kombëtar i Maleve të Sharrit. Për të përmbushur një mision kaq ambicioz, Institucioni i ri publik i sapokrijuar i Parkut Kombëtar të Sharrit po përballlet me një detyrë me përgjegjësi për të përmbyllur procesin për miratimin e këtij projekt-plani të menaxhimit. Madje më e rëndësishme është të sigurohet se plani i menaxhimit do të zbatohet me sukses në periudhën 2022 - 2031.

Plani i menaxhimit është një mjet për menaxhimin e parkut kombëtar për të përmbushur nevojat e ndryshme në zonë ndërsa ndjek detyrimet vijuese ligjore. Ky dokument është hartuar me anë të një qasjeje ndër-disiplinore, duke sjellë së bashku ekspertë dhe palë të interesuara për të diskutuar menaxhimin e ardhshëm të zonës së mbrojtur dhe është zhvilluar përmes një procesi të gjerë konsultimi me synimin për të siguruar përvetësimin e tij ndër radhët e autoritet menaxhues dhe aktorëve të tjerë.

Plani për menaxhim i ndjek udhëzimet të dhëna në Rregulloren për përmbajtjen e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe programet vjetore për mbrojtjen e natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 67/04). Malet e Sharrit janë një masiv i gjerë e i lartë i cili shtrihet përgjatë një territori në veri-perëndim të Maqedonisë së Veriut dhe në jug të Kosovës me një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 2500 kilometra katrorë. Zona karakterizohet nga një numër i madh majash mbi 2000 m lartësi me një diversitet të pasur gjeologjik dhe është formuar përmes proceseve glaciale dhe fluviale.

Brenda kufijve të Parkut Kombëtar të Maleve të Sharrit gjenden 27 fshatra të cilat në shumë raste kanë popullsi në rënie dhe infrastruktura të varfër. Në aspektin administrativ parku kombëtar ndodhet në shtatë komuna: Jegunovcë, Tearcë, Tetovë, Bogovinjë, Vrapçishtë, Gostivar, Mavrovë dhe Rostushë. Pjesa më e madhe e tokës është pronë shtetërore.

Fauna në malet e Sharrit është e pasur me të gjitha llojet e grupeve taksonomike. Në zonat e habitateve të ujërave të ëmbla janë konfirmuar 5 lloje peshqish, 11 amfibë dhe 17 zvarranikë. Shpendët janë klasa më e dendur e vertebrorëve të zonës, të përfaqësuar nga 128 lloje. Në veçanti, shpendë të ndryshëm grabitqarë gjenden: shqiponja e malit, shkaba kokëbardhë, kali i qyqes, skifteri dhe fajkoi. 51 lloje gjitarësh janë të pranishëm, duke përfshirë ariun e murrmë, rrëqebullin e Ballkanit, macen e egër, lundëzën, derrin e egër, dhinë e egër, kaprollin, ujkun, dhelprën e kuqe, vjedullën dhe llojet e kunadheve.

Aktualisht në zonën e parkut kombëtar njihen 662 lloje të njëqelizorëve (diatomeve), 1,260 lloje të bimëve vaskulare, më shumë se 260 lloje myshqesh, 500 kërpudha dhe 160 likene.

Llojet mbizotëruese në pyjet e zonës janë ahu, shkoza dhe lisi, të shoqëruar nga bredhi i butë, selvia, pisha, bredhi, verri dhe shelgu. Komunitetet e pranishme jo-pyjore janë: zonat alpine dhe boreale, kullotat oromezike acidofilike, kullota të lagështa, zona torfike alkaline, lëndina me luleborë dhe breza kodrinorë dhe alpinë, livadhe gëlqerore alpine dhe subalpine, thepa me gurë silici me bimësi kazmofite dhe livadhe silici alpine dhe të ftohta malore. Habitatet ligatinore të zonës janë: ujërat e qëndrueshëm, ujërat e rrjedhshëm sipërfaqësorë, zona litorale me trupa ujqorë në sipërfaqen tokësore, livadhe torfike, lloje të ndryshme të torfës moçalore.

Peizazhet e Maleve të Sharrit marrin trajtën sipas gjeologjisë, proceseve fluviale dhe glaciale dhe ndikimit të njeriut përgjatë shekujve. Traditat e ndryshme dhe prejardhjet etnike dhe kulturore të popullsisë lokale kanë kontribuar në diversitetin e dhjetë llojeve të ndryshme të peizazheve.

Në lidhje me kushtet socio-ekonomike, në regjistrimin e fundit kombëtar në vend në vitin 2002 u numëruan rreth 17 000 banorë në 27 fshatra të teritorit të parkut. Ky numër është mjaft i pasigurt për shkak të prirjeve të fundit të braktisjes së zonave rurale.

Bujqësia tradicionale ka krijuar një peizazh të shumëllojshëm dhe të pasur përreth fshatrave, të karakterizuar nga mozaikë fushash dhe livadhesh, zakonisht me parcela të vogla dhe përdorim të gjerë që kanë pësuar ndryshime masive përmes braktisjes. Kullotja në verë është ende e pranishme në rajon dhe gjithashtu po pëson rënie të ndjeshme.

Shumica e pyjeve janë në pronësi shtetërore dhe menaxhohen nga Ndërmarrja Publike e Pyjeve Kombëtare në bazë të planeve të posaçme 10-vjeçare të menaxhimit. Autoriteti i Menaxhimit do të ketë përgjegjësinë për të marrë përsipër menaxhimin e pyjeve në parkun kombëtar në pajtim me objektivat për ruajtjen e natyrës.

Në zonë janë krijuar shtatë territore për gjueti. Gjashtë prej tyre menaxhoheshin nga koncesionarë, ndërsa terreni shtetëror i gjuetisë menaxhohej nga Ndërmarrja Publike e Pyjeve Kombëtare. Me shpalljen e zonës park kombëtar, autoritetit i ri i menaxhimit është kompetent për të mbrojtur dhe menaxhuar kafshët e egra, duke përfshirë gjuetinë selektive. Parku kombëtar duhet të përgatisë një plan të posaçëm për menaxhimin e natyrës së egër për mbrojtjen e kafshëve të egra duke ndjekur parimet e ruajtjes së natyrës.

Mbledhja e bimëve dhe frutave të egra, duke përfshirë bimët medicinale dhe kërpudhat, është një praktikë tradicionale dhe një veprimtari mjaft e përhapur në Malet e Sharrit. Ka të paktën 51 lloje bimësh (p.sh. *Sideritis scardica*) dhe një numër kërpudhash që mbledhen për qëllime tregtare. Parku kombëtar do të ketë gjithashtu kompetencat për të menaxhuar këtë veprimtari.

Në një pjesë të zonës gjendet rezorti i njohur i skive Kodra e Diellit me disa teleferikë të vegjël/të mesëm. Në zonat përreth po shtohen ndërtimet e shtëpive të verimit, e cila çon në probleme me mbeturinat, ujërat e ndotura, trafikun dhe të tjera.

Turizmi konsiderohet të jetë një sektor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik. Për momentin ekzistojnë disa struktura akomoduese. Turizmi masiv është i pranishëm në rezortin e skive Kodra e Diellit, ndërsa ende janë duke u zhvilluar lloje të ndryshme të turizmit alternativ. Këto veprimtari përfshijnë sporte verore dhe dimërore malore të tilla si ngjitja, kalërimi, çiklizmi malor, ski të stilit të lirë, udhëtim në dëborë dhe ecje në dëborë. Trysnia në vlerat natyrore indentifikohet nga përdorimi i mjeteve motorrike.

Lloje të panumërta të bimëve u identifikuan të cilat ndodhen në listën e Kuqe të IUCN-it, Shtojca II e Direktivës së Habitave të BE-së, në listën e llojeve të mbrojtura (rreptësisht) në vend ose regjime të tjera të mbrojtjes. Shembujt janë: *Mannia triandra* dhe *Buxbaumia viridis* (myshqet), *Crocus scardicus*, *Gentiana lutea* dhe *Gentiana punctata*, *Lilium albanicum*, *Pinguicula balcanica*, *Pinus heldreichii*, *Pinus peuce*, *Potentilla doerfleri*, *Sempervivum kosaninonii*, *Sideritis scardica* ose *Silene schmuckeri* (bimë vaskulare).

Lloje të panumërta kafshësh u identifikuan të cilat janë në listat e Kuqe të IUCN-it, Shtojca II e Direktivës së BE-së për Habitatet, në listën e llojeve të mbrojtura (rreptësisht) në vend ose regjime të tjera mbrojtjeje.

Shembujt janë: *Canis lupus*, *Lynx lynx balcanicus*, *Miniopterus schreibersii*, *Myotis blythii*, *Myotis myotis*, *Rupicapra rupicapra* ose *Ursus arctos* (gjitarë);

*Accipiter nisus*, *Aquila chrysaetos*, *Bubo bubo*, *Corvus corax*, *Coturnix coturnix*, *Crex crex*, *Falco peregrinus*, *Falco Subbuteo*, *Falco tinnunculus*, *Gyps fulvus*, *Oriolus oriolus*, *Otus scops*, *Pernis apivorus*, *Pyrrhocorax graculus*, *Pyrrhocorax pyrrhocorax*, *Tetrao urogallus* ose *Tetrastes bonasia* (shpendët);

*Bombina variegata*, *Bufotes viridis*, *Coronella austriaca*, *Dolichophis caspius*, *Hyla arborea*, *Lacerta agilis*, *Lacerta trilineata*, *Lacerta viridis*, *Natrix tessellate*, *Podarcis erhardii*, *Podarcis muralis*, *Rana dalmatina*, *Rana graeca*, *Testudo graeca*, *Testudo hermanni*, *Triturus macedonicus*, *Vipera ammodytes*, *Vipera ursinii* ose *Zamenis longissimus* (zvarranikët dhe amfibët);

*Aricia anteros*, *Carcharodus floccifera*, *Coenonympha tullia*, *Cupido decoloratus*, *Erebia (epiphron) roossi*, *Euphydryas aurinia*, *Euphydryas maturna*, *Hipparchia statilinus*, *Iolana iolas*, *Lycaena dispar*, *Melitaea aurelia*, *Parnassius apollo*, *Parnassius mnemosyne*, *Phengaris (Maculinea) arion*, *Plebejus pylaon*, *Polyommatus damon*, *Polyommatus dorylas*, *Polyommatus eros eroides*, *Pseudophilotes vicrama*, *Thymelicus action* ose *Zerynthia cerisy* (fluturat);

Më shumë se 20 habitate nga Direktiva e BE-së për Habitatet Shtojca I u identifikuan në zonë, ndër to lumenj dhe ligatina, livadhe baritore, pyje dhe habitate kazmofitike.

Për shkak të ndryshimeve në shoqëri, Malet e Sharrit i janë nënshtruar trysnive antropogjene. Kjo shkakton kërcënime ndaj vlerave natyrore:


- Braktisja e praktikave të përdorimit tradicional të tokës dhe përdorimi i burimeve natyrore, duke ndryshuar dhe reduktuar zonën në lidhje me diversitetin;
- Urbanizimi dhe infrastruktura e parregulluar (hapja e rrugëve, shtëpitë e pushimit, objektet hotelierike, infrastruktura turistike, etj.);

- Veprimtari të paligjshme dhe të pakontrolluara të prerjes së drurëve, gjuetisë dhe peshkimit;
- Përdorimi i paqëndrueshëm i disa bimëve aromatike dhe mjekësore dhe kërpudhave të caktuara;
- Përdorim i paqëndrueshëm i burimeve ujore (veçanërisht për prodhimin e energjisë elektrike);
- Përdorim i parregulluar i mjeteve të motorizuara.

Ndikimet negative në biodiversitetin e Maleve të Sharrit janë:

- Shndërrimi i habitateve i shkaktuar nga kërcënimi i braktisjes së praktikave tradicionale të përdorimit të burimeve natyrore. Për shembull, mbulimi i sipërfaqes së tokave bujqësore me shkurre dhe fiere çon në zvogëlimin e diversitetit biologjik;
- Shndërrimi i habitateve përmes kërcënimit të prerjes së paligjshme të drurëve;
- Ndërprerja e proceseve ekologjike në ekosistemet lumore e cila shkaktohet nga ndërtimi i infrastrukturës për prodhimin e energjisë me hidrocentrale;
- Humbje dhe shkatërrim i habitateve përmes urbanizimit të parregulluar dhe ndërtimit të infrastrukturës, si për shembull ndërtimi i rrugëve, shtëpive dhe strukturave të tjera;
- Ndryshimet në dendësinë e llojeve të bimëve përmes mbledhjes pa kriter të bimëve të caktuara aromatike dhe mjekësore;
- Shqetësimi, reduktimi i popullatave ose madje edhe humbja e llojeve përmes kërcënimit të gjuetisë së pakontrolluar të kafshëve të egra;
- Shqetësimi i llojeve përmes turizmit.

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, janë hartuar dhe përshkruar 4 zona: mbrojtja e rreptë, menaxhimi aktiv, zhvillimi i qëndrueshëm dhe rripi mbrojtës për qendrën e skijimit. Një listë e hollësishme e kufizimit të veprimtarive për secilën zonë jepet më poshtë në këtë Planin menaxhimi.



Plani i menaxhimit paraqet një vizion për parkun kombëtar i cili shpreh rëndësinë e nevojës për mbrojtjen e vlerave natyrore dhe në të njëjtën kohë propozon përfshirjen e popullsisë lokale dhe tregon potencialin për mundësitë turistike për të sjellë zhvillimin e qëndrueshëm turistik në rajon.

Pjesa thelbësore e planit të menaxhimit janë 8 programe me nën-programe dhe veprimtari të hollësishme për një plan operativ 5-vjeçar. Tetë programet janë:

1. Ruajtja dhe Monitorimi i Trashëgimisë Natyrore;
2. Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore;
3. Menaxhimi i Habiteteve dhe Ekosistemeve;
4. Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore;
5. Zhvillimi i Turizmit të Qëndrueshëm;
6. Zhvillimi Lokal;
7. Informimi, Rritja e Ndërgjegjësisë dhe Edukimi;
8. Qeverisja, Menaxhimi, Organizimi i Punës dhe Financimi.


Institucioni Publik i Parkut Kombëtar të Maleve të Sharrit u krijua me anë të një vendimi të Qeverisë (Gazeta Zyrtare 175/2021). Në bazë të këtij vendimi, struktura menaxhuese përfshin organet e mëposhtme:

- Bordin e menaxhimit;
- Drejtorin e bordit operativ;
- Bordin e ekspertëve;
- Bordin për kontrollin e zbatimit fizik dhe financiar.

Kompetencat, struktura, organizimi, dhe përgjegjësitë e këtyre organeve duhet të përcaktohen në statutin e IP (2021), në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligjin për Shpalljen e Maleve të Sharrit Park Kombëtar.

Mekanizma të shumtë për konsultimin e aktorëve janë të pranishëm në planin e menaxhimit për të arritur mbështetje të fortë nga palët e interesit në të ardhmen. Disa avantazhe të rëndësishme për përfshirjen publike në PKMSH janë në monitorimin dhe hulumtimin, luftën kundër veprimtarive të paligjshme, aksesin e njohurive nga komuniteti ose vendimarrjen e përmirësuar nga parku kombëtar. Shembujt për këto mekanizma janë platformat e rregullta për shkëmbim dhe bashkëpunim, udhëtime studimore, konferenca dhe panaire në nivelin ndërkombëtar ose bashkëpunim kufitar me zona të tjera të mbrojtura.

Plani i menaxhimit paraqet propozimin për një strukturë të Institucionit Publik me departamente dhe anëtarë të shumtë të stafit, duke përfshirë përskrime të hollësishme të detyrave dhe nevojave të trajnimit të stafit.



Sipas Rregullores për organizimin e brendshëm të IPPKMSH-së, institucioni ka katër njësi organizative – njësi, si në vijim:

1. Njësia për Çështje Juridike, Ekonomike dhe të Përgjithshme
2. Njësia për mbrojtjen e natyrës
3. Njësia për shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore,
4. Njësia për Aktivitete Alternative dhe Edukim Mjedisor.

Çdo njësi ka një udhëheqës dhe të punësuar. Numri i paraparë i ekzekutuesve, kushtet e veçanta të nevojshme për kryerjen e punëve dhe detyrave të punëve të caktuara, si dhe përshkrimi i vendeve të punës sipas detyrave dhe pjesëve organizative përcaktohen me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në IP PKMSH.

Prej këtu në departamentin për çështje juridike, ekonomike dhe të përgjithshme janë të parapara 12 vende pune, në departamentin për mbrojtje të natyrës 19 vende pune, në departamentin për shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore janë siguruar 13 vende pune ndërsa në departamentin për veprimtari alternative dhe ekologjike janë paraparë gjithsej 5 vende pune. Duke pasur parasysh mungesën e përvojës paraprake në numrin e nevojshëm të punonjësve për të cilët në të njëjtën kohë institucioni do të mund të sigurojë financim të përhershëm, si për fillim IPPKMSH do të funksionojë me pesëdhjetë punonjës. Nëse gjatë punës shfaqet nevoja për të rritur numrin e punonjësve për të cilët institucioni do të jetë në gjendje të sigurojë financimin e duhur, ky numër mund të rritet.

Në lidhje me këtë strukturë të propozuar u përgatit buxheti përkatës.

Pamje e përgjithshme e shpenzimeve brenda funksioneve të rregullta:

<b>Pozicionet në funksionet e rregullta</b>	<b>Vlera</b>	<b>Shpenzimi për njësi MKD</b>	<b>Shuma totale MKD / vit</b>	<b>Shpenzi met totale EUR /vit</b>
Paga / anëtar i stafit x * muaj (900 EUR)	50	60.000	36.000.000	585.365
Hapësirë zyre (12m2) për individ + PC + artikuj të ndryshëm. (300 EUR/muaj)	40	20.000	9.600.000	156.097
Automjete (600 EUR/muaj)	15	36.000	6.480.000	105.365
Uniforma + pajisje për roje pylli (30 EUR/muaj)	20	2.000	480.000	7.804
Shpenzime të tjera (3000 EUR/ muaj)	1	180.000	2.160.000	35.121
<b>Shuma totale / vit</b>			<b>54.720.000</b>	<b>889.752</b>

Vlerësimi i shpenzimeve për bashkëpunim me ekspertë të huaj për programe operative:

<b>Projekte me bashkëpunim të jashtëm</b>	<b>Nr. i Veprimtarive</b>	<b>Shpenzime t mesatare EUR/ vit</b>	<b>Shpenzimet tolale MKD / vit</b>	<b>Shpenzi me totale EUR / vit</b>

**Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit për periudhën 2022-2031**

Projekt i prioritetit 1 me mbështetje të jashtme	35	15,000	32.287.500	525.000
Projekte të prioritetit 2 me mbështetje të jashtme	70	15,000	64.575.000	1.050.000
Projekte të prioritetit 3 me mbështetje të jashtme	25	15,000	23.062.500	375.000
Shuma totale / vit				1.950.000

Burime të shumta të financimit për funksionet e parkut kombëtar duhet të merren në konsideratë për t'u adresuar për financimin e funksioneve të menaxhimit të Parkut Kombëtar dhe projekteve përkatëse:

- Fondet kombëtare (qeveria)
- Pagesat e shërbimeve të ekosistemeve: Tarifatat e mbledhura nga përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore sipas Planit të menaxhimit si dhe tarifatat nga subjektet që ofrojnë shërbime në territorin e PK (operatorët turistikë, hidrocentralet e vogla, linjat e rrymës elektrike, hotelet, operatorë turistikë, shërbimet e skive, etj.
- PONT
- IPA - BE
- Programi ndërkufitar i BE-së
- GIZ
- GEF
- UNDP
- UNEP
- SIDA
- USAID
- Bashkëpunimi zviceran
- Donatorë të tjerë ndërkombëtarë
- Sponsorizimi nga sektori privat



## 2. Hyrje

Malet e Sharrit janë një vargmal që shtrihet në veri-perëndim të Maqedonisë së Veriut dhe jug të Kosovës. Zona ka një pasuri me vlera natyrore dhe diversitet biologjik. Ajo është e pasur me pyje, kullota, liqene malore, përrrenj, dhe gjeomorfologji të larmishme. Pjesa maqedonase e vargmalit mbulon një sipërfaqe prej 840.2 km<sup>2</sup>, dhe pika e tij më e lartë është Titov Vrv, në lartësinë 2,748 m mbi nivelin e detit. Pjesa veriore, e ndodhur në Kosovë, u shpall Park Kombëtar pothuajse dhjetë vjet më parë.

Megjithatë, trysnia për biodiversitetin është në rritje. Vendi është në udhëkryq mes zhvillimit të shpejtë ekonomik (shfrytëzimi intensiv i burimeve natyrore, rritja e tokës bujqësore, ndërtim i pakontrolluar dhe zhvillim urban, etj.) dhe shkatërrimit në rritje të vlerave natyrore.

Si reagim, zgjerimi i rrjetit të zonave të mbrojtura kombëtare si dhe forcimi i kapaciteteve për menaxhimin efektiv po ndiqen si qasje për të mbrojtur biodiversitetin.

Me qëllim që të mbrohen vlerat natyrore të pranishme në Malet e Sharrit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut i kërkoi Programit për Mjedisin të Kombeve të Bashkuara (UNEP) të mbështesë iniciativën për shpalljen e Maleve të Sharrit Zonë të Mbrojtur, në kategorinë "Park Kombëtar".

Fondet u siguruan përmes Qendrës Globale për Mjedisin (GEF), në bazë të projektit: "Arritja e mbrojtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efikas me zonat e mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës", zbatuar nga UNEP, në partneritet me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor si përfituesi kryesor. Procesi për shpalljen e Maleve të Sharrit park kombëtar u krye në kuadër të këtij projekti dhe përfshiu përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, konsultimin dhe veprimtaritë promovionale.

Si rrjedhojë, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut mori një vendim më 30 qershor 2021 për të shpallur një park kombëtar në Malet e Sharrit. Ligji për shpalljen e pjesës së Maleve të Sharrit Park Kombëtar kërkon miratimin e një plani të menaxhimit nga institucioni publik i cili qeveris zonën e mbrojtur, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit (6 korrik 2021).

Si i tillë, hapi i ardhshëm është përgatitja e planit të menaxhimit. Parku Kombëtar i Maleve të Sharrit do të mbështesë tre rezultate kryesore: (1) Zgjerimin e rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura, (2) Rritjen e efektshmërisë për menaxhimin e biodiversitetit, (3) Përfshirjen e biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës.

Qëllimi i përgjithshëm i planit të menaxhimit është ruajtja në mënyrë sistematike e biodiversitetit, duke analizuar me kujdes trysnitë dhe kërcënimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, dhe duke i adresuar ato përmes zbatimit të politikave të përshtatshme. Plani i menaxhimit përfshin gjithashtu qasje të shumta për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik dhe për të rritur përfitimet e popullsisë lokale.

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit është përgatitur duke u bazuar në dy studime të përfunduara nga një ekip ekspertësh të disiplinave të shumta dhe me pjesëmarrjen e MMJPH dhe UNEP:

- Studimi për Valorizimin e Maleve të Sharrit (2020);
- Studimi socio-ekonomik i propozuar për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit (2020)

Rezultatet e pritshme të planit të menaxhimit janë ruajtja e përmirësuar e biodiversitetit në Maqedoninë e Veriut duke zgjeruar rrjetin kombëtar të zonave të mbrojtura dhe duke përmirësuar qeverisjen përmes krijimit të politikave të shëndosha dhe forcimit të kapaciteteve përkatëse, planifikimit dhe menaxhimit të përmirësuar të përdorimit të tokës, me përfshirjen e plotë të aktorëve lokalë në procesin e përgjithshëm.

## 2.1. Sfondi Ligjor

### 2.1.1. Legjislacioni Kombëtar

Dokumenti i nivelit më të lartë ligjor në vend është Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/91, e ndryshuar), e cila parashtron parimet bazë për mbrojtjen e mjedisit. Nevoja për të mbrojtur natyrën dhe mjedisin është një nga parimet më themelore.

Të gjithë burimet natyrore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë florën, faunën, dhe trashëgiminë natyrore janë të interesit publik dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë. Republika garanton mbrojtjen, promovimin dhe pasurimin e kapitalit historik dhe artistik të vendit.

Dy ligje në veçanti lidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore të vendit:

**Ligji për Mjedisin Jetësor** ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/05, i ndryshuar) është një kuadër ligjor në fushën e mjedisit. Ky ligj, së bashku me aktet nënligjore, rregullon zbatimin e procedurave mjedisore dhe strategjike për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor.

**Ligji për Mbrojtjen e Natyrës** ("Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut", nr. 67/04, i ndryshuar) është një nga komponentët më të rëndësishëm të legjislacionit kombëtar për mjedisin jetësor. Ai rregullon ruajtjen e natyrës përmes mbrojtjes së diversitetit biologjik dhe peizazhor dhe mbrojtjes së trashëgimisë natyrore, brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura, si dhe mbrojtjes së tipareve të rralla natyrore.

### 2.1.2. Ligji për Shpalljen e Maleve të Sharrit Park Kombëtar

Ligji për Shpalljen e Maleve të Sharrit Park Kombëtar u botua në ("Gazetën Zyrtare" e RMV-së nr. 151/2021). Shpallja e parkut kombëtar bën gjithashtu thirrje për një strukturë menaxhuese, përgjegjëse për menaxhimin e zonës së mbrojtur në bazë të një plani të menaxhimit. Ky plan do të përcaktojë masat dhe veprimtaritë për mbrojtjen e vlerave karakteristike natyrore brenda parkut, si dhe menaxhimin e territorit të tij.

Në bazë të nenit 17 të Ligjit, ky institucion i sapo krijuar duhet të përgatisë një program vjetor brenda tre muajve nga data e shpalljes dhe një plan menaxhimi brenda një viti nga e njëjta datë.

### 2.1.3. Marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse

Republika e Maqedonisë së Veriut është një palë nënshkruese e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Biodiversitetin Biologjik (me Protokollet e Kartagjenës dhe Nagojës) e cila parashtron tre objektiva: ruajtjen e biodiversitetit, përdorimin e qëndrueshëm të komponentëve të tij dhe ndarjen e barabartë dhe të drejtë të përfitimeve të përdorimit të burimeve gjenetike. Përveç KDB-së, Maqedonia e Veriut ka ratifikuar gjithashtu edhe marrëveshjet e mëposhtme përkatëse:

- Konventën për Ruajtjen e Natyrës së Egër Evropiane dhe Habiteteve Natyrore (Konventa e Bernës)
- Konventën për Ruajtjen e Llojeve Shtegtare të Kafshëve të Egra (Konventa e Bonit)
- Traktatin për Ruajtjen e Popullatave Evropiane të Lakuriqëve të Natës (EUROBATS)
- Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore (Konventa e UNESCO-s për Trashëgiminë Botërore)
- Konventën për Tregëtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër (CITES, Konventa e Uashingtonit)
- Konventën Evropiane për Peizazhin
- Konventën Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)

## 2.2. Parathënie

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, një organ menaxhues për zonën e mbrojtur është kompetent për përgatitjen dhe miratimin e një plani të menaxhimit, me pëlqimin paraprak të MMJPH.

Plani i menaxhimit duhet të jetë rezultat i një procesi efikas, të organizuar i cili përfshin pjesëmarrjen e të gjithë palëve të përfshira përkatëse dhe të interesuara, dhe do t'i krijojë mundësinë organit menaxhues të menaxhojë me efektivitet dhe efikasitet zonën.

Plani i menaxhimit përmban një komponent operativ, i cili identifikon veprimtaritë e përcaktuara në programe dhe nën-programe, së bashku me afatet kohore të përcaktuara dhe kompetencat e kërkuara. Plani përcakton masat dhe veprimtaritë për mbrojtjen e vlerave karakteristike natyrore të zonës së mbrojtur, si dhe menaxhimin e zonës brenda kufijve të saj.

### 3. Përshkrimi i zonës

#### 3.1. Informacioni i iërgjithshëm

Malet e Sharrit janë një masiv i madh e i lartë që shtrihet në pjesën veri-perëndimore të Maqedonisë së Veriut dhe në pjesën jugore të Kosovës. Brenda kufijve të tij natyrorë ai mbulon një sipërfaqe prej 2,480 km<sup>2</sup> nga të cilat 881 km<sup>2</sup> ose 35.5% i përkasin Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pjesa e Maleve të Sharrit që i nënshtrohet këtij plani të menaxhimit ka një sipërfaqe prej 627 km<sup>2</sup>.

Malet karakterizohen nga një numër i madh i majave që ngihen mbi 2000 m lartësi. Relievi glacial dhe fluvial ka krijuar një sipërfaqe me një dendësi të madhe luginash dhe grykash, duke përfshirë shtigje të shkurtra përmes kanioneve nëpër gurët gëlqerorë, kuarcitet dhe granitidet, si dhe diversitetin e jashtëzakonshëm gjeologjik.

Shumë prej lumenjve në anën maqedonase zbresin thikë nga rrëpirat në formë ujëvarash me shtrirje gjatësore të cilat krijojnë rrjedha të rrëmbyeshme. Këto përfshijnë Lumenjtë Vratnicka, Belovishka, Gabrovnica, Teareçka dhe Bistrica dhe degët e Shkumbinit duke përfshirë Lumenjtë Skakalska, Lesnicka dhe Krivoshijska, disa prej të cilave kanë ujëvara të mahnitshme (duke përfshirë Belovishkën, Vratnickën, Krivoshijkën, Leshnickën dhe Bogovinskën).

Më shumë se 10 % e Maleve të Sharrit përbëhen nga gurë karbonikë (kryesisht mermer dhe gurë gëlqerorë). Në këto zona, veçanërisht në gurët gëlqerorë të Luginës së Shkumbinit janë identifikuar shpella të panumërta dhe pritet të gjenden edhe struktura më të mëdha shpelleologjike.

Brenda kufijve të Parkut Kombëtar gjenden më shumë se 25 fshatra, të cilat mund të arrihen përmes rrugëve të asfaltuara. Shumë rrugë në zonë janë të pashtruara ose në gjendje të mjerueshme dhe mund të kalohen vetëm me makina fuoristradë. Të gjitha fshatrat në zonë kanë pësuar rënie të popullsisë për shkak të shpërnguljes në qytete. Ka mjaft hapësirë për përmirësim të infrastrukturës dhe shërbimeve lokale.


##### 3.1.1. Vendodhja gjeografike dhe kufijtë administrativë

Malet e Sharrit janë një masiv i cili shtrihet në kufirin veriperëndimor të Maqedonisë së Veriut dhe atij jugor të Kosovës.

Vargmali shtrihet nga maja Luboten (2498 m mbi nivelin e detit) në pjesën verilindore, deri në shpatin e Malit Niçpurska dhe Qafën e Bunecit (drejt Luginës së Mavrovës) në pjesën jugperëndimore, më shumë se 60 km në vija të drejtë. Në pjesën lindore dhe juglindore, vargmali zbrit në Luginën e Pollogut. Qytetet më të afërta janë Tetova dhe Gostivari.

Kufijtë e PKMSH (Parkut Kombëtar të Maleve të Sharrit) janë të përcaktuara me hollësi në Ligjin për Shpalljen, të miratuar më 7 korrik 2021 (Gazeta Zyrtare 151/21).

Pjesa maqedonase e Maleve të Sharrit i përket administrimit të shtatë komunave: Jegunovcë, Tearcë, Tetovë, Bogovinjë, Vrapçishtë, Gostivar, Mavrovë dhe Rostushë. Pjesa më e madhe gjendet në Komunën e Tetovës (220 km<sup>2</sup>), dhe ajo më e vogla (26.4 km<sup>2</sup>) në Mavrovë dhe Rostushë.



### 3.1.2. Pronësia mbi tokën

Toka brenda kufijve të PKMSH është në pronësi shtetërore dhe private. Të dhënat e sakta të regjistrimit të tokës janë në zotërim dhe ruhen nga Agjencia për Kadastër të Patundshmërisë. Organi menaxhues i PK duhet të mbledhë të dhëna për pronësinë mbi tokën, meqenëse këto do të jenë të rëndësishme për përdorime të ardhshme.

Pjesa më e madhe e tokës brenda parkut është në pronësi shtetërore dhe jepet me qera në bazë koncesionesh, veçanërisht kullotat, rajonet e peshkimit, rajonet e gjuetisë, minierat në sipërfaqe për nxjerrjen e burimeve minerare, si dhe hidrocentralet e vogla. Me shpalljen e parkut kombëtar, organi menaxhues i zonës së mbrojtur është përgjegjës për menaxhimin e të gjithë territorit të zonës së mbrojtur, në pajtim me Nenin 135, paragrafi 6, dhe Nenin 135a të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare nr. 67/04, i ndryshuar).

Pyjet e zonës janë në pronësi shtetërore dhe private (madje edhe nga grupet fetare). Pyjet në pronësi shtetërore menaxhohen nga entitete të caktuara nga qeveria, (në këtë rast Autoriteti i Menaxhimit të parkut kombëtar). Pyjet në pronësi private menaxhohen nga pronarët e tyre, në bazë të kriterëve të paracaktuara dhe planeve të miratuara të menaxhimit.

## 3.2. Mjedisi jetësor

### 3.2.1. Gjeologjia dhe gjeomorfologjia

Përbërja gjeologjike e Maleve të Sharrit mbizotërohet nga gurë metamorfikë paleozoikë me rezistencë të ulët, të cilët ndikojnë në karakteristikat e relievit. Në disa vende metamorfitet (kuarcite, mermer) shfaqen në reliev (p.sh. Leshnica). Në disa të tjera ka depërtime të gurëve më të fortë granitikë. Gurët karbonitikë shfaqen në pothuaj 11% të sipërfaqes së malit dhe ndikohen nga karstifikimi. Malet e Sharrit karakterizohen nga një strukturë tektonike shumë e ndërlikuar. Vargmali është ngjeshur nga Pllaka e Adriatikut dhe Albanidet në perëndim, si dhe nga Pelagonia nga lindja (si një zonë kratene). Indikacionet e relievit gjeologjik tregojnë se pjesa më e madhe e shpërndarjes dhe e ngritjes u shfaq në fund të Miocenit dhe përgjatë Pliocenit, dhe e njëjta gjë ndodh edhe në ditët e sotme, me një rritje mesatare prej pothuajse 1-2 mm / vit.

Në lidhje me karakteristikat morfometrike, malet variojnë në lartësi ndërmjet 470 m (Lugina e Pollogut) dhe 2747 m (Titov Vrv). Malet e Sharrit kanë një pjerrësi mesatare prej afërsisht 25° dhe shtrihen në drejtim VL-JJSP-J me një gjatësi prej 75 km.

Nga llojet e relievit, format e fosilizuara dhe ato të kohëve të fundit janë të pranishme në Malet e Sharrit. Një nga elementët morfologjikë karakteristike për Malet e Sharrit janë relievet fluviale. Ka shumë lugina në formë V-je, të formuara nga prerje intensive vertikale, dhe gryka të pafundme, disa me segmente të shkurtra kanionesh të prera në brendësi të gurëve shumë të fortë (gëlqerorë, kuarcitë, granotidë). Disa lugina kanë një karakter fluvial-glacial.

Për shkak të ndryshimit të lartësive ndërmjet maleve dhe Luginës së Pollogut, zbritja gjatësore e lumenjve është e mahnitshme, duke krijuar lumenj me rënie të vrullshme uji dhe ujëvara.

Shfaqja e relievit karstik në Malet e Sharrit ndodh për shkak se rreth 11% e vargmaleve përbëhen nga gurë karbonikë (kryesisht mermer dhe gurë gëlqerorë). Ndërmjet viteve 2017 dhe 2019, u regjistruan hyrjet në 10 shpella dhe gremina të shumta, kryesisht në gëlqerorët e luginës së Shkumbinit dhe priten objekte më të mëdha shpelleologjike.

Malet e Sharrit kanë shumë gjurmë glaciale. Hulumtimi deri tani ka identifikuar mbi 50 zona akumulimi glacial, nga të cilat 8 zona shumë të mëdha akumulimi glacial (ku paraqiten disa me të vogla) sipërfaqja e të cilëve është 10 km, pastaj afërsisht 28 lugina duke përfshirë luginat në formë U-je (disa nga të cilat kanë shpate glaciale), morena të panumërta anësore dhe frontale, pellgje akumuluese, iriqë deti, gurë të shkërmoqur, etj.

### 3.2.2. Hidrologjia

Malet e Sharrit kanë tipare të panumërta hidrologjike që kontribuojnë ndaj gjeodiversitetit dhe biodiversitetit të tyre. Zona ka më shumë se 100 burime, dhe 20 pellgje lumore duke përfshirë përrrenjtë dhe degët e tyre kryesore, si dhe shumë liqene glaciale.

Pellgjet kryesore lumore janë Dufska, Vrutnicka, Jelovjanska, Kamenjska, Uliveriçka dhe Shkumbin, të gjitha derdhen në Lumin Vardar. Liqenet më të mëdha glaciale janë Liqenet e Bozovcës, Liqeni i bardhë, Liqeni i Bogovinjes, Karanikoliçko, Krivoshisko, Liqeni i zi.

### 3.2.3. Klima

Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Kodra e Diellit (1,780 m MSL) është 4.8 °C. Ato maksimale dhe minimale janë 30.6 °C dhe -23.0 °C.

Rreshjet mesatare vjetore të parkut janë rreth 700 mm, dhe arrijnë deri në 1,250 mm në bjeshkë.

### 3.2.4. Dheu

Në Luginën e Pollogut, pjesa më e ulët e zonës, fluvisolet janë lloji më i përhapur i dheut. Në terren kodrinor, regosolet dhe dheu i kanellës është i përhapur, dhe në terrene malore gjenden leptosolet, dheu i kafenjtë mbi gëlqerorët dhe dolomitët, dheu i kafenjtë i pyjeve, argjilorët dhe gurët porozë gëlqerorë dhe dolomitët. Përzierjet e dherave të mëposhtëm shfaqen gjithashtu në park: argjilorët dhe leptosolet gëlqerore-dolomite, dheu i kafenjtë i pyjeve dhe gurët porozë, argjilorët e kafenjtë të pyjeve dhe leptosoli, gurët porozë dhe regosolë, regosolë dhe leptosolë.

### 3.2.5. Erozioni

Duke marrë parasysh topografinë e zonës, në malin e lartë, zonën subalpine dhe alpine, janë të pranishme procese të shumta erozioni: orteqet, rrëshqitjet e dheut, dekompozimet, format glaciale dhe karstike të erozionit.

Erozioni i sipërfaqeve shpesh shfaqet në afërsi të vendbanimeve, përgjithësisht në anën e kundërt të vendbanimeve, si dhe brenda zonave ujëmbledhëse, ku ndikohet bimësia.

Dekompozimi i gurëve (erozioni dekompozues) është i pranishëm në të gjithë masivët malorë të analizuar, veçanërisht në zonat malore, bjeshkët, zonat subalpine dhe alpine.

Rrëshqitjet e dheut janë procese episodike të lëvizjes së masave të mëdha të tokës në shpatet e territoreve kodrinore apo malore ose të brigjeve lumore dhe janë regjistruar në pjesën më të madhe të zonave ujëmbledhëse.

Erozioni fluvial lumor është i pranishëm në shtratet lumore të përrrenjve dhe është rezultat i erozionit të shkaktuar nga rrjedhat e ujit. Ai shkakton energji kinetike gërryese të ujërave rrjedhëse të përrrenjve. Procesi i sedimentimit fillon në përgjithësi në pjesët më të larta të pellgut dhe shtratit lumor ku depozitohen sedimentet më të mëdha, ndërsa pjesët më të vogla arrijnë në destinacionin e fundit, në Lumin Vardar.

### 3.2.6. Fauna

Malet e Sharrit strehojnë një shumëllojshmëri të madhe jovertebrorësh duke përfshirë krimbat (*Platyhelminthes*), (*Nematoda*), qime kali (*Nematomorpha*) dhe krimbat unazor (*Annelida*). Janë evidentuar 56 lloje të Mollusqve (*Mollusca*), duke përfshirë 4 lloje endemike, si dhe pothuajse 300 lloje të akrepave të rremë (*Pseudoscorpiones*), merimanga (*Arachnida*) dhe gaforre (*Krustacëve*), duke përfshirë dhe disa lloje endemike. Deri tani është regjistruar një numër total prej 1,847 lloje insektesh, duke përfshirë më shumë se 900 lloje fluturash, kryesisht (*Nocturna*) dhe rreth 160 lloje nga lloji *Carabidae*.

Në zonat me habitate të ujërave të ëmbla, janë konfirmuar 5 lloje peshqish, 11 amfibësh dhe 17 zvarranikësh.

Shpendët janë klasa e vertebrorëve më të përhapur në zonë, të përfaqësuar nga 128 lloje. Në veçanti gjenden shpendë të ndryshëm grabitqarë: shqiponja e malit, huta, kali i qyqes, skifteri dhe fajkoi.

Janë të pranishme 51 lloje gjitarësh duke përfshirë ariun e murrmë, rrëqebullin, macen e egër, lundërzën, derrin e egër, dhinë e egër, kaprollin, ujkun, dhelpren, vjedullën dhe shqarthin.

### 3.2.7. Flora

Aktualisht në Malet e Sharrit njihen 662 lloje njëqelizorësh (diatome), 1,260 lloje të bimëve vaskulare, më shumë se 260 lloje myshqesh, 500 kërpudhash dhe 160 likenesh.

### 3.2.8. Habitatet

Për shkak të diversitetit të formacioneve gjeomorfologjike dhe zhvillimit historik gjeologjik, si dhe pranisë së vazhdueshme të njerëzve përgjatë mijëvjeçarëve, zona ka florë të pasur dhe habitate të shumëllojshme.

Llojet e drurëve mbizotërues në pyjet e zonës janë ahu, shkoza dhe lisi, të shoqëruara nga bredhi i butë, selvia, pisha, bredhi, verri dhe shelgu.

Bashkësitë e bimëve të pranishme jo pyjore janë: zona alpine dhe boreale, kullota acidofilike oromezike, bimësi mesdhetare, torfa alkaline, lëndina me luleborë dhe breza kodrinorë dhe alpinë, livadhe gëlqerore alpine dhe subalpine, thepa me gurë silikate me bimësi kazmofite dhe livadhe silikate alpine dhe boreale malore.

Habitatet ligatinore të zonës janë: ujërat e qëndrueshëm, ujërat e rrjedhshëm sipërfaqësorë, zona litorale me trupa ujorë në sipërfaqen tokësore, livadhe torfike, lloje të ndryshme të torfës moçalore.

### 3.2.9. Ekosistemet

Ekosistemet e mëposhtme natyrore gjenden në Malet e Sharrit:

1. Ekosisteme liqenesh (ekosisteme të ujërave të qëndrueshëm sipërfaqësorë, duke përfshirë rezervuarat, pellgjet e mëdha dhe liqenet glaciale)
2. Ekosistemet e lumenjve (ekosistemet e ujërave të rrjedhshëm sipërfaqësorë, duke përfshirë përrenjtë)
3. Ekosistemet e torfës malore (kënetat acidike)
4. Ekosistemet e moçalishteve malore (bazë kënete)
5. Ekosistemet e përbaltura dhe moçalore (duke përfshirë moçalet e kripura)
6. Ekosistemet e kullotave dhe livadheve mezofilike dhe të vërshuara në periudha sezonale)
7. Ekosisteme të kullotave malore (duke përfshirë kullotat subalpine dhe alpine, si dhe kullotat shkëmbore)
8. Ekosisteme të kaçubeve të shkurtra të bjeshkëve
9. Ekosisteme të shkurreve malore
10. Ekosisteme të degraduara pyjore (duke përfshirë përzierje halorësh dhe gjetherënësh (pseudomaquis), formacione bimësh pyjore, shqopishta dhe shkurre termike mesdhetare)
11. Ekosisteme ripariane dhe me kaçube moçalore
12. Ekosisteme me pyje gjetherënë (pyje gjetherënë)



13. Ekosisteme me pyje halore
14. Ekosisteme të përziera të pyjeve me drurë gjetherënë dhe halorë
15. Ekosisteme shpellore (duke përfshirë trupat ujorë në to)
16. Ekosisteme shkëmbore dhe gurore (duke përfshirë gurët, terrenin shkëmbor dhe rrëpirat)
17. Ekosistemet me bimësi shumë të rrallë ose pa bimësi (duke përfshirë rajonet e gërryera)
18. Agro-ekosistemet bujqësore
19. Agro-ekosistemet akuatike (peshkataria)
20. Ekosistemet urbane
21. Sisteme ekologjike të venbanimeve rurale
22. Sisteme ekologjike të minierave dhe guroreve industriale
23. Sisteme ekologjike të trupave ujorë tërësisht artificiale
24. Sisteme mjedisore të depozitimeve dhe deponive të mbeturinave

Një përshkrim gjithëpërfshirës i Shërbimeve të Ekosistemit (ESS) është paraqitur në Studimin Socio-Ekonomik të Parkut Kombëtar. Tre lloje të ndryshme janë përshkruar dhe vlerësuar financiarisht: furnizimi, rregullator dhe kulturor.

Shërbimet e ekosistemit të furnizimit i referohen biomasës dhe burimeve të tjera të marra nga ekosisteme të ndryshme që plotësojnë nevojat e njeriut për jetën e përditshme, veçanërisht ushqimin, lëndët e para, ujin e freskët, burimet gjenetike dhe ilaçet. Shembuj janë prodhimi bujqësor, prodhimi i kafshëve ose prodhimi pyjor.

Shërbimet rregulluese të ekosistemit i referohen rregullimit të proceseve të ndryshme ekologjike që kontribuojnë në një ekosistem funksional, më konkretisht rregullimit të klimës dhe cilësisë së ajrit, depozitimit të karbonit, kontrollit të fatkeqësive natyrore, trajtimit të ujërave të zeza, mbrojtjes nga erozioni dhe mirëmbajtjes së pjellorisë së tokës, pllenimit dhe kontrolli biologjik.

Shërbimet kulturore dhe të ekosistemeve i referohen ekosistemeve natyrore që janë jetike dhe kulturore të rëndësishme për njerëzit, sepse ato ofrojnë vende për rekreacion, kënaqësi shpirtërore dhe vlerë estetike. Këto shërbime janë të vlefshme për rekreacionin dhe shëndetin e popullatës dhe turistëve. Këto përfshijnë vlera estetike dhe frymëzim për kulturën, artin dhe dizajnin, përvojën shpirtërore.

ESU-të janë të rëndësishme për financimin e ardhshëm të Shërbimit të Parkut Kombëtar.


### 3.2.10. Peizazhet

Peizazhet e Maleve të Sharrit janë formuar nga proceset gjeologjike, fluviale dhe glaciale dhe më tej nga ndikimi i njeriut përgjatë shekujve. Traditat e ndryshme dhe prejardhja etnike dhe kulturore e popullsisë lokale kanë kontribuar në diversitetin e peizazheve.

Melovski et al. (2010) përcaktoi llojet e peizazheve në Malet e Sharrit:

- Peizazh i sheshtë nënkontinental bujqësor dhe rural
- Peizazh kodrinor rural
- Peizazh me bar të thatë në terren silici
- Peizazh me pyje halore dhe bredha
- Peizazh me terren gurësh gëlqerorë
- Peizazh baritor malor në terren gëlqeror

- Peizazh baritor malor në terren silici
- Peizazh me terren gurësh silici
- Peizazh pyjor gjethegjere
- Peizazh malor rural



### 3.3. Karakteristikat socio-ekonomike

#### 3.3.1. Komunitetet dhe popullsitë lokale

Parku Kombëtar i Maleve të Sharrit gjendet në kuadër të 7 komunave të rajonit të Pollogut: Bogovinjë, Gostivar, Jegunovcë, Mavrovë dhe Rostushë, Tearcë, Tetovë, and Vrapçishtë. Tetova dhe Gostivaro janë qendrat kryesore.

Popullsia në shtatë komunat:

Komuna	Numri i përgjithshëm i banorëve
Bogovinë	22 906
Gostivarë	59 770
Jegunovcë	8 895
Mavrovë dhe Rostushë	5 042
Tearcë	17 694
Tetovë	84 770
Vrapçisht	19 842

Tabela e mëposhtme paraqet fshatrat në PKMSH sipas komunës:

Komuna	Fshatrat në PKMSH sipas komunës
Bogovinjë	Palçishti i epërm, Jelovjanë, Novo Selë, Rakovec, Selce Keç, Urviç
Gostivar	Brodec, Jelovce i poshtëm, Jelovce i epërm, Peçkovë
Mavrovë and Rostushë	Duf
Tearcë	Breznë, Prvce
Tetovë	Bozovcë, Llacë, Lisec, Gjermë, Sellcë, Setolë, Shipkovicë, Vejcë, Veshallë
Vrapçishtë	Gjurgjevishtë, Gorjanë, Kalishtë, Lomnicë, Pozaranë
Jegunovcë	Asnjë fshat në PK

### 3.3.2. Përdorimi i tokës

#### 3.3.2.1. Bujqësia dhe blegtoaria

Bujqësia karakterizohet kryesisht nga mbjellja e kulturave bujqësore, hortikulturave, drithërave dhe produkteve të tjera për përdorim shtëpiak. Në varësi të përkufizimit sektorial, përafërsisht 10% e sipërfaqes së PK-së është tokë bujqësore. Bujqësia tradicionale ka krijuar një peizazh të larmishëm dhe me përbërje të pasur përreth fshatrave, e karakterizuar nga një mozaik me fusha dhe lëndina, zakonisht me parcela të vogla dhe përdorim të gjerë.

Kullotat malore, të përdorura në verë (transhumance), mbulojnë afërsisht 45% të sipërfaqes. Ato gjenden në zonat alpine dhe subalpine dhe përfshijnë ligatinat, lumenjtë dhe zonat shkëmbore. Këto kullota përdoren në mënyrë tradicionale për kullotjen dhe kultivimin e deleve. Stanet janë të zakonshme në zonat e larta malore. Kultivimi i bagëtive praktikohet në afërsi të fshatrave më të afërt. Si rrjedhojë e shpërnguljes së vazhdueshme nga fshati në qytet, ritmi i përdorimit të kullotave malore po pëson rënie të ndjeshme. Ka pothuajse 2,500 krerë bagëti, 50,000 dele dhe 1,500 dhi në fermat dhe pronat e vogla përreth fshatrave malore. Përmasat mesatare të tufave janë afërsisht 200 dele.

#### 3.3.2.2. Menaxhimi i pyjeve

Pyjet, si burimet natyrore dhe ofruesit e shërbimeve të ekosistemit, sigurojnë funksionet më të çmueshme ekonomike, shoqërore dhe mjedisore. Pavarësisht se shumë pyje janë në pronësi shtetërore, ka gjithashtu edhe pyje në pronësi private të cilat përdoren nga pronarët e tyre, kryesisht për prodhimin e drurëve të zjarrit. Praktikant e kaluara të paqëndrueshme kanë çuar në përdorimin e dukshëm pa kriter në disa zona të PKMSH. Prerja e paligjshme e pemëve është e pranishme në PKMSH dhe për këtë kërkohen masat parandaluese.

PKMSH ka lloje të shumëllojshme pyjesh, ndër të cilat mbizotërojnë gjetherënët. 75% of pyjeve të parkut janë vetëm me një lloj druri, kryesisht ah ose lis. Këto pyje ahu ose lisi formojnë dy zona ose breza të dallueshëm, në lartësi të ndryshme. Lloje të tjera drurësh të pranishëm përfshijnë bredhin e butë, gështenjën, bredhin, panjën, shkozën, drizën, si dhe endemikë, duke përfshirë pishën maqedonase - *Pinus peuce* Griseb., pishën boshnjake - *Pinus heldreichii*, *Acer heldreichii* Orph. Ex Boiss.

Pyjet e përziera, pavarësisht se zënë më pak sipërfaqe në park, janë të rëndësishëm meqenëse ofrojnë biodiversitet të madh. Pylli i përzier, i përbërë prej më shumë se gjashtë lloje drurësh, në zonën e mbrojtjes së rreptë të Mazdraçës, është një shembull i rrallë e i rëndësishëm që meriton të mbrohet.

Në Malet e Sharrit përshkruhen 13 grupime pyjore, ku shpërndarja e tyre lidhet me lartësinë, kushtet klimatike dhe kushtet e zonës. Calimintho grandiflorae – Fagetum përbën 41,5% të sipërfaqes pyjore, ndërsa Festuco heterophyllae-Fagetum zë 25,3%, Grupimi Orno-Quercetum petraeae është i treti më i zakonshëm, me 13,4 % të sipërfaqes totale pyjore.

Pyjet e shkozës janë të prejardhjes relikte dhe endemike dhe duhet të mbrohen në mënyrë që të ruhet gjendja e tyre natyrore. Shumë pyje të parëndësishëm ekonomikisht dhe lloje pemësh kanë shumë rëndësi mjedisore dhe kontribuojnë në biodiversitetin e PK. Menaxhimi i tyre duhet të jetë i përshtatshëm për rolin e tyre mjedisor.

Zona të tjera në parkun kombëtar janë mbjellë, disa me lloje autoktone të tilla si *Pinus strobus*, të tjera lloje aloktone të tilla si *Pinus nigra* dhe driza e butë. Këto lloje aloktone mbulojnë një sipërfaqe shumë të kufizuar, dhe mbizotërimi i llojeve të reja autoktone është i dukshëm. Zona të tilla duhet të monitorohen nga afër, për të informuar vendimet e ardhshme nëse duhet të lihen në gjendjen aktuale apo të shndërrohen në pyje me pemë autoktone.

Menaxhimi i kaluar i pyllit dhe praktikat e përdorimit kanë bërë që në ditët e sotme në PK të ketë 75.2% pyjeve me korije, kryesisht dushk, shkozë, dhe disa pyje me ah dhe gështenja.

Rritja mesatare vjetore është 1,86 m<sup>3</sup>/ha ndërsa rritja totale mesatare vjetore përlllogaritet të jetë 34,123 m<sup>3</sup>. Me një rritje relativisht kaq të ulët vjetore dhe prodhimin e drurit masiv, pyjet në parkun kombëtar kanë nevojë të madhe për restaurimin e habitatit. Në të njëjtën kohë, ata kanë një funksion të rëndësishëm shoqëror si burimi i interesit ekonomik për popullsinë lokale. Rreth 90% e prerjes vjetore është dru zjarri për Rajonin e Pollogut, si dhe një sasi e panjohur shtesë e nxjerrë përmes prerjes së jashtëligjshme.

Menaxhimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve për qëllime ekonomike kryhet në pajtim me Ligjin për Pyjet dhe me planet e posaçme 10-vjeçare për menaxhimin e pyjeve. Planet aktuale të menaxhimit të pyjeve përqendrohen në përdorimin ekonomik të pyllit si një burim, ndërsa praktikat e ardhshme të menaxhimit duhet të përqendrohen në ruajtjen e pyjeve ose menaxhimin e habitateve pyjore. Sipërfaqja totale e pyjeve është 18.332,11 ha, e ndarë në pesë njësi menaxhimi të pyjeve, secila me planin e vet të posaçëm 10-vjeçar të menaxhimit të pyjeve.

Tabela e mëposhtme tregon shtrirjen e njësive të menaxhimit të pyjeve dhe periudhave të vlefshmërisë së planeve të tyre të menaxhimit.

Njësia e Menaxhimit të Pyllit	Sipërfaqja pyjore (ha)	Vlefshmëria e planit të menaxhimit të pyjeve
Novo Selo 2 – Kodra e Diellit	1.925,70	2026
Shar Planina – Bistrica	5.653,10	2029
Lesnichka Shuma	2.287,03	2028
Ljubotenska Reka	1.519,58	2026
Duf – Mazdraça	6.946,70	2023

Njësia e Menaxhimit të Pyllit	Sipërfaqja pyjore (ha)	Vlefshmëria e planit të menaxhimit të pyjeve
<b>Totali</b>	<b>18,332,11</b>	

Në vitet e kaluara prerja vjetore ishte rreth 18,388 m<sup>3</sup>. Kjo duhet të reduktohet dukshën në PK.

Pasi të krijohet parku kombëtar duhet të kryhet një inventarizim i plotë pyjor dhe duhet të përgatitet një plan i ri për menaxhimin e pyjeve duke ndjekur parimet e ruajtjes së natyrës dhe në pajtim me zonimin e ZM-së:

- Asnjë ndërhyrje në zonën e mbrojtjes së rreptë, me përjashtimin të rasteve të jashtëzakonshme, me miratimin e MMJPH.
- Në zonën e menaxhimit aktiv lejohen ndërhyrjet në pyje nëse janë të planifikuara dhe miratuara në planin e posaçëm për mbrojtjen dhe kultivimin e pyjeve. Ndërhyrje të tilla duhet të lejohen nëse është e nevojshme për menaxhimin e habitatit dhe kur janë në përputhje me objektivat e ruajtjes. Këtu përfshihet kultivimi intensiv, kujdesi dhe rivitalizimi i pyjeve për të krijuar kushte për përmirësimin e strukturës së tyre dhe shndërrimin e tyre nga pyje me kërcell të ulët në pyje me kërcell të lartë;
- Nuk duhet lejuar asnjë prerje masive në zonën e përdorimit të qëndrueshëm. Veprimet që janë në pajtim me objektivat e ruajtjes së natyrës mund të kryhen nëse ato janë planifikuar dhe miratuar nga autoriteti menaxhues.

Prerja e pastër nuk lejohet në asnjë zonë të mbrojtur.

Derisa të përgatiten këto plane të posaçme të menaxhimit të pyjeve, duhet të miratohen masat e ndërmjetme. Këto duhet të marrin në konsideratë nevojat e popullsisë lokale për dru zjarri.

Paralelisht me këto përpjekje shërbimet e turizmit të zhvilluar mirë do të lejojnë që menaxhimi i parkut të përqendrohet në burime të tjera të ardhurash në vend të prerjes së drurëve.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i pylltarisë është parandalimi dhe menaxhimi i zjarreve në pyje. Zjarret mund të shpërndahen, për shembull, nga zonat e kullotave me fiere dhe dëllinja drejt pyjeve. Ato mund të përbëjnë një kërcënim serioz për ekosistemin e pyjeve, dhe meritojnë përparësi në menaxhimin e ardhshëm të parkut kombëtar.

### 3.3.2.3. Kafshët e egra

Gjuetia në Malet e Sharrit i përket shtetit. Si një e mirë e interesit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, natyra e egër gëzon mbrojtje të veçantë, në një mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara në Ligjet për Gjuetinë dhe Mbrojtjen e Natyrës.

51 lloje të gjitarëve shfaqen në PKMSH (58% e tyre të pranishëm më RMV), së bashku me 128 lloje shpendësh. Disa prej tyre konsiderohen për gjah, dhe dallimet bëhen ndërmjet gjitarëve të vegjël dhe atyre të mëdhenj të gjahut dhe shpendëve të gjahut.

Tabela e mëposhtme tregon llojshmërinë e natyrës së egër më të zakonshme në Malet e Sharrit (lista e plotë gjendet në kreun 3.4.1):

Statusi i mbrojtjes	Gjitarët e mëdhenj	Gjitarët e vegjël	Shpendët
Llojet e mbrojtura	Ariu i murrmë, rrëqebulli (Ballkanit)	Macja e egër, lundërza, vjedulla, gjeri, ketri i kuq	Shqiponja e malit, shqiponja e madhe e rosave, bufi i madh me veshë, bufi veshgjatë, shkaba, korbi sqepkuq, korbi sqepverdhë
Llojet me mbrojtje të përkohshme gjuetie	Kaprolli, derri i egër, dhia e egër	Lepuri	Pula me çafkë, thëllëza e malit, pëllumbi i egër i shkëmbit, shapka
Lloje pa mbrojtje	Ujku	Dhelpra e kuqe, kunadhja gushëverdhë, kunadhja gushëbardhë, qelbësi	Gjeraqina, korbi i bardhë/gallofi, stërqoka, laraska,

Territori i cili përfshin parkun kombëtar ndahet në shtatë zona gjuetie. Deri në vitin 2021 gjashtë prej tyre menaxhoheshin nga koncesionarët, ndërsa terreni shtetëror i gjuetisë menaxhohej nga Ndërmarrja Publike e Pyjeve Kombëtare. Secili nga terrenet e gjuetisë ende menaxhohet në bazë të një programi të përgatitur çdo vit për planin 10 vjeçar të posaçëm për menaxhimin e gjuetisë. Periudhat e vlefshme prej gjashtë prej planeve të menaxhimit të gjuetisë skadojnë në fund të vitit 2021, ndërsa ai për terrenin shtetëror të gjuetisë skadoi në fund të vitit 2018.

Tabela e mëposhtme tregon numrin e gjahut të numëruar në këto zona gjuetie në vitin 2018. Në bazë të Studimit për Valorizimin:

Gjah nën mbrojtje		Numri i kafshëve të numëruara
1.	Kaprolli	482
2.	Dhia e egër	394
3.	Derri i Egër	185
4.	Ariu	36
5.	Rrëqebulli	5
Gjah i numëruar pa mbrojtje		Numri i kafshëve
1.	Ujku	37

Me shpalljen e zonës park kombëtar autoriteti i ri i menaxhimit është përgjegjës për menaxhimin e natyrës së egër, duke përfshirë asgjësimin selektiv të kafshëve. Autoriteti i parkut kombëtar duhet të përgatisë një plan menaxhimi të posaçëm për natyrën e egër i cili ndjek parimet e ruajtjes së natyrës dhe është në pajtim me zonimin:

- Asnjë ndërhyrje në zonën e mbrojtjes së rreptë.
- Ndërhyrjet në zonën e menaxhimit aktiv duhet të konsiderohen si të pranueshme kur ato janë të domosdoshme për menaxhimin e llojeve dhe kur janë në pajtim me objektivat e ruajtjes (ushqyerja në dimër, krijimi i qendrës riprodhuese, asgjësimi selektiv në rast sëmundjesh, etj).
- Asgjësimi selektiv do të lejohet në zonën e qëndrueshme për të kontrolluar numrin e kafshëve që mund të shkaktojnë dëme ndaj tokës bujqësore dhe fshatrave.

Disa veprimtari përfshijnë numërimet e përvitshme, ushqyerjen në dimër, monitorimin dhe kontrollin e veprimtarive të paligjshme që duhet të kenë përparësi në periudhën kalimtare derisa të përgatitet një plan menaxhimi për natyrën e egër

Pavarësisht kushteve potencialisht të favorshme të riprodhimit për disa nga llojet e përmendura, në krahasim me parqe të tjera në Evropë dendësitë e popullatave të tyre janë të ulëta. Gjuetia e paligjshme ka të ngjarë të jetë shkaku kryesor dhe kontrolli i saj duhet të jetë i prioritetit më të lartë për menaxhimin e Parkut. Rojet e pyllit me përvojë në menaxhimin e natyrës së egër, në bashkëpunim me policinë pyjore, duhet të jenë përgjegjës për këtë. Numri i kafshëve të egra duhet të ketë mundësinë të rritet në mënyrë natyrore. Disa aktorë propozuan krijimin e qendrës së riprodhimit të dhisë së egër në Leshnicë.

#### 3.3.2.4. Mbledhja e bimëve dhe frutave të egra

Mbledhja e bimëve dhe frutave të egra, duke përfshirë bimët mjekësore dhe kërpudhat, është një praktikë tradicionale ende mjaft e përdorshme në Malet e Sharrit. Gjenden të paktën 51 lloje bimësh dhe kërpudhash të panumërta që mbledhen për qëllime tregtare brenda parkut.

Mbledhja e të dhënave për popullatat e llojeve të egra, si dhe monitorimi i popullatave të llojeve të egra që mbledhen, duhet të kryhet në mënyrë të rregullt, duke mundësuar në këtë formë vendimet e bazuara në prova për përdorimin e ardhshëm të këtyre llojeve.

Lloje të shumta (disa prej tyre të mbrojtura në bazë të ligjit kombëtar) kërkojnë **monitorim të përhershëm** për të parandaluar rrezikimin e popullatave përmes mbledhjes:

- Bimët: *Achillea millefolium*, *Artemisia absinthium*, *Chamomilla recutita*, *Cornus mas*, *Corylus avellana*, *Galium verum*, *Gentiana lutea*, *Juglans regia*, *Juniperus communis*, *Origanum vulgare*, *Primula veris*, *Sideritis scardica* (e mbrojtur) dhe *Vaccinium myrtillus*.
- Kërpudhat: *Agaricus capmestris*, *Amanita cesarea* (e mbrojtur), *Boletus edulis*, *Calocube gambosa*, *Cantharellus cibarius* and *Macrolepiota procera* (e mbrojtur).

Bimët dhe frutat e egra mbledhen për përdorime vetjake dhe tregtare. Mbledhja për konsum vetjak, prej më pak se 1 kg për individ, duhet të lejohet pa pasur nevojë për leje. Megjithatë, lejet për mbledhjen për qëllime tregtare duhet të jepen nga autoriteti i menaxhimit.

Kuotat e mbledhjes për të gjitha llojet e mbledhura për qëllime tregtare duhet të përcaktohen në bazë të vlerësimeve të burimeve dhe monitorimit. Mbledhësit janë kryesisht individë nga familje me të ardhura të ulëta dhe kanë shumë pak mundësi ekonomike. Vetëm në raste të rralla produktet e mbledhura përpunohen në mënyrë që të kërkohet çmim më i lartë.

Kompanitë lokale të ndodhura në qytetet pranë, i blejnë, tregëtojnë dhe përpunojnë bimët dhe kërpudhat e mbledhura, dhe kanë rrjetet përkatëse dhe strukturat organizative. Këto duhen marrë në konsideratë kur përcaktohen lëshimet për mbledhjen. Një opsion tjetër i përmendur gjatë takimeve të konsultimit me palët e përfshira ishte se autoriteti i parkut

kombëtar mund të organizojë blerjen, përpunimin, tegëtimin dhe shitjen e këtyre produkteve, për të siguruar një treg të qëndrueshëm për mbledhësit si dhe të ardhura për parkun kombëtar.

Shumica e mbledhësve veprojnë pa leje për mbledhje, dhe nuk dihet nëse ata i kanë të njohura principet për mbledhjen e qëndrueshme. Parku kombëtar duhet të ofrojë trajnime për këtë çështje ndaj mbledhësve dhe duhet të sigurojë monitorimin e biodiversitetit. Ka të dhëna se disa mbledhës hyjnë në PKMSH nga Kosova për të mbledhur pemë dhe fruta të egra. Bashkëpunimi ndërmjet PKMSH dhe PK Sharri, me përfshirjen e policisë kufitare të pyjeve, do të jetë një parakusht për menaxhimin efektiv.

Mbledhja e bimëve, frutave të egra dhe kërpudhave lejohet në zonat e përdorimit të qëndrueshëm dhe të menaxhimit aktiv, dhe ndalohet në zonën e mbrojtjes së rreptë, me përjashtim të konsumit vetjak. Duhet të mbështetet edhe kultivimi lokal, si pjesë e përpjekjeve për ruajtjen e atyre bimëve që mbledhen të egra në sasi të mëdha, por që mund të kultivohen.

#### 3.3.2.5. Bletaria

Informacioni për bletarinë është i disponueshëm për shtatë komunat brenda të cilave ndodhet PK. Në këtë zonë ka 422 bletërritës të regjistruar me 11,684 koshere, të cilat përbëjnë rreth 11% të koshereve në Maqedoninë e Veriut.

Duke marrë parasysh që bletaria siguron si të ardhura për ekonominë lokale ashtu edhe shërbime të vlefshme të ekosistemit, mbështetja duhet t'i sigurohet bletërritësve lokalë. Kjo mund të bëhet përmes vendosjes së markës për produktet e apikulturës, mbështetje për ngjarje që promovojnë produkte të tilla nga parku, etj. Ka gjithashtu potencial për të zhvilluar dhe promovuar api-turizmin përmes parkut kombëtar, i cili do të ishte një burim të ardhurash si për ekonominë lokale ashtu edhe për parkun. Meqenëse kosheret janë të pozicionuara në prona private, masat dëmshpërblyese për dëmin e shkaktuar nga natyra e egër duhet të vihen në zbatim në zonat e përdorimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit aktiv.

#### 3.3.2.6. Peshkimi

Prania e Troftës Maqedonase, *Salmo macedonicus*, në rrjedhat dhe lumenjtë malorë të PKMSH siguron mundësinë për turizmin e peshkimit. Meqenëse shumë pak dihet për llojet në këtë zonë, duhet të kryhet monitorim i kujdesshëm për të siguruar informacionin e nevojshëm për vendimet e ardhshme të bazuara në të dhëna.

Mbajtësit e koncesioneve janë përgjegjës për zbatimin e Planit të Posaçëm të Menaxhimit për peshkimin në Pellgun e Rrjedhës së Sipërme të Vardarit, gjatë periudhës së vlefshme të tij” (2016-2022). Pas përfundimit të afatit të këtij plani, parku kombëtar duhet të përgatisë një Plan të ri të Posaçëm Menaxhimi për peshkimin për periudhën 2022-2032, në pajtim me veprimtaritë e lejuara dhe të ndaluara në zonë e mbrojtur. Peshkimi mund të lejohet vetëm për ato lumenj në zonën e menaxhimit të qëndrueshëm, dhe më tej vetëm për kapje dhe lëshim. Introdiktimi (futja) e peshqve në lumenj dhe liqene të PKMSH ndalohet.

### 3.3.3. Infrastruktura dhe zhvillimi

#### 3.3.3.1. Infrastruktura rrugore

Rritja e popullsisë brenda zonës së zgjeruar që tashmë përbën parkun gjatë 20 viteve të kaluara ka rezultuar në rritje të ndërtimeve. Pavarësisht se vendbanimet e popullsisë kryesore



janë të shpërndara dhe mbulojnë zona relativisht të vogla, zhvillimi i ardhshëm duhet të kryhet në bazë të zonimit të vendosur, në mënyrë që të shmangen pasojat e dëmshme për biodiversitetin.

Shumë prej vendbanimeve në Malet e Sharrit janë pjesë e rrjetit të rrugëve të shtruara (asfaltuara), që lidh qytetet dhe fshatrat e thella. Disa prej rrugëve ndërmjet, dhe në raste të rralla brenda, fshatrave, janë të pashtuara.

Shumica e tyre gjenden në zona të thella, veçanërisht pranë kufirit me Kosovën, dhe përdoren kryesisht për transportimin e drurit, vajtjen në stanet lart në male, dhe turizmin. Këto zona mund të jenë të vështira për t'u arritur pothuajse gjatë të gjithë vitit, ndërsa në dimër rrugët malore lokale mund të bllokohen nga dëborat. Mirëmbajtja e rrugëve kryhet nga ndërmarrja publike kompetente për rrjetin rrugor kombëtar me fondet dhe të ardhurat e veta. Mirëmbajtja e rrugëve rurale në dimër aktualisht nuk përbën një prioritet të madh dhe menaxhimi i parkut kombëtar duhet të mbështesë aksesin ndaj rrugëve gjatë të gjithë vitit për popullsinë lokale.

Zonat urbane, Tetovë dhe Gostivar, lidhen përmes autostradës A27, pjesë e rrjetit rrugor kombëtar. Rruga e vjetër Tetovë-Gostivar, R12068, lidh Tetovën, Bogovinjen, Vrapçishtën dhe Gostivarin. Rruga R12039 lidh Tetovën me komunat e Tearcës dhe Jegunovcës, si dhe kalimin kufitar me Republikën e Kosovës. Tearce lidhet me Jegunovcën përmes rrugës R2234.

Qendra e skijimit Kodra e Diellit është i lidhur mjaft mirë me Tetovën përmes rrugës rajonale 1209. Prania e lidhjeve me hekurudhën dhe aeroportin janë gjithashtu të rëndësishme në kontekstin e turizmit.

Rrjeti hekurudhor në rajon përbëhet nga linja lokale që lidh Kërçovën, Gostivarin dhe Tetovën me Shkupin, dhe pjesa e korridorit të hekurudhës ndërkombëtare që lidh Shkupin me Prishtinën. Aeroportet më të afërta gjenden në Shkup dhe Fushë Kosovë pranë Prishtinës.

Pavarësisht rrjetit të zhvilluar të rrugëve, parkimi i kufizuar në rezortin e skive në Kodra e Diellit kufizon mundësitë e rezortit për zhvillim. Ka një nevojë të ngutshme për rinovimin e teleferikut që lidh qendrën e skijimit me qendrat urbane.

Projektet për zhvillimin dhe infrastrukturën përbëjnë kërcënime të mundshme për biodiversitetin. Pasojat e dëmshme të një zhvillimi të tillë përfshijnë shkatërrimin dhe fragmentimin (copëzimin) e habitateve, përmes zgjerimit të infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimit të asaj të re (rrugët, rryma elektrike, uji dhe instalimet e telekomunikacionit, etj.), përvetësimin në rritje të burimeve natyrore (veçanërisht uji) dhe ndotjen (mbetjet inerte nga ndërtimet, ujërat e zeza, ndotja e ajrit dhe ndotja akustike, eutrofikimi, etj.). Këshillohet fuqimisht që çdo zhvillim i rrugës në të ardhmen të kryhet në përputhje me zonimin e parkut

### *3.3.3.2. Furnizimi me rrymë elektrike*

Në bazë të kërkimit të kryer për Analizën Socio-Ekonomike në vitin 2020, të gjithë fshatrat në Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit lidhen me rrjetin e rrymës elektrike.

### *3.3.3.3. Furnizimi me ujë*

Shumica e fshatrave në PKMSH kanë akses ndaj ujit të pijshëm. Kjo ndodh kryesisht nga burimet, pavarësisht se disa fshatra përdorin ujë sipërfaqësor ose puse nëntokësore për të nxjerrë ujin e pijshëm. Qyteti i Tetovës merr gjithashtu ujin e pijshëm nga Malet e Sharrit, nga burimet e Draga Voda, Golemi, Vakufski dhe Uliveriçki. Burimi Draga Voda siguron gjithashtu ujë të pijshëm për fshatin e Gajres.

#### *3.3.3.4. Ujërat e zeza dhe kanalizimet*

Fshatrat dhe vendbanimet në PKMSH nuk janë të lidhura me infrastrukturën e kanalizimeve dhe kryesisht përdorin gropa septike. Ndërtimi i kanalizimeve dhe infrastruktura e trajtimit të ujërave të zeza është e rëndësishme së veçantë dhe përparësi duhet t'u jepet vendbanimeve më të mëdha duke përfshirë Rezortin e Skive, vendbanimeve për fundjavë dhe fshatrave më të mëdha.

Qytetet e Tetovës dhe Gostivarit kanë një sistem kanalizimesh, nga të cilat ujërat e ndotura dhe të zeza futen në lumin Vardar të patrajtuara.

#### *3.3.3.5. Cilësia e ujit*

Çështja e cilësisë së ujit është ngritur në takime të shumta me banorët lokalë dhe përfaqësuesit e komunave, pavarësisht se Malet e Sharrit kanë mjaft ujë të pastër të rrjedhshëm.

Menaxhimi i parkut kombëtar duhet të mbështesë fshatrat malore në përmirësimin e furnizimit me ujë, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitat dhe ndërmarrjet publike përkatëse.

#### *3.3.3.6. Mbetjet e ngurta*

Shkarkimi i pakontrolluar dhe i paligjshëm i mbetjeve të ngurta është një problem i menjëhershëm dhe i ngutshëm për mjedisin, si dhe në kontekstin e zhvillimit të turizmit në parkun kombëtar. Nga 27 fshatra brenda parkut, vetëm shtatë kanë grumbullim të organizuar të mbetjeve të ngurta (të zonës). Për më tepër, mbeturinat mbledhen shumë rrallë nga zonat kryesore të piknikut dhe ato turistike, duke përfshirë qendrën e skijimit, Belovishtë dhe Tri Vode.

Secila nga shtatë komunat brenda parkut (Bogovinjë, Gostivar, Jegunovcë, Mavrovë dhe Rostushë, Tearcë, Tetovë, dhe Vrapçishtë) janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve brenda kufijve të tij, duke kontraktuar kompani të specializuara. Gjatë konsultimeve me aktorët e përfshirë, banorët nga fshatrat malore parashtruan ankesat e tyre për performancën e ulët të këtyre kompanive.

Mbështetje duhet të sigurohet nga parku kombëtar për të përmirësuar këtë situatë, veçanërisht në fshatrat e thella malore.

#### *3.3.3.7. Infrastruktura sociale*

Nuk ka asnjë kopsht fëmijësh brenda territorit të PK, pavarësisht se ka shkolla fillore. Shkollat e mesme gjenden në Tetovë dhe Gostivar, si dhe një në Komunën e Vrapçishtës. Komunitat organizojnë transportin për nxënësit nga fshatrat të cilat nuk kanë shkolla.

Në Tetovë dhe Gostivar ka universitete. Dy universitetet në Tetovë janë të dy shtetërorë, ai i Gostivarit është institucion privat.

Qendrat shëndetësore janë të përqendruara në Tetovë dhe Gostivar. Ka një spital të përgjithshëm në Gostivar, dhe një klinikë, një institut të kujdesit shëndetësor dhe një spital për sëmundjet respiratore në Tetovë. Qendrat e ndihmës së shpejtë gjenden në fshatrat e mëdha brenda parkut kombëtar, duke përfshirë ato në Vejce, Novo Selo, Shipkovicë.

Klinikat dentare janë të përqendruara në qytetet e Tetovës dhe Gostivarit, dhe gjithashtu gjenden edhe në Komunitat e Bogovinjes, Tearcës dhe Jegunovcës.

Kujdesi social ofrohet përmes qendrave sociale Komunale dhe Ndërkomunale në Gostivar dhe Tetovë.

Nuk ka asnjë qendër kulturore apo artistike në PKMSH, dhe qendrat sportive janë të pakëta dhe gjenden vetëm në fshatrat e Selcës dhe Shipkovicës.

#### *3.3.3.8. Infrastruktura industriale, energjetike dhe minerare*

Që në vitet e 70-ta, lumenjtë e Maleve të Sharrit janë përdorur për prodhimin e rrymës elektrike përmes sistemit të mbledhjes së ujërave Sharski Vodi, i cili mbledh ujin nga një numër i lumenjve dhe e transporton atë në rezervuarin e Mavrovës dhe në hidrocentralet e Vrutokut, Ravenit dhe Vrbenit. Kjo infrastrukturë siguron afërsisht 12% të energjisë elektrike të Maqedonisë së Veriut.

Është veçanërisht me rëndësi në rastin e ndërprerjeve të rrymës elektrike, meqenëse ai është i pavarur nga rryma elektrike dhe mund të prodhojë energji elektrike vetëm në bazë të rrjedhjes së ujit. Meqenëse funksionimi i tij përbën interes kombëtar dhe publik, të gjitha zonat lejohen që ta mirëmbajnë.

Parku kombëtar do të krijojë një mekanizëm për bashkëpunimin me AD ESM, organin e menaxhimit të sistemit Sharski Vodi, duke përfshirë përcaktimin e rregullave që do të sigurojnë mirëmbajtjen e infrastrukturës pavarësisht zonimit.

Brenda parkut ka 11 hidrocentrale të vogla. Disa të tjera në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm janë në proces ndërtimi, të cilat duhet të përfundojnë deri më datë 30 qershor 2022, një vit pas miratimit të ligjit për shpalljen e parkut kombëtar. Ndërtimi i hidrocentraleve të tjera të vogla në park nuk do të lejohet.

Autoriteti kombëtar do të monitorojë rregullisht ndikimin e hidrocentraleve të vogla në mjedis dhe komunitetet lokale, përmes programit për monitorimin e shkarkimit ekologjik minimal.

Lista e hidrocentraleve të vogla të ndërtuara dhe të planifikuara me status që nga janari 2021 është bashkangjitur në Shtojcën 7.3.

Deri në momentin e përgatitjes së këtij dokumenti, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është në proces të rishikimit dhe ndryshimit të koncesioneve të dhëna për hidrocentrale brenda kufijve të ZM .

Pas përfundimit të procesit të rishikimit, administrata e ZM, në koordinim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pritet të inkorporojë çdo ndryshim në listën e objekteve hidroenergjetike të njohura ligjërisht brenda ZM dhe të zbatojë dhe zbatojë rregulloret përkatëse të ZM për të gjithë. koncesionarët, në përputhje me atë që përcaktohet në rregulloret e AP dhe legjislacionin kombëtar.

#### *3.3.4. Trashëgimia kulturore*

Trashëgimia kulturore brenda PKMSH i shton vlerën zonës së mbrojtur, dhe mund të sjellë dobi në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, ose madje edhe të kontribuojë në zhvillimin e markës turistike të PKMSH.

Legjislacioni përcakton tre lloje të trashëgimisë kulturore: trashëgimi kulturore e patundshme, e tundshme dhe jo materiale, nga të cilat trashëgimia kulturore e patundshme

dhe ajo jo materiale janë identifikuar brenda ZM, pavarësisht se trashëgimia kulturore e tundshme nuk duhet përjashtuar aktualisht.

Trashëgimia kulturore e patundshme e identifikuar brenda PKMSH përmban kryesisht: 1. Zona arkeologjike, të tilla si vendbanimet dhe nekroplet nga antikiteti ose mesjeta; dhe 2. Tempujt dhe kultet, si krisitane ashtu edhe muslimane. Peizazhe kulturore përfshihen gjithashtu në këtë kategori pavarësisht se ato ende nuk janë identifikuar dhe vlerësuar zyrtarisht. Kullotat malore janë një lloj i peizazhit kulturor i cili meriton mbrojtje dhe mirëmbajtje, në njohje të lidhjes së tyre të pazgjidhshme me blegtorinë tradicionale në shkallë të gjerë të deleve.

Në të gjithë fshatrat malore spikat një stil i veçantë arkitekturor, i karakterizuar nga përdorimi i materialeve tradicionale ndërtimore të tilla si gurë, dru, kashtë dhe baltë. Materiale të tilla ulin ndikimin mjedisor të ndërtimit. Për të ruajtur karakterin autentik të parkut kombëtar, është e udhës të përdoret material ndërtimi tradicional kurdo që të jetë e mundur, dhe duhet të kërkohet në rastin e çdo rinovimi në zonën e menaxhimit aktiv.

Pavarësisht se shumë elementë të trashëgimisë kulturore jo materiale janë të pranishme në PKMSH, vetëm një është regjistruar zyrtarisht: kënga e burrave me dy zëra në zonën e Fushëgropës së Pollogut, e njohur në zonë si Gllasoëçko. Kjo, së bashku me elementë të tjerë kulturorë jo materialë të tillë si zakonet tradicionale dhe fetare, mund të jenë të vlefshëm në promovimin e ZM si një destinacion turistik.

Ruajtja dhe vazhdimësia e trashëgimisë kulturore të ZM-së duhet të ketë qasje në bashkëpunim me institucionin kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Mbështetja dhe inkurajimi ndaj humumtimit të mëtejshëm të trashëgimisë kulturore, dhe madje edhe veprimtaritë për të rritur vizibilitetin e saj, mund të merren gjithashtu në konsideratë.

Ka një histori të gjatë për ngjarjet kulturore lokale dhe rajonale në park dhe në rajonin përreth tij. Secila nga komunat, dhe pothuajse çdo fshat ka festivalet dhe ngjarjet e veta në lidhje me pushimet fetare. Këto mund të përbëjnë bazat për ofertat e pasura kulturore ndaj vizitorëve. Në bashkëpunim me popullsinë lokale, parku kombëtar do të mbështesë identifikimin, organizimin dhe promovimin e ngjarjeve/festiveleve dhe veprimtarive tradicionale të cilat mund të tërheqin më shumë turistë.

Masa të veçanta kërkohen për ruajtjen e siteve të trashëgimisë kulturore, p.sh. tempujve. Detajet e hollësishme për këto site janë paraqitur në Studimin për Valorizimin dhe në studimin socio-ekonomik. Ky plan i menaxhimit përfshin një program të posaçëm i cili do të hartëzohë, identifikojë dhe përcaktojë masat e mbrojtjes.

### 3.3.5. Rekreacioni dhe turizmi

Natyra e pasur, gjeografia, dhe peizazhet, të shoqëruara nga trashëgimia kulturore, traditat dhe ngjarjet kulturore të PKMSH sigurojnë një bazë të shëndoshë për zhvillimin e turizmit dhe atraksioneve për vizitorët. Zona është tashmë një destinacion i njohur gjatë të gjithë stinëve për veprimtari të shumëllojshme. Ka një numër të strukturave akomoduese ekzistuese, si dhe ofruesve të shërbimeve turistike dhe në vitet e fundit në zonë vërehet një prirje për rritjen e numrit të vizitorëve.

Turizmi konsiderohet si sektori kryesor për zhvillimin ekonomik, dhe i vetmi me potencialin më të madh. Duke marrë në konsideratë infrastrukturën ekzistuese, mund të përcaktohen dy

lloje kryesore të turizmit brenda PK-së: turizmi masiv dhe turizmi alternativ. Strukturat e turizmit masiv janë përqendruar në brezin e mbrojtjes, ndërsa format alternative të turizmit praktikohen brenda parkut, në të trija zonat së bashku. Turizmi alternativ mund të ndahet më tej në turizmin e aventurës, atë rural dhe turizmin e soditjes së natyrës së egër (kafshëve të egra). Në mbështetje të zhvillimit secili prej tyre do t'i sjellë dobi jetesës lokale dhe do të ndihmojë në shpërndarjen e ndikimeve turistike në mënyrë më të njëtrajtshme.

Të gjitha format e turizmit duhet të sigurojnë qëndrueshmërinë dhe përgjegjësinë në pajtim me zonimin e përcaktuar dhe rregulloret. Megjithatë, vizioni afatgjatë i parkut kombëtar është të mbështesë çdo formë të turizmit i cili ka ndikim të ulët në mjedis dhe ruan barazpeshën ndërmjet turizmit masiv dhe atij alternativ. Për të dyja format kryesore të zhvillimit të mundshëm të turizmit, është thelbësore ruajtja e natyrës. Ruajtja e natyrës do të ishte e mundur vetëm nëse të gjithë aktorët do të krijojnë një bashkëpunim të mirë me parkun kombëtar dhe ndërmjet njëri tjetrit.

### 3.3.5.1. Turizmi masiv

Qendra e skijimit “Kodra e diellit” është destinim i turizmit masiv, i cili përfshin një dendësi të madhe të shtëpive të pushimit dhe një numër të madh hotelesh.

Për të lejuar zhvillimin e ardhshëm të qendrës së skijimit dhe veprimtarive të tjera ekzistuese ekonomike, është krijuar brezi i mbrojtjes përreth zonës potenciale për zhvillimin e qendrës (në bazë të masterplanit të vitit 2012).

Çdo zhvillim i mëtejshëm i qendrës së skijimit Kodra e Diellit kërkon zgjidhje për transportin e turistëve të skijimit nga Tetova në qendrën e skijimit, sepse zona e qendrës së skijimit ka shumë pak kapacitet për parkimin e veturave të turistëve. Qendra e skijimit, është e nevojshme përmirësimi i grumbullimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta.

### 3.3.5.2. Turizmi alternativ – i Aventurës

Shumë lloje të ndryshme të veprimtarisë së turizmit të aventurës janë identifikuar në parkun kombëtar, në Studimin për Valorizimin dhe Studimin Socio-ekonomik. Disa prej tyre janë mjaft të njohur, ndërsa të tjerë praktikohen vetëm nga një numër njerëzish.

Tabela kryesore paraqet një pamje të përgjithshme të sporteve më interesante të aventurës, ku ato ushtrohen, ndikimet dhe vlerësimet e tyre në mjedis dhe interesat për zhvillimin e tyre në të ardhmen.

Legjenda për ndikimin: 1 = i ulët; 2 = i mesëm; 3 = i lartë

Veprimtaria	Popullariteti / interesi	Sezoni	Zona	Vendodhja	Ndikimi i llogaritur në mjedis
Ski alpinizmi	I lartë	Dimër	I kufizuar në brezin e mbrojtjes	Vendodhje të caktuara	1
Turne Skish (udhëtim me ski)	I lartë	Dimër	Të gjithë zonat	Sipërfaqe e gjerë dhe vendodhje të caktuara	1
Ngjitje	I lartë	Të gjithë stinët	Të gjithë zonat	Territor i gjerë dhe	1

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit për periudhën 2022-2031

Veprimtaria	Popullariteti / interesi	Sezoni	Zona	Vendodhja	Ndikimi i llogaritur në mjedis
				vendodhje të caktuara	
Kalërim	I mesëm, me mundësi rritjeje	Pranverë, verë dhe vjeshtë	Kryesisht në zonat aktive dhe të qëndrueshme.  Në raste të veçanta në zonën e mbrojtjes së rreptë – kryesisht për të transportuar furnizime në stane	Vendodhje të caktuara	1
Çiklizëm malor	Mesatar, me mundësi rritje	Pranverë, verë dhe vjeshtë	Kryesisht në zonën aktive dhe të qëndrueshme. Në raste përjashtimi në zonën e mbrojtjes së rreptë	Vendodhje të caktuara	1
Vrapim malor	Mesatar, me mundësi rritjeje	Pranverë, verë dhe vjeshtë	Të gjithë zonat	Vendodhje të caktuara	1
Slita motorike dëbore	I lartë	Dimër	Kryesisht në brezin e mbrojtjes por gjithashtu edhe në zona të tjera	Territor i gjerë	3
Drejtimi i automjeteve 4 x 4 (fuoristradë)	I lartë	Të gjithë stinët	Të gjithë zonat	Territor i gjerë	3
Hedhje me parashutë	I ulët, me mundësi rritjeje	Kryesisht verë	Kryesisht në brezin e mbrojtjes	Territor i gjerë	1
Udhëtim me makinë e skive/Ski të stilit të lirë	I lartë	Në dimër	Të gjithë zonat	Vendodhje të caktuara	3

Veprimtaria	Popullariteti / interesi	Sezoni	Zona	Vendodhja	Ndikimi i llogaritur në mjedis
Ecje sportive në dëborë	I ulët	Në dimër	Të gjithë zonat	Territori i gjerë	1
Shpelleologji	I ulët	Kryesisht verë	Të gjithë zonat	Vendodhje të caktuara	1
Alpinizëm	I ulët	Kryesisht dimër	Në zonën e mbrojtjes së rreptë	Vendodhje të caktuara	1

Disa veprimtari dimërore si udhëtim me ski dhe ecje në dëborë kryhen në një territor të gjerë dhe kanë një ndikim të ulët në mjedis. Veprimtari të njohura verore si ngjitje, ciklizëm malor dhe kalërim duhet të ndjekin shtigjet dhe rrugët e shënuara. Duhet të zhvillohet një sistem i shtigjeve si pjesë e programit turistik në mënyrë që të shmangen rreziqet e mundshme dhe konfliktet ndërmjet përdoruesve të ndryshëm.

Veprimtaritë e kryera në vendodhjet e caktuara zakonisht mbështeten në natyrë, ku një tipar i veçantë gjellogjik përdoret për një qëllim të caktuar. Veprimtari të tilla, që përfshijnë shpelleologjinë (vizitat në shpella), ngjitjen alpinistike dhe ngjitjen e shkëmbinjve mund të përbëjnë kërcënime ndaj habitateve të caktuara, dhe vlerësimi i kujdesshëm duhet të bëhet përpara se ato të lejohen. Hedhja me parashutë mund të konsiderohet gjithashtu një veprimtari me vendodhje të caktuar, ku pika e ngritjes është në zonën e menaxhimit aktiv.

Veprimtaritë e turizmit kufitar me PK Sharri të Kosovës duhet të bashkërendohen përmes policisë kufitare, dhe në pajtim me veprimtaritë e lejuara në zona të ndryshme të PKMSH. Disa prej veprimtarive të tilla të turizmit kufitar kërkojnë struktura akomoduese të shoqëruara me rregullat ndërkombëtare në bazë të kabinës së sigurisë brenda harkut kohor të 4 orëve ecje.

Promovimi i zonës së re të mbrojtur duhet të ecë paralelisht me përpjekjet për të rritur reputacionin e saj si një destinacion i sigurt turistik. Një nga shqetësimet kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit të aventurës është nevoja për një shërbim funksional shpërtimi, jo vetëm në rezortin e skive por gjithashtu për të mbuluar të gjithë parkun kombëtar.

### 3.3.5.3. Turizmi alternativ – rural dhe ekoturizmi

27 fshatrat brenda parkut kombëtar, të gjithë të pozicionuar në zonën e menaxhimit të qëndrueshëm, ofrojnë mundësi të mëdha për zhvillimin turistik. Kjo është madje edhe më e rëndësishme për ato fshatra me popullsi në rënie.

Turizmi rural dhe ekoturizmi mund të shërbejnë si kundërpeshë ndaj turizmit masiv, dhe të ulin trysnitë mjedisore të shkaktuara nga rezorti i skive “Kodra e Diellit”.

Ata që kërkojnë këtë lloj turizmi kërkojnë ajrin e pastër, rrethinat e qeta, ushqimin dhe shërbimet lokale. Fshatrat e Maleve të Sharrit ofrojnë mundësi të panumërta eko-turistike, megjithatë, industria lokale është në fazën e saj të hershme të zhvillimit me vetëm një numër të kufizuar familjesh që ofrojnë shërbime akomoduese dhe turistike.

Është e rëndësishme që parku kombëtar të mbështesë popullsinë lokale me masat për të inkurajuar zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve të tyre, veçanërisht në fshatra të thella me shumë pak banorë. Mbështetje dhe bashkëpunim i tillë me banorët lokalë duhet të rezultojë në sinergji të panumërta që kontribuojnë në përpjekjet për ruajtjen e natyrës.

#### *3.3.5.4. Turizmi alternativ – soditja e natyrës së egër (kafshëve të egra)*

Natyra e egër (kafshët e egra) është motivi kryesor për grupe të vogla por të mirë-krijuara të turistëve, i përqendruar përreth soditjes së kafshëve dhe habitateve të tyre natyrore. Shumëllojshmëria e kafshëve të egra në PKMSH nënkupton turizmin soditës.

Aktualisht kryhet turizëm për gjueti. Duke e zëvendësuar këtë me turizmin për soditjen e natyrës së egër do të krijohet mundësia që parku të ofrojë përvoja tërheqëse për vizitorët, dhe t'i edukojë dhe t'i përfshijë ato në monitorimin e natyrës së egër ndërkohë që gjeneron të ardhura.

#### *3.3.5.5. Infrastruktura turistike*

**Strukturat akomoduese** në PKMSH përqendrohen kryesisht në Kodra e Diellit. Ky rezort ka shtatë hotele, me rankimet e rehatisë nga një deri në katër yje. Kasolle malore, hostele dhe shtëpi familjare, gjenden gjithashtu, të shpërndara anekënd parkut kombëtar.

**Strukturat e kampingjeve** në PKMSH nuk kanë një pozicionim të zyrtarizuar, megjithatë, ka zona të shumta të njohura për kamping (në natyrën e egër) që përdoren kryesisht nga alpinistët dhe ngjitesit e malit. Këto zona kampingu janë aktive kur organizohen ngjarje. Ka gjithashtu zona kampingu të vogla të improvizuara verore në zonat e larta malore, kryesisht pranë liqeneve dhe burimeve malore, shpesh në zonën e mbrojtjes së rreptë. Kampingjet gjithashtu kryhen në dimër, në lidhje me veprimtaritë dimërore sportive. Terrenet e përcaktuara dhe të mirëmbajtura për kamping do të lejonin menaxhim më të mirë të praktikës së krijuar të kampingut në natyrën e egër në PKMSH.

**Rrugët e pashtuara** në PKMSH nuk menxhohen, dhe shumë janë krijuar pa autorizim, për veprimtari të ndryshme. Këto rrugë mund të përdoren për veprimtari të ndryshme turistike, po ashtu duhet të parashikohet kontrolli i erozionit dhe mirëmbajtja.

**Shtigje për ngjitje** në PKMSH janë të vetmet shtigje zyrtare të zhvilluara dhe të shënuara në pajtim me Ligjin për Shtigjet Malore. Ka 24 shtigje zyrtare për ngjitje me një gjatësi totale prej 303 km. Shtigje të reja për ngjitje janë parashikuar në planet e zhvillimit komunal, të tilla si ai i Komunës së Bogovinjes, i cili planifikon të ndërtojë tre shtigje shtesë. Mirëmbajtja e këtyre do të ndihmojë në inkurajimin e ngjitesve për të ruajtur shtigjet e përcaktuara dhe të mos sorrollaten në zonat ku ato mund të shqetësojnë proceset natyrore dhe natyrën e egër.

**Shtigjet për ciklizmin malor** në PKMSH nuk janë të përcaktuara. Megjithatë, ciklistët malorë zakonisht përdorin korsi të shumta të cilat mund të konsiderohen si korsi shumëfunktionale. Këto kryesisht ndjekin rrugë të gjera të pashtuara, por edhe monopate të ngushta malore. Sigurimi i shtigjeve të përcaktuara dhe/ose rrugëve shumëfunktionale ku lejohet ciklizmi malor do të ndihmojë të zhvillohet turizmi i ciklizmit malor në PKMSH, dhe do të parandalojë gjithashtu konfliktet për përdorimin e shtigjeve ndërmjet ciklistëve malorë dhe përdoruesve të shtigjeve të tjera.



### 3.4. Vlerat e zonës

#### 3.4.1. Llojet

Nëndarjet e mëtejme paraqesin llojet e njohura që shfaqen në Malet e Sharrit, me nivelin e tyre të mbrojtjes dhe statusin e ruajtjes.

Përshkrimet e gjera të faunës dhe florës së zonës paraqiten në Studimin për Valorizimin. Expertë të shumtë përkushtuan njohuritë e tyre në këtë studim në mënyrë që të kontribuojnë në ruajtjen e llojeve, habitateve dhe peizazheve.

Mbrojtja paraqitet në lidhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare, konventat dhe listën e kuqe:

- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës në Maqedoninë e Veriut, bazuar në Listën kombëtare të llojeve të egra të mbrojtura (rreptësisht) (2011)
- Konventa e Bernës
- CITES (Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër, Konventa e Uashingtonit)
- Lista e Kuqe e IUCN-it për Llojet e Kërcënuara
- Lista e Kuqe Kombëtare e Maqedonisë së Veriut
- Lista e Kuqe e njëqelizorëve (diatomëve) të Evropës Qendrore dhe Lindore
- Direktiva e BE-së për Habitatet (DH)
- Direktiva e BE-së për Shpendët

Llojet e hijëzuara me ngjyrë të gjelbër është popozuar të përfshihen në programet e hartëzimit dhe monitorimit në Parkun Kombëtar. Të njëjtat lloje gjithashtu **duhet të konsiderohen si thelbësore për përcaktimin e masave të ruajtjes** në Parkun Kombëtar.

Pas formimit të Autoritetit Menaxhues të PK, i njëjti në koordinim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me mbështetjen teknike dhe shkencore nga autoritetet kombëtare të ekspertëve dhe nga Bordi Shkencor, duhet të shqyrtojë dhe të ndryshojë speciet kryesore të identifikuar këtu, nëse kjo do të jetë e nevojshme.

##### 3.4.1.1. Njëqelizorët (Diatomët)

Legjenda për Listën e Kuqe të Njëqelizorëve (Diatomëve) të Evropës Qendrore dhe Lindore: 1- lloje të ndikuara ndjeshëm, 2- lloje të ndikuara, 3 – lloje të ndikuara pak, G – lloje pothuajse të ndikuara, V – popullata në rënie, R- lloje mjaft të rralla

Emrat e llojeve	Lista e Kuqe e njëqelizorëve (diatomëve) të Evropës Qendrore dhe Lindore	Lista e kuqe paraprake e Maqedonisë
<i>Achnantheidium gracillimum</i> (F. Meister) Lange-Bertalot	3	
<i>Achnantheidium linearioide</i> Lange-Bertalot	3	I rrallë
<i>Adlafia detenta</i> (Hustedt) Heudre, C.E.Wetzel & Ector	1	I rrallë
<i>Adlafia suchlandtii</i> (Hustedt) Monnier & Ector	V	I rrallë
<i>Boreozonacola hustedtii</i> Lange-Bertalot, Kulikovskiy & Witkowski	2	I rrallë
<i>Caloneis lauta</i> Carter & Bailey-Watts	G	I rrallë
<i>Caloneis leptosoma</i> (Grunow) Krammer	G	I rrallë

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit për periudhën 2022-2031

Emrat e llojeve	Lista e Kuqe e njëqelizorëve (diatomëve) të Evropës Qendrore dhe Lindore	Lista e kuqe paraprake e Maqedonisë
<i>Cavinula mollicula</i> (Hustedt) Lange-Bertalot	3	I rrallë
<i>Cavinula variostrata</i> (Krasske) D.G. Mann	3	
<i>Chamaepinnularia hassiaca</i> (Krasske) Cantonati & Lange-Bertalot	3	
<i>Cymbella proxima</i> Reimer	V	I rrallë
<i>Cymbopleura similis</i> (Krasske) Krammer	3	
<i>Encyonema gaeumannii</i> (Meister) Krammer	3	I rrallë
<i>Encyonema hebridicum</i> Grunow ex Cleve	3	I rrallë
<i>Encyonema norvegicum</i> (Grunow) Mayer	3	I rrallë
<i>Eucocconeis alpestris</i> (Brun) Lange-Bertalot	3	I rrallë
<i>Eucocconeis flexella</i> (Kützing) Cleve	3	
<i>Eunotia arcubus</i> var. <i>bidens</i> (Grunow) Lange-Bertalot	G	I rrallë
<i>Eunotia flexuosa</i> (Brébisson ex Kützing) Kützing	2	
<i>Eunotia maior</i> (W. Smith) Rabenhorst	2	I rrallë
<i>Eunotiany manniana</i> Grunow	3	
<i>Geissleria similis</i> (Krasske) Lange-Bertalot & Metzeltin	V	I rrallë
<i>Genkalia digitulus</i> (Hustedt) Lange-Bertalot & Kulikovskiy	3	I rrallë
<i>Gomphonema amoenum</i> Lange-Bertalot	3	
<i>Gomphonema parvulus</i> (Lange-Bertalot & E.Reichardt) Lange-Bertalot &	3	
<i>Gomphonema pseudoboheicum</i> Lange-Bertalot & E Reichardt	3	
<i>Hygropetra balfouriana</i> (Grunow) Krammer & Lange-Bertalot	R	I rrallë
<i>Mastogloia grevillei</i> W. Smith	G	I rrallë
<i>Muelleria gibbula</i> (Cleve) Spaulding & Stoermer	G	I rrallë
<i>Navicula absoluta</i> Hustedt	2	
<i>Navicula angusta</i> Grunow	3	
<i>Navicula concentrica</i> Carter	2	I rrallë
<i>Navicula densilineolata</i> (Lange-Bertalot) Lange-Bertalot	3	I rrallë
<i>Navicula pseudolanceolata</i> Lange-Bertalot	3	I rrallë
<i>Navicula vulpina</i> Kützing	3	I rrallë
<i>Neidium alpinum</i> Hustedt	3	I rrallë
<i>Neidium bergii</i> (Cleve-Euler) Krammer	3	
<i>Neidium distinctepunctatum</i> Hustedt	R	I rrallë
<i>Neidium kozłowi</i> var. <i>parva</i> Mereschkowsky	R	I rrallë
<i>Pinnularia borealis</i> var. <i>scalaris</i> (Ehrenberg) Rabenhorst	R	
<i>Pinnularia cuneola</i> Reichardt	R	I rrallë
<i>Pinnularia decrescens</i> (Grunow) Krammer	D	I rrallë
<i>Pinnularia divergens</i> W.Smith	V	I rrallë
<i>Pinnularia infirma</i> Krammer	R	I rrallë
<i>Placoneis amphibola</i> (Cleve) E.J. Cox	3	I rrallë
<i>Placoneis opportuna</i> (Hustedt) Chudaev & Gololobova	2	I rrallë
<i>Planothidium joursacense</i> (Héribaud) Lange-Bertalot	3	I rrallë
<i>Psammothidium rossii</i> (Hustedt) Bukhtiyarova & F.E. Round	2	I rrallë
<i>Skabitschewskia oestrupii</i> (A.Cleve) Kuliskovskiy & Lange-Bertalot	D	I rrallë

Emrat e llojeve	Lista e Kuqe e njëqelizorëve (diatomëve) të Evropës Qendrore dhe Lindore	Lista e kuqe paraprake e Maqedonisë
<i>Skabitschewskia pergalloi</i> (Brun & Héribaud-Joseph) Kuliskovskiy & Lange-Bertalot	3	I rrallë
Infrastruktura	Vendosja e tabelave reklamuese	JO	JO	PO	PO
Infrastruktura	Krijimi i parkingjeve të makinave për mjetet motorike * përfshirë për zonat e përcaktuara për zhvillimin e turizmit, me miratimin nga MMJPH dhe autoritetit menaxhues	JO	JO *	PO	PO
Infrastruktura	Vendbanimet e reja turistike / shtëpitë e verimit	JO	JO	PO	PO
Infrastruktura	Hidrocentralet e reja	JO	JO	JO	JO
Infrastruktura	Teleferikë për ski dhe parkime biçikletash	JO	JO	JO	PO
Infrastruktura	Infrastruktura e re për prodhimin e energjisë së rinovueshme (ndërtimi i tubacioneve të biogazit)	JO	JO	JO	JO
Infrastruktura/ Menaxhimi	Instalimi dhe mirëmbajtja e tabelave informuese dhe shenjave të sinjalistikës rrugore (të prodhuara nga materiale natyrore) nga autoriteti menaxhues (p.sh. shënimi i shtigjeve për ngjitje)	PO	PO	PO	PO
Infrastruktura/ Menaxhimi	Pikat vrojtuese dhe soditëse (të bëra nga materiale natyrore),	PO	PO	PO	PO

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Kategoria	Veprimtaritë	Zonat			
		E mbrojtjes së rreptë	Menaxhimit aktiv	Përdorimi i qëndrueshëm	Brezi mbrojtës
	të menaxhuara nga organi menaxhues				
Infrastruktura/ Menaxhimi	Vendet e pushimit (tryeza, stola, kosha mbeturinash) të bëra nga materiale natyrore	JO	PO	PO	PO
Infrastruktura/ Menaxhimi	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e qendrave të informacionit	JO	JO	PO	PO
Menaxhimi	Hulumtimi shkencor/monitorimi në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, vetëm me pëlqimin paraprak nga MMJPH dhe të shoqëruar nga rojet e pyllit	PO	PO	PO	PO
Menaxhimi	Asgjësimi selektiv i kafshëve të egra, me lejen paraprake të MMJPH dhe MBPEU	JO	PO	PO	PO
Menaxhimi	Lëvizja e mjeteve motorike nga entiteti menaxhues në rrugët ekzistuese/të përcaktuara për përdorimin e mjeteve jeep* përjashtim në pjesën e sistemit Sharski Vodi dhe operacioneve të shpëtimit.	JO *	PO	PO	PO
Menaxhimi	Ndërtimi i qendrave riprodhuese për kafshët e egra	JO	JO	PO	PO
Menaxhimi	Ndërtimi i arboretumeve (kopshteve botanike) për llojet endemike dhe të rralla	JO	JO	PO	PO
Minierat	Kryerja e hulumtimeve të hollësishme gjeologjike dhe shfrytëzimi i burimeve minerare	JO	JO	JO	JO
Turizmi	Ngjitja, alpinizmi dhe çiklizmi malor (në zonën e mbrojtjes së rreptë, vetëm në shtigjet e shënuara dhe të drejtuara nga rojet e pyllit, ose nga udhërrëfyes të regjistruar me organin e menaxhimit)	PO	PO	PO	PO
Turizmi	Kalërimi (në zonën e mbrojtjes së rreptë, vetëm në shtigjet e shënuara dhe të drejtuar nga rojet e pyllit ose nga udhërrëfyes të regjistruar në organin e menaxhimit)	PO	PO	PO	PO
Turizmi	Skitë me makinat e ngjeshjes së dëborës, në bazë të një plani të zonave të kufizuara	JO	PO	PO	PO
Turizmi	Pista zbritjeje natyrore për parashutistët (në zonën e menaxhimit aktiv, vetëm në vendodhje të caktuara të lejuara nga entiteti menaxhues)	JO	PO	PO	PO
Turizmi	Rindërtimi i strukturave ekzistuese akomoduese, në pajtim me PM dhe duke respektuar kufizimet për lartësinë, dizenjimin dhe materialet me opinionet nga autoriteti menaxhues dhe MMJPH	JO	PO	PO	PO
Turizmi	Objekte të reja turistike (hotele, restorante, motele, kafene, zona	JO	JO	PO	PO

Kategoria	Veprimtaritë	Zonat			
		E mbrojtjes së rreptë	Menaxhimit aktiv	Përdorimi i qëndrueshëm	Brezi mbrojtës
	kampingu, etj.)				
Turizmi	Lëvizja e mjeteve motorike në rrugët ekzistuese *përgjashtim për numrin e kufizuar të mjeteve të bazuara në vlerësim dhe me kompensim	JO	JO *	PO	PO
Turizmi	Kampingu në vendodhje të caktuara *përgjashtim për zonat e kampikut të menaxhuara nga organi menaxhues	JO	JO *	PO	PO
Turizmi	Ndezja e zjarreve të hapura, në vendodhje të përcaktuara nga autoriteti menaxhues, me mbikëqyrjen e rojeve të pyllit	JO	JO	PO	PO
Turizmi	Ngjarje të organizuara sportive (vrapimi nëpër shtigje, turneu i skive), me miratimin nga organi menaxhues	PO	PO	PO	PO
Turizmi	Bërja ski në rezortet për ski	JO	JO	JO	PO

Përgjashtime:

- Mjetet motorike dhe makinat e pastrimit të dëborës mund të lëvizin në një zonë në raste emergjence, kur ka rrezik për jetën e njeriut;
- Mjetet motorike mund të lëvizin në një zonë në rast emergjence për kontrollin e zjarreve të furishëm.

#### 4.3.4. Kategorizimi i zonës me justifikimin

Malet e Sharrit janë propozuar për mbrojtje si një parku kombëtar. Neni 72 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës përcakton zonat e mbrojtura në këtë kategori si zona të mëdha tokësore ose ujore me vlera të shumta të veçanta natyrore, duke përfshirë një ose më shumë ekosisteme që janë në një gjendje natyrore ose afër natyrrës. Ky përcaktim synohet kryesisht për ruajtjen e thesareve natyrore, kulturore dhe shpirtërore.

Tabela e mëposhtme rendit Kriteret e IUCN-it që karakterizojnë zonat e mbrojtura në Kategorinë II – Park Natyror dhe ofron komente se sa mirë përputhen këto kritere me situatën e Maleve të Sharrit.

Kriteret	Komentet
Objektivi kryesor <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbrohet biodiversiteti natyror së bashku me përbërjen ekologjike përkatëse dhe mbështetëse të proceseve mjedisore, dhe të promovohet edukimi dhe rekreacioni.</li> </ul>	përputhje e mirë
Objektiva të tjera: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të menaxhohet zona në mënyrë që të ruhen, në një gjendje sa më natyrore të mundshme, shembujt përfaqësues të rajonit fiziografik, komuniteteve biotike, burimeve gjenetike dhe proceseve të padëmtuara natyrore;</li> </ul>	përputhje e mirë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mirëmbahen popullatat dhe grumbullimet jetike dhe funksionale ekologjikisht të llojeve autoktone në dendësinë e mjaftueshme për të ruajtur integritetin e ekosistemit dhe aftësinë ripërtëritëse në</li> </ul>	përputhje e mirë

Kriteret	Komentet
periudhën afatgjatë;	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të kontribuohet veçanërisht në ruajtjen e llojeve të gamës së gjerë, proceseve ekologjike rajonale dhe korridoreve të shtegtimit;</li> </ul>	përputhje e mirë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të menaxhohet përdorimi nga ana e vizitorëve i zonës për qëllime frymëzimi, edukimi, kulture apo rekreacioni në atë shkallë e cila nuk do të shkaktonte degradim të ndjeshëm biologjik ose ekologjik ndaj burimeve natyrore;</li> </ul>	përputhje e mirë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të merren parasysh nevojat e njerëzve autoktonë dhe komuniteteve lokal, duke përfshirë përdorimin e burimeve për jetesë, në mënyrë që këto të mos kenë ndikim të dëmshëm ndaj objektivit kryesor të menaxhimit;</li> </ul>	jo relevante
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të kontribuohet ndaj ekonomive lokale përmes turizmit.</li> </ul>	përputhje e mirë
<p>Tiparet dalluese</p> <p>Zonat e kategorisë II janë kryesisht të mëdha dhe ruajnë një “ekosistem” funksional, pavarësisht se për të arritur këtë, kjo zonë e mbrojtur mund të ketë nevojë të plotësohet me menaxhimin dashamirës që vjen nga zonat përreth.</p>	përputhje e mirë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Zona duhet të ruajë shembuj përfaqësues të rajoneve kryesore natyrore, dhe tipare ose pamje biologjike dhe mjedisore, ku bimët autoktone dhe llojet e kafshëve, habitatet dhe zonat e gjeodiversitetit janë të rëndësishme të veçantë shpirtërore, shkencore, edukative, rekreative apo turistike.</li> </ul>	përputhje e mirë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Zona duhet të jetë e madhësisë së mjaftueshme dhe e cilësisë ekologjike në mënyrë që të mirëmbajë funksionet dhe proceset ekologjike që do të lejojnë mbizotërimin e llojeve dhe komuniteteve autoktone për një periudhë afatgjatë me ndërhyrje minimale menaxhuese.</li> </ul>	përputhje e mirë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Përbërja, struktura dhe funksioni i biodiversitetit duhet të jetë në një masë të madhe në gjendje “natyrore” ose të ketë potencialin të restaurohet në gjendje të tillë, me rrezik shumë të ulët të invazionit (përhapjes) së llojeve jo autoktone.</li> </ul>	përputhje e mirë
<p>Roli në peizazh</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kategoria II ofron mundësi të ruajtjes së shkallës së gjerë ku proceset natyrore ekologjike mund të vijojnë pafundësisht, duke krijuar hapësira për evolucionin e vazhdueshëm. Ato janë shpesh themelet kryesore në krijimin dhe zhvillimin e korridoreve biologjike në shkallë të gjerë ose iniciativave të tjera të ruajtjes të nevojshme për ato specie (me një gamë të gjerë shpërndarjeje dhe/ose migrimi), të cilat nuk mund të ruhen plotësisht në një zonë të mbrojtur. Prandaj, rolet e tyre kryesore janë si më poshtë:</li> </ul>	përputhje e mirë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbrojtja e proceseve ekologjike të shkallës së gjerë që do të mungojnë në zona më të vogla të mbrojtura ose në peizazhe kulturore;</li> </ul>	përputhje e mirë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbrojtja e shërbimeve të pajtueshme të ekosistemit;</li> </ul>	përputhje e mirë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbrojtja e llojeve dhe komuniteteve të veçanta që kërkon zona relativisht të mëdha me habitat të pasqetësuar;</li> </ul>	përputhje e pjesshme
<ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurimi i një “grupimi” të llojeve të tilla për të ndihmuar popullimin</li> </ul>	përputhje e mirë

**Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit**

Kriteret	Komentet
e zonave të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme që rrethojnë zonën e mbrojtur;	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të integrohen me përdorime të tokës përreth për të kontribuar ndaj planeve për ruajtjen në shkallë të gjerë;</li> </ul>	përputhje e mirë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të informohen dhe nxiten vizitorët për nevojën dhe potencialin e programeve të ruajtjes;</li> </ul>	përputhje e mirë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbështetet zhvillimi i pajtueshëm ekonomik, kryesisht përmes rekreacionit dhe turizmit, i cili mund të kontribuojë ndaj ekonomive kombëtare dhe në veçanti ndaj komuniteteve lokale.</li> </ul>	përputhje e mirë

Përfundimi: Parku Kombëtar i Maleve të Sharrit përmbush kriteret e Kategorisë II të IUCN-it

#### 4.4. Programet e Menaxhimit

##### 4.4.1. Ruajtja dhe monitorimi i trashëgimisë natyrore

Parku Kombëtar i Maleve të Sharrit përbën trashëgiminë e rëndësishme natyrore e cila duhet të ruhet. Programi për ruajtjen dhe monitorimin e trashëgimisë natyrore lidhet drejtpërdrejt me përbushjen e vizionit të parkut për të mbetur një rajon i rëndësishëm i biodiversitetit. Objektivi kryesor i programit është të monitorohet, mirëmbahet dhe rritet biodiversiteti dhe vlerat natyrore, duke përfshirë llojet e egra, karakteristikat fizike (gjeologjike, geomorfologjike, pedologjike dhe hidrologjike) dhe peizazhet.

Programi përmban shtatë nën-programe, secili me objektivat e veta. Për secilin nën-program, janë përcaktuar në mënyrë të hollësishme veprimtaritë, treguesit, shkalla e prioritetit dhe partnerët përkatës për një periudhë pesëvjeçare.

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
Ruajtja dhe Monitorimi i Trashëgimisë Natyrore	Të monitorohet, mirëmbahet dhe rritet biodiversiteti dhe vlerat natyrore, duke përfshirë llojet e egra, karakteristikat fizike (gjeologjike, geomorfologjike, pedologjike dhe hidrologjike) dhe peizazhet.	1.1 Objektivat për trashëgiminë natyrore (habitatet, llojet dhe peizazhet)	Të përcaktohen objektivat për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e statusit të vlerave natyrore
		1.2 Hartëzimi i llojeve kryesore	Të sigurohen njohuritë dhe të dhënat e mjaftueshme për ruajtjen dhe monitorimin e mëtejshëm
		1.3 Masat e ruajtjes për llojet kryesore	Të sigurohet mbrojtje afatgjatë e vlerave natyrore (statusi i favorshëm i ruajtjes në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare)
		1.4 Monitorimi i llojeve Kryesore	Të zhvillohet dhe zbatohet një sistem praktik, me kosto të ulët, i orientuar drejt rezultateve, i lehtë për të komunikuar, për Monitorimin e llojeve kryesore dhe peizazheve si bazë për menaxhimin e ardhshëm të vlerave natyrore.
		1.5 Hulumtimi për vlerat natyrore	Të sigurohen njohuritë shkencore bazë për llojet dhe habitatet dhe të përcaktohet

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
			statusi i favorshëm i ruajtjes për vlerat relevante natyrore.
		1.6 Vlerësimi i masave të ruajtjes për llojet dhe peizazhet	Të ofrohet një metodologji sistematike për të vlerësuar efektet e programeve të mbrojtjes dhe të konfirmohet sa sa janë realizuar objektivat. Vlerësimi ndihmon që të konfirmohet ajo që duhet të përmirësohet.
		1.7 Monitorim nga qytetarët dhe shkenca	Të trajnohen dhe përfshihen banorët lokalë apo vizitorët e rregullt në monitorimin e llojeve dhe peizazheve kryesore.

#### 4.4.2. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore

Burimet e shumta natyrore që gjenden në Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit duhet të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme. Programi për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore do të kontribuojë në përmbushjen e vizionit të parkut për krijimin e barazpeshës ndërmjet ruajtjes së natyrës dhe përfitimit, në një mënyrë e cila nuk vë në rrezik mbijetesën e llojeve.

Objektivi kryesor i programit është që: Burimet natyrore të PKMSH-së të përdoren në mënyrë të qëndrueshme. Përdorimi i tyre ofron të ardhura për komunitetet lokale dhe kontribuon ndaj financimit të Parkut Kombëtar.

Programi përmban shtatë nën-programe, secili me objektivin e tij. Për secilin nën-program përcaktohen veprimtaritë e hollësishme, treguesit, shkalla e prioritetit dhe partnerët përkatës për një periudhë pesëvjeçare.

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
Menaxhimi i Qëndrueshëm i	Burimet natyrore të PKMSH-së përdoren në	2.1 Përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve në pajtim me planet e posaçme të menaxhimit të pyjeve	Përdorimi i pyllit në park menaxhohet në pajtim me parimet e pylltarisë për ruajtjen e natyrës.

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
Burimeve Natyrore	mënyrë të qëndrueshme. Përdorimi i tyre ofron të ardhura për komunitetet lokale dhe kontribuon ndaj financimit të Parkut Kombëtar.	2.2 Përdorimi i qëndrueshëm i kullotave dhe zonave baritore gjysëm-natyrore	Përdorimi i kullotave mbikëqyret dhe është i qëndrueshëm; bashkëpunim me NP Kullotat dhe fermerët lokalë.
		2.3 Përdorimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore në zonat përreth fshatrave	Në bashkëpunim me popullsinë lokale.
		2.4 Përdorimi i qëndrueshëm i bimëve dhe frutave të egra	Në bashkëpunim me popullsinë lokale.
		2.5 Menaxhimi i qëndrueshëm i natyrës së egër	Të rriten popullatat e kafshëve të egra dhe të të sigurohet monitorimi i vazhdueshëm i natyrës së egër.
		2.6 Përdorimi i qëndrueshëm i ujit	Monitorimi i vazhdueshëm dhe masat për të minimizuar ndikimet e dëmshme ndaj biodiversitetit
		2.7 Krijimi i Sistemit të Parandalimit të Zjarrit në Pyje	Monitorimi, ndërhyrja e hershme dhe parandalimi efektiv i zjarrit.

#### 4.4.3. Menaxhimi i habitateve dhe ekosistemeve

Parku Kombëtar i Maleve të Sharrit është i pasur me habitate dhe ekosisteme të cilat duhet të menaxhohen në pajtim me qëllimet e ruajtjes. Programi për menaxhimin e habitateve dhe ekosistemeve do të kontribuojë në përmbushjen e vizionit të parkut për krijimin e barazpeshës ndërmjet ruajtjes së natyrës dhe veprimtarive tradicionale, në një mënyrë e cila nuk vë në rrezik mbijetesën e popullatave apo llojeve dhe ekuilibrimin e tyre natyror.

Objektivi kryesor i programit është të menaxhojë habitatet dhe ekosistemet në pajtim me qëllimet e ruajtjes në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Programi përmban pesë nën-programe, secili me objektivin e vet. Për secilin nën-program përcaktohen me hollësi veprimtaritë, treguesit, shkalla e prioritetit dhe partnerët përkatës për një periudhë pesëvjeçare.



Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
Menaxhimi i Habitave dhe Ekosistemeve	të menaxhojë habitatet dhe ekosistemet në pajtim me objektivat e ruajtjes në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.	3.1 Hartëzimi i habitateve	Hartëzimi në terren i habitateve të përzgjedhura si bazë për menaxhimin e ardhshëm të vlerave natyrore
		3.2 Masat e menaxhimit të habitateve në pajtim me qëllimet e ruajtjes	Të mirëmbahen dhe përmirësohen (ose restaurohen) habitatet me masat e përshtatshme të përcaktuara për secilën zonë të mbrojtur.
		3.3 Monitorimi i habitateve	Të zhvillohet dhe zbatohet një sistem praktik, me kosto të ulët, i orientuar drejt rezultateve, i lehtë për të komunikuar, për monitorimin e habitateve si baza për menaxhimin e ardhshëm të vlerave natyrore
		3.4 Menaxhimi i të dhënave për vlerat natyrore	Të zhvillohet një bazë të dhënash praktike dhe efikase që do të përdoret për qëllime të ruajtjes së natyrës dhe për raportimin ndaj institucioneve dhe donatorëve. Stafi do të trajnohet për të mbledhur, ngarkuar, ruajtur dhe përpunuar të dhënat.
		3.5 Vlerësimi i masave të ruajtjes për habitatet	Të ofrohet një metodologji sistematike për të vlerësuar efektet e programeve të mbrojtjes dhe të konfirmohet sa sa janë realizuar objektivat. Vlerësimi ndihmon që të konfirmohet ajo që duhet të përmirësohet.

#### 4.4.4. Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore

Zona e PKMSH-së ka një trashëgimi të pasur kulturore. Programi për menaxhimin e trashëgimisë kulturore kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e vizionit të parkut për të krijuar barazpeshën ndërmjet ruajtjes së natyrës dhe mbrojtjes/ruajtjes së trashëgimisë së rëndësishme kulturore, duke përfshirë peizazhet, arkitekturën dhe vlera të tjera kulturore.

Objektivi kryesor i programit është të mbrohen dhe promovohen peizazhet e shumëllojshme dhe trashëgimia kulturore e parkut, duke përfshirë peizazhet tradicionale që kanë evoluar përgjatë shekujsh përmes ndërveprimeve të njerëzve me natyrën.

Programi përmban dy nën-programe, secili me objektivin e vet. Për secilin nën-program përcaktohen me hollësi veprimtaritë, treguesit, shkalla e prioritetit dhe partnerët përkatës për një periudhë pesëvjeçare.

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore	Të mbrohen dhe promovohen peizazhet e shumëllojshme dhe trashëgimia kulturore e parkut, duke përfshirë peizazhet tradicionale që kanë evoluar ndër shekujsh përmes ndërveprimeve të njerëzve me natyrën.	4.1 Masat për mirëmbajtjen e peizazheve karakterisitke	Të zhvillohet një sistem praktik për hartëzimin, monitorimin dhe promovimin e peizazheve kulturore.  të zbatohet një program pilot për restaurimin e peizazheve të degraduara në mënyrë që ruhen peizazhet karakterisitke të krijuara nga njeriu, të përshtaten praktikatat për përdorimin e burimeve natyrore për të shmangur degradimin e mëtejshëm të peizazhit.
		4.2 Masat për mirëmbajtjen e vlerave kulturore	Promovimi i trashëgimisë kulturore, përmes artit, ngjarjeve kulturore, botimeve të monografive dhe artikujve shkencorë që lidhen me historinë kulturore.

#### 4.4.5. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm

Parku Kombëtar i Maleve të Sharrit ofron një potencial të madh për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Programi për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e vizionit të parkut për krijimin e barazpeshës ndërmjet ruajtjes së natyrës dhe zhvillimit të turizmit.

Objektivi kryesor i programit është që Malet e Sharrit të mirëpresin turistë nga e gjithë bota të cilët vlerësojnë dhe i gëzohen bukurive natyrore dhe diversitetit të zonës. Vizitorët ndihmojnë në financimin e Parkut Kombëtar përmes kompensimeve turistike, ndërsa eko-turizmi kontribuon ndaj banorëve lokalë të cilët përfshihen në mënyrë aktive në ofrimin e shërbimeve turistike (udhërrëfime, akomodime dhe ushqime tradicionale).

Programi përmban katër nën-programe, secili me objektivin e vet. Për secilin nën-program përcaktohen me hollësi veprimtaritë, treguesit, shkalla e prioritetit dhe partnerët përkatës për një periudhë pesëvjeçare.

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
Zhvillimi i Turizmit të Qëndrueshëm	Malet e Sharrit të mirëpresin turistë nga e gjithë bota të cilët vlerësojnë dhe i gëzohen bukurive natyrore dhe diversitetit të zonës. Vizitorët ndihmojnë në financimin e Parkut Kombëtar përmes kompensimeve turistike, ndërsa eko-turizmi kontribuon ndaj banorëve lokalë të cilët përfshihen në mënyrë aktive në ofrimin e	5.1 Zhvillimi i strategjisë së turizmit për PKMSH-në	Të zhvillohet një strategji e përgjithshme turistike, një markë turistike me logo dhe “identitetin e destinacionit” që do të përdoret në të gjithë rajonin; të zbatohet programi për të mbështetur turizmin e qëndrueshëm.
		5.2 Sistemi i bashkëpunimit me aktorët e turizmit	Të sigurohet që shërbimet turistike të kryhen në pajtim me parimet për mbrojtjen e natyrës. Mbështetje ndaj popullsisë lokale për zhvillimin e shërbimeve turistike. Shërbimet ofrohen nga udhërrëfyes apo cicieronë të licencuar. Të sigurohet se për çdo shërbim paguhet taksë.
		5.3 Krijimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së vizitorëve	Të zhvillohet dhe mirëmbahet infrastruktura e nevojshme për vizitorët (rrugët, shtigjet, kasollet, pikat e informimit, qendrat e vizitorëve) dhe të përfshihen banorët lokalë (turizmi gjithëpërfshirës). Të zhvillohen aplikacionet mobile me

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
	shërbimeve turistike (udhërrëfime, akomodime dhe ushqime tradicionale).		informacionin për zonat dhe vlerat e territorit.
		5.4 Sistemi i menaxhimit të vizitorëve	Të krijohet një sistem funksional dhe modern për regjistrimin e numrit të vizitorëve, kompensimet e hyrjes, kompensimet për shërbimet, pagesën elektronike.

#### 4.4.6. Zhvillimi Lokal

Programi për zhvillimin lokal do të kontribuojë në përmbushjen e vizionit të parkut që zona e mbrojtur do të sjellë përfitime ekonomike ndaj popullsisë lokale dhe kontribuon ndaj zhvillimit të ekonomisë së gjelbër. Autoriteti i parkut kombëtar mbështet zhvillimin e infrastrukturës komunale dhe forcon rolin e grave në zhvillimin lokal.

Objektivi kryesor i programit është që Parku Kombëtar i Maleve të Sharrit të mbështesë në mënyrë aktive zhvillimin e qëndrueshëm të fshatrave malore.

Programi përmban katër nën-programe, secili me objektivin e vet. Për secilin nën-program përcaktohen me hollësi veprimtaritë, treguesit, shkalla e prioritetit dhe partnerët përkatës për një periudhë pesë-vjeçare.

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
Zhvillimi Lokal	PKMSH të mbështesë në mënyrë aktive zhvillimin e fshatrave malore	6.1 Korniza për financimin e zhvillimit ligjor	Të krijohen programe të shumta të cilat do të mundësojnë që banorët lokalë të marrin pjesë në zhvillimin e fshatrave malore
		6.2 Mirëmbajtja dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe shërbimeve komunale	Të përmirësohen shërbimet komunale në fshatrat malore në bashkëpunim me komunitat: mbledhja e mbeturinave (të ngurta dhe të lëngshme), trajtimi i mbetjeve, pastrimi i mbeturinave të hedhura pa kriter, të përmirësohet

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
			menaxhimi i ujërave të zeza. Të sigurohet aksesimi ndaj të gjithë fshatrave malore me banorë të përhershëm gjatë të gjithë vitit
		6.3 Mirëmbajtja dhe rinovimi i arkitekturës tradicionale	Të sigurohet që arkitekturat unike tradicionale të ruhen, dhe rinovimi të bëhet në pajtim me stilet tradicionale
		6.4 Raportimi dhe monitorimi i zhvillimit urban	Të krijohet sistemi i monitorimit dhe raportimit të rregullt që do kontribuojë në rregulloren e zhvillimit urban në pajtim me zonimin e parkut

#### 4.4.7. Informimi, rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi

Programi për informimin, rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimin do të kontribuojë në përmbushjen e vizionit të parkut duke rritur në mënyrë aktive ndërgjegjësimin dhe duke ofruar informacion për vlerat e zonës tek popullata lokale dhe vizitorët, përmes programeve dhe ngjarjeve edukative për nevojat për të mbrojtur habitatet, llojet, ekosistemet dhe peizazhet, dhe përfitimet e një mjedisi të shëndetshëm.

Objektivi kryesor i programit është të ofrojë informacion dhe të rrisë ndërgjegjësimin për vlerat natyrore dhe kulturore, objektivat e zonës së mbrojtur dhe zonimit, kufizimet dhe masat për ruajtjen, si dhe përfitimet e Parkut për popullsinë lokale. Më tej, ai do të ofrojë veprimtari edukative në mënyrë që të gjitha llojet e vizitorëve dhe grupet e targetuara të mund të shijojnë vlerat e Parkut Kombëtar.

Programi përmban tre nën-programe, secili me objektivin e vet. Për secilin nën-program përcaktohen me hollësi veprimtaritë, treguesit, shkalla e prioritetit dhe partnerët përkatës për një periudhë pesëvjeçare.

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
Informimi, rritja e ndërgjegjësimit dhe Edukimi	të ofrojë informacion dhe të rrisë ndërgjegjësimin për	7.1 Zhvillimi i infrastrukturës për edukimin mjedisor	Të krijohen mjediset e mbyllura dhe të hapura ndërvepruese për edukimin e turistëve dhe fëmijëve.

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
	vlerat natyrore dhe kulturore, objektivat e zonës së mbrojtur dhe zonimit, kufizimet dhe masat për ruajtjen, si dhe përfitimet e Parkut për popullsinë lokale. Më tej, ai do të ofrojë veprimtari edukative në mënyrë që të gjitha llojet e vizitorëve dhe grupet e targetuara të mund të shijojnë vlerat e Parkut Kombëtar.		Të krijohen programe edukative mjedisore me stafin e trajnuar me aftësi për t'i zbatuar ato.
		7.2 Strategjia e komunikimit duke përfshirë mediat sociale	Të krijohet paketa e plotë e marrëdhënieve me publikun për parkun, duke përfshirë website, mediat sociale, fushatat e komunikimit, materialet promocionale
		7.3 Programet edukative për grupe të ndryshme të synuara	të ofrohen programe edukative për grupe të ndryshme të targetuara, veçanërisht fëmijët.

#### 4.4.8. Qeverisja, menaxhimi, organizimi i punës dhe financimi

Programi për qeverisjen, menaxhimin, organizimin e punës dhe financimin kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e vizionit të parkut që Autoriteti i Parkut Kombëtar menaxhon zonën e mbrojtur në bazë të planifikimit strategjik, siguron burime të ndryshme financimi, drejton dhe menaxhon burimet njerëzore të organizatës, ofron trainimin bashkëkohor të stafit, bashkëpunon me zonat e mbrojtura fqinje dhe ndërkonstruon marrëdhënie të mira me aktorët e përfshirë brenda dhe jashtë parkut.

Objektivi kryesor i programit është të zbatojë menaxhimin efektiv, planifikimin dhe zhvillimin strategjik dhe të ketë kapacitete të forta dhe të sigurojë burime financiare.

Programi përmban gjashtë nën-programe, secili me objektivin e vet. Për secilin nën-program përcaktohen me hollësi veprimtaritë, treguesit, shkalla e prioritetit dhe partnerët përkatës për një periudhë pesë-vjeçare.

Programi	Objektivi	Nën-programi	Objektivat specifike
----------	-----------	--------------	----------------------

<p>Qeverisja, Menaxhimi, Organizimi i Punës dhe Financimi</p>	<p>Të zbatojë menaxhimin efektiv, planifikimin dhe zhvillimin strategjik, dhe të ketë kapacitete të forta dhe të sigurojë burime financiare.</p> <p>(Burimi: Appleton, M.R. (2016). A Global Register of Competences for Protected Area Practitioners. IUCN)</p>	8.1 Forcimi institucional i zonës së mbrojtur	Sigurimi i një kornize strategjike dhe të mirë-planifikuar për menaxhimin e ZM-së.
		8.2 Drejtimi dhe Zhvillimi Organizativ	Krijimi dhe ruajtja e organizatave të qeverisura, të menaxhuara dhe të drejtuara mirë për menaxhimin e ZM-së.
		8.3 Menaxhimi i Burimeve Natyrore	Krijimi i fuqisë punëtore të duhur, kompetente dhe të mbështetur për ZM-në. Të ofrohet trajnimi për stafin për aftësitë përkatëse.
		8.4 Menaxhimi Financiar	Sigurimi që ZM financohet dhe pajiset siç duhet, dhe që burimet lëvrohen dhe përdoren në mënyrë efektive dhe efikase. Qasja ndaj donatërve ndërkombëtare. Lidhja me Natura 2000 dhe Bashkëpunimi Ndërkufitar LIFE (Mavrovë, Kosovë, Shqipëri).
		8.5 Raportimi Administrativ dhe Dokumentacioni	Krijimi dhe zbatimi i procedurave për menaxhimin e informacionit, dokumentimin dhe raportimin.
		8.6 Komunikimi dhe Bashkëpunimi	Ndërtimi dhe përdorimi i aftësive të kërkuara për të komunikuar dhe bashkëpunuar në mënyrë efektive.
			Krijimi i grupeve të punës dhe aktorëve të përfshirë lokal – Këshilli

## 5. Plani operativ

Në përputhje me rregulloren për përmbajtjen e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe programeve vjetore për mbrojtjen e natyrës, më poshtë jepen veprimtaritë të cilat Institucioni Publik PKMSH është përgjegjës për të zbatuar në periudhën e parë pesëvjeçare (2021 deri në 2026). Pas kësaj periudhe, në pajtim me Nenin 99 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, institucioni përgjegjës rishikon planin e menaxhimit.

Veprimtaritë janë të organizuara në tetë programe, të hartuara për të përmbushur objektivat e indentifikimit të zonave të mbrojtura të propozuara (Kreu 4.2). Çdo program ka disa nën-programe, secili me një plan operativ dhe veprimtari, prioritete, tregues, afate kohore dhe përgjegjësi.

Prioritetet:

- Prioriteti 1: Veprimtaritë të cilat janë të detyrueshme për zbatimin e planit
- Prioriteti 2: Veprimtaritë të cilat janë të rëndësishme në arritjen e objektivave të planit. Veprimtari të tilla mund të mbeten të papërmbushura vetëm në rrethana të veçanta.
- Prioriteti 3: Veprimtaritë të cilat janë të dobishme por jo kritike për përmbushjen e objektivave të planit. Investimet në këto veprimtari duhen bërë vetëm kur Prioriteti 1 dhe Prioriteti 2 kanë përfunduar.

Treguesit e përmbushjes së aktivitetit lehtësojnë monitorimin duke përcaktuar përfundimet e matshme.

Afati kohor për zbatim tregon vitet, brenda 5 viteve të ardhshëm, në të cilat veprimtaritë duhet të përfundojnë.

“Subjekti zbatues” i referohet strukturës përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive, apo të një apo më shumë partnerëve të mundshëm me të cilët struktura përgjegjëse do t’i zbatojë ato.

Instituti Publik PKMSH monitoron zbatimin e planit operativ.

Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, pas periudhës së parë pesëvjeçare plani i menaxhimit do të rishikohet dhe rinovohet për periudhën pasardhëse.



## 5.1. Ruajtja dhe monitorimi i trashëgimisë natyrore

### 5.1.1. Objektivat për trashëgiminë natyrore

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Zbatimi i përgjegjshëm	Burimi i mundshëm i financimit	Relevancaembështetjessëjashtme
1.1.1 Identifikimi i objektivave afatshkurtra dhe afatgjata për mbrojtjen e vlerave natyrore (Rrëqebulli si lloj prioritar)	1	Objektiva për mbrojtjen e vlerave natyrore të përcaktuara në raport	1					Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të PK-së, UNEP-it, PNUD-it, BE-së, GIZ-itdhetëtjera	E lartë

### 5.1.2. Hartëzimi i llojeve kryesore

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
1.2.1 Hartëzimi i shpërndrjes së llojeve kryesore (propozuar në kreun 3.3.2.4 Koleksioni i	2	Harta të shpërndarjes të llojeve kryesore në GIS		1	1	1		Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
bimëve të egra dhe 3.4.1 Llojet)										
1.2.2 Vlerësimi i statusit të mbrojtjes së llojeve kryesore	2	Studim mbi statusin e mbrojtjes të llojeve kryesore				1		Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë
1.2.3 Inventarizimi dhe hartëzimi i llojeve aloktone të pemëve	3	Harta për inventarin dhe shpërndarjejen dhe plani i veprimit për llojet e pemëve aloktone në një studim dhe në GIS			1	1		Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë
1.2.4 Hartëzimi i llojeve kryesore më të prekura nga	3	Identifikimi i llojeve prioritare				1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
ndryshimet klimatike								ekspertët e organizatave joqeveritare		

### 5.1.3. Masat mbrojtëse për llojet

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
1.3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i masave mbrojtëse për llojet kryesore	2	Krijimi i Programit për Mbrojtjen e Llojeve Kryesore		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë
1.3.3 Përgatitja e planit të menaxhimit të veçantë për peshkimin në lumenjtë e parkut kombëtar	2	Plan i veçantë menaxhimi për peshkimin i përgatitur dhe i miratuar		1				Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë

5.1.4. Monitorimi i Llojeve Kryesore

Vepimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
1.4.1 Monitorimi i llojeve kryesore të jovertebrorëve	2	Protokolle të përgatitura monitorimi, të dhëna të mbledhura nga monitorimet në GIS, raporte vjetore dhe raporti përfundimtar rreth rezultateve në vitin 2026		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	Mesatare
1.4.2 Monitorimi i llojeve kryesore të gjitarëve (me përjashtim të lakuriqëve të natës)	2	Protokolle të përgatitura monitorimi, të dhëna të mbledhura nga monitorimet në GIS, raporte vjetore dhe raporti përfundimtar rreth rezultateve në vitin 2026		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera.	Mesatare

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
1.4.3 Monitorimi i llojeve kryesore të lakuriqëve të natës	2	Protokolle të përgatitura monitorimi, të dhëna të mbledhura nga monitorimet në GIS, raporte vjetore dhe raporti përfundimtar rreth rezultateve në vitin 2026		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	Mesatare
1.4.4 Monitorimi i llojeve kryesore të shpendëve	2	Protokolle të përgatitura monitorimi, të dhëna të mbledhura nga monitorimet në GIS, raporte vjetore dhe raporti përfundimtar rreth rezultateve në vitin 2026		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	Mesatare

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
1.4.5 Monitorimi i llojeve kryesore të bimëve, kërpudhave dhe myshqeve	2	Protokolle të përgatitura monitorimi, të dhëna të mbledhura nga monitorimet në GIS, raporte vjetore dhe raporti përfundimtar rreth rezultateve në vitin 2026		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	Mesatare
1.4.6 Monitorimi i llojeve kryesore të amfibëve, zvarranikëve, peshqve, algave dhe molusqeve	2	Protokolle të përgatitura monitorimi, të dhëna të mbledhura nga monitorimet në GIS, raporte vjetore dhe raporti përfundimtar rreth rezultateve në vitin 2026		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtar dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	Mesatare
1.4.7 Monitorimi i llojeve të indentifikuara nën kërcënimin e ndryshimeve klimatike	2	Monitorim i kryer i llojeve të përzgjedhura nga lista e raportit të tretë kombëtar për UNFCCC		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	Mesatare

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
								ekspertët e organizatave joqeveritare		
1.4.8 Monitorimi i llojeve të pemëve invasive dhe aloktone të Parkut Kombëtar të Maleve të Sharrit	2	Protokolle të përgatitura monitorimi, të dhëna të mbledhura nga monitorimet në GIS, raporte vjetore dhe raporti përfundimtar rreth rezultateve në vitin 2026		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	Mesatare
1.4.9 Monitorimi i popullatave të Troftës Maqedonase në lumenjtë me ndërhyrje të njeriut (sipër dhe poshtë ndërhyrjes)	2	Protokolle të përgatitura monitorimi, të dhëna të mbledhura nga monitorimet në GIS, raporte vjetore dhe raport përfundimtar rreth rezultateve në 2026		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	Mesatare

5.1.5. Kërkimi shkencor për vlera natyrore

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
1.5.1 Zhvillimi i një liste prioritare të temave për kërkim/studim	2	Listë e prioriteteve për temat e studimit		1				Struktura e Menaxhimit të zonave të mbrojtura	Buxheti i menaxhimit të PK-së, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët
1.5.2 Studim mbi eutrofikimin e Liqenit të Bogovinës	3	Raport studimor i përgatitur mbi eutrofikimin e Liqenit të Bogovinës			1	1		Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë
1.5.3 Kërkim/Studim mbi llojet invazive	3	Raport studimor i përgatitur mbi llojet invazive			1	1		Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë



5.1.6. Shkenca Qytetare/e Komunitetit për Monitorim

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
1.6.1 Zhvillimi dhe zbatimi i programit për Monitorimin përmes Shkencës qytetare apo Shkencës së Komunitetit	2	Minimalisht 20 persona nga fshatrat lokale marrin pjesë në programin e monitorimit , raporte vjetore dhe raporti përfundimtar në vitin 2026.		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

5.1.7. Vlerësimi i masave mbrojtëse për llojet dhe peizazhet

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
1.7.1 Vlerësimi i efikasitetit të masave mbrojtëse për llojet kryesore	2	Raport mbi efektshmërinë e masave mbrojtëse për llojet kryesore në vitin 2026					1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë

**Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit**

									kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare		
1.7.2 Vlerësimi i efikasitetit të masave mbrojtëse për peizazhet	3	Raport mbi efektshmërinë e masave mbrojtëse për peizazhet në vitin 2026						1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në, institucionet shkencore dhe profesionale, ekspertët kombëtarë dhe ekspertët e organizatave joqeveritare	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë

**5.2. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore**

Vepriartaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
2.1.0 Zhvillimi i një skeme të përgjithshme pagesash për shërbimet e ekosistemit	1	Studim mbi këtë skemë	1	1				Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH-në dhe ekspert	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë

5.2.1. Përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve

Vepimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
2.1.1 Përgatitja e planit të posaçëm për menaxhimin e habitateve pyjore	1	Plani i menaxhimit të posaçëm pyjor i përgatitur dhe i miratuar	1					Struktura e Menaxhimit të ZM- së në bashkëpunim me MMJPH-në, MBPEU, institucionet përkatëse dhe universitetet dhe ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme
2.1.2 Përgatitja dhe zbatimi i planeve vjetore për të gjitha operacionet menaxhuese për habitatet pyjore (duke përfshirë mbjelljen, mirëmbajtjen e rrugëve pyjore etj.)	1	Plane të përgatitura dhe të zbatuara rregullisht	1					Struktura e Menaxhimit të ZM- së në bashkëpunim me MMJPH-në, MBPEU-në, institucione dhe universitete përkatëse dhe ekspertë	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

**Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit**

<b>Veprimtaria</b>	<b>Prioriteti</b>	<b>Treguesi</b>	<b>V 2022</b>	<b>V 2023</b>	<b>V 2024</b>	<b>V 2025</b>	<b>V 2026</b>	<b>Të autorizuar për zbatim</b>	<b>Burimi i mundshëm i financimit</b>	<b>Relevanca e mbështetjes së jashtme</b>
2.1.3 Përgatitja e rregulloreve dhe e procedurave të brendshme për përdorimin e pyjeve në pronësinë private	1	Dokumentet e përgatitura për përdorimin e pyjeve në pronësi private	1	1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët

**5.2.2. Përdorimi i qëndrueshëm i kullotave malore**

<b>Veprimtaria</b>	<b>Prioriteti</b>	<b>Treguesi</b>	<b>V 2022</b>	<b>V 2023</b>	<b>V 2024</b>	<b>V 2025</b>	<b>V 2026</b>	<b>Të autorizuar për zbatim</b>	<b>Burimi i mundshëm i financimit</b>	<b>Relevanca e mbështetjes së jashtme</b>
2.2.1 Zbatimi i inventarit të kullotave dhe staneve i mundësuar në GIS	1	Është bërë inventari i të gjithë staneve në zonë dhe i mundësuar me GIS; duke përfshirë kapacitetin e kullotave, gjendjen e staneve dhe infrastrukturës, ndikimin në habitatet e ndjeshme	1					Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH, MBPEU, NP për kullotat, institucione dhe universitete përkatëse dhe ekspertë	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
2.2.2 Identifikimi i nevojës për masat mbrojtëse të habitateve dhe llojeve të kërcënuara të cilat lidhen me kullotjen	2	Vlerësim i përgatitur për mbrojtjen e habitateve dhe llojeve të kërcënuara në kullota me përqëndrim në zonat e mbrojtura në mënyrë të rreptë		1				Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH, MBPEU, NP për kullotat, institucione dhe universitete përkatëse dhe ekspertë	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë
2.2.3 Plan i përgatitur për përdorimin e qëndrueshëm të kullotave në Parkun Kombëtar	2	Plan i përgatitur për përdorimin e qëndrueshëm të kullotave, kontrata me barinj të dhe fermerët për mirëmbajtjen e kullotave		1				Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH, MBPEU, NP për kullotat, institucione dhe universitete përkatëse dhe ekspertë	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme
2.2.4 Trajnimi i barinjve mbi vlerat natyrore, zhvillimit turistik dhe përmirësimit të cilësisë së produkteve	1	Program zbatues trajnimi për barinj të	1	1	1			Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH, MBPEU, NP për kullotat, institucione dhe universitete përkatëse dhe ekspertë	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
2.2.5 Përmirësimi i kolibeve malore, rrugëve dhe infrastrukturës përkatëse për stanet	2	Raport mbi përmirësimin e kabinave malore dhe infrastrukturës përkatëse		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM- së në bashkëpunim me MMJPH, MBPEU, NP për kullotat, institucione dhe universitete përkatëse dhe ekspertë	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme
2.2.6 Program për mbështetjen e kullotjes tradicionale të bagëtive (përshfirë: qentë e stanit)	2	Numri i barinjve dhe deleve të mbështetura nga programi		1	1	1		Struktura e Menaxhimit të ZM- së në bashkëpunim me MMJPH, MBPEU, NP për kullotat, institucione dhe universitete përkatëse dhe ekspertë	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

5.2.3. Përdorimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore në fshatrat përreth

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
2.3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i masave agromjedisore për menaxhimin e parcelave bujqësore veçanërisht tokën e braktisur	3	Numri i masave të zhvilluara, madhësia e zonës ku këto masa do të zbatohen, numri i zonave pilote të përzgjedhura dhe programi pilot për mbështetjen e fermerëve në zbatimin e masave për peizazhet e degraduara			1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH, MBPEU, NP për kullotat, institucione dhe universitete përkatëse dhe ekspertë	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë
2.3.2 Vlerësimi i ndikimeve të programeve pilote agromjedisore	3	Studim vlerësues mbi ndikimet e programeve pilote agromjedisore					1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së në bashkëpunim me MMJPH, MBPEU, NP për kullotat, institucione dhe universitete përkatëse dhe ekspertë	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë

5.2.4. Përdoimi i qëndrueshëm i bimëve dhe frutave të malit

7.1.2 Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve edukative ( llojet, veprimtaritë e lejuara dhe të ndaluara, kodi i sjelljes, etj.)	2	Janë shtypur dhe dhe shpërndarë një numër i madh i materialeve informuese	1	1	1			Struktura e menaxhimit të ZM-së, MMJPH, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme
7.1.3 Ndërtimi i infrastrukturës edukative për fëmijët dhe përshtatja për persona me aftësi të kufizuara	3	Numri i infrastrukturave të ndërtuara			1	1		Struktura e menaxhimit të ZM-së, MMJPH, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

5.7.2. Programi i komunikimit duke përfshirë veprimtaritë në mediat sociale

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
7.2.1 Përgatitja dhe mirëmbajtja e website-it, hapja e email-eve për punonjësit, krijimi i profilit	1	Website funksional i lidhur me GIS; numri i llogarive të email-it të stafit të PK-s; profil aktiv në median sociale	1	1	1	1	1	Struktura e menaxhimit të ZM-së, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
të parkut në median sociale										
7.2.2 Mundësimi i rregullt i informacionit rreth parkut në website dhe median sociale	1	Numri i postimeve; Numri i pjestarëve	1	1	1	1	1	Struktura e menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët
7.2.3 Përgatitja e materialit informues promociional rreth biodiversitetit për popullsinë vendase	2	Material i përgatitur dhe i shpërndarë		1	1	1	1	Struktura e menaxhimit të ZM-së, MMJPH, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

5.7.3. Programe edukative për grupe të ndryshme të targetuara

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes nga jashtë
7.3.1 Përgatitja e strategjisë dhe planit për	3	Strategji vullnetare e përgatitur			1			Struktura e menaxhimit të ZM-së, MMJPH, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së,	E ulët

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes nga jashtë
angazhimin e vullnetarëve									BE-së, GIZ-it dhe të tjera	
7.3.2 Grup i edukuar i stafit të parkut për të punuar me grupet e organizuara të fëmijëve ( shkolla fillore dhe të mesme)	2	Numri i edukuar i stafit për të punuar me fëmijët			1	1		Struktura e menaxhimit të ZM-së, MMJPH, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme
7.3.3 Krijimi i akademisë së natyrës për fëmijët	3	Akademia e natyrës e krijuar me një program edukativ dhe një numër seminaresh			1	1	1	Struktura e menaxhimit të ZM-së, MMJPH, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme
7.3.4 Zhvillimi i paketave të ndryshme edukative për grupe dhe moshë të ndryshme të targetuara	2	Numri i zhvilluar i paketave edukative të zbatuara			1	1	1	Struktura e menaxhimit të ZM-së, MMJPH, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

5.8. Pogrami i qeverisjes, menaxhimit, organizimit të punës dhe programi i financimit

5.8.1. Forcimi Institucional i zonës së mbrojtur

Vepri	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
8.1.1 Zhvillimi i një strategjie të përgjithshme për PK me stafin përfshirë vizionin, qëllimet, prioritetet dhe detyrat për mbrojtjen, kërkimin/studimin, menaxhimin e llojeve, habitateve, zhvillimit turistik, zhvillimit vendas	1	Krijimi i Dokumentit strategjik dhe shpërndarja midis stafit	1					Struktura e Menaxhimit e ZM-së, MMJPH, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë
8.1.2 Mundësimi i ambjenteve të përshtatshme të punës për punonjësit e Strukturës së Menaxhimit të ZM-së	1	Janë formuar zyra me hapësira pune të mjaftueshme për stafin e PK-së	1					Struktura e Menaxhimit e ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
8.1.3 Sigurimi i teknologjisë së TIK dhe pajisjeve GIS, pajisje për monitorimin dhe mbrojtjen nga zjarri, automjetet 4x4 (fuoristradë), hulumtim	1	Pajisje bashkëkohore dhe funksionale të siguruar për stafin e PK-së	1					Struktura e Menaxhimit e ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë
8.1.4 Zhvillimi i një liste të projekteve prioritare për t'u zbatuar në 5 vitet e ardhshme	2	Është përpiluar lista e projekteve		1				Struktura e menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët

5.8.2. Programi i Drejtimit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
8.2.1 Zhvillimi i një programi drejtimi duke përfshirë proceset e punës, strukturat e menaxhimit, mbikqyrjen dhe	1	Program i drejtimit i zhvilluar dhe zbatuar në institucione publike	1	1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështesjes së jashtme
drejtimin e stafit										

### 5.8.3. Programi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështesjes së jashtme
8.3.1 Zhvillimi i një regjistri të kompetencave të nevojitura për një menaxhim efektiv të parkut duke përfshirë nivelet	1	Është përpiluar Regjistër për kompetencat për institucionet publike dhe është zbatuar nga stafi	1					Struktura e Menaxhimit të ZM-së, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë
8.3.2 Rekrutimi i stafit të kualifikuar dhe të motivuar duke u bazuar në Termat e Referencës të përcaktuara më parë brenda	1	Rekrutimi i stafit të kualifikuar në bazë të regjistrit të kompetencave	1	1				Struktura e Menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët



Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
regjistrin të kompetencave										
8.3.3 Zhvillimi dhe zbatimi i programit të burimeve njerëzore	1	Program i burimeve njerëzore i zbatuar dhe i përdorshëm në institucionet Publike; numri i trajnimeve, numri i pjesëmarrësve në trajnime	1	1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së, ekspertë	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme
8.3.4 Trajnimi për përgatitjen e programeve vjetore, raporteve nga protokollët e monitorimit	1	Raporte vjetore të përgatitura	1	1		1		Struktura e Menaxhimit të ZM-së, MMJPH, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë
8.3.5 Certifikimi dhe pajisja e rojeve në zonën e mbrojtur-Shërbimi i Rojeve të Pyllit	1	Shërbimi i rojeve të pyllit është funksional	1	1				Struktura e Menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
8.3.6 Zhvillimi i një programi për vlerësimin e performancës, kushteve të punës, dhe skemave shpërblyese	1	Janë përgatitur raporte vjetore të vlerësimit të performancës	1	1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

5.8.4. Menaxhimi Financiar

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
8.4.1 Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie për qëndrueshmëri financiare duke përfshirë planin e biznesit, donatorët ndërkombëtarë, programet ndërkufitare, kompensimet e turistëve dhe burimet alternative	1	Strategjia për qëndrueshmëri financiare e përgatitur dhe e zbatuar	1	1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E lartë

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
8.4.2 Krijimi i një programi të përhershëm në vazhdimësi për planifikimin financiar dhe menaxhimin	1	Raporte vjetore financiare	1	1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët

#### 5.8.5. Raportimi Administrativ dhe Dokumentacioni

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
8.5.1 Raportimi në nivel kombëtar duke përfshirë auditimin dhe monitorimin e zbatimit të planit vjetor, planit të menaxhimit dhe planit vjetor METT	1	Raporte vjetore të përgatitura, përpilimi i METT	1	1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së, MMJPH, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
8.5.2 Përgatitja e Planit Operativ Pesëvjeçar për periudhën e ardhshme pesëvjeçare të zbatimit të Planit të Menaxhimit	1	Plani Operativ Pesëvjeçar i përgatitur dhe i miratuar					1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët
8.5.3 Raportimi mbi progresin në nivel kombëtar	2	Raporte të përgatitura në vitin 2024 dhe vitin 2026			1		1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme

5.8.6. Komunikimi dhe Bashkëpunimi

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
8.6.1 Krijimi i një programi të përhershëm për komunikimin dhe bashkëpunimin në rajon	1	Të përcaktuara dhe të zbatuara përgjegjësitë e programit të përhershëm të bashkëpunimit në rajon		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
8.6.2 Krijimi i një programi të përhershëm për komunikimin dhe bashkëpunimin me institucionet në nivel kombëtar	1	Të përcaktuara dhe të zbatuara përgjegjësitë e programit të përhershëm të bashkëpunimit me institucionet në nivel kombëtar	1	1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët
8.6.3 Krijimi i bashkëpunimit me organizata jo-qeveritare, universitetet, institucione të tjera eksperte dhe palë të tjera të interesuara për të mbështetur hulumtimin dhe projektet	1	Të përcaktuara dhe të zbatuara përgjegjësitë e programit të përhershëm të bashkëpunimit me botën akademike dhe OJQ-të	1	1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët
8.6.4 Program për bashkëpunimin efikas me pronarët e pyjeve private	1	Të përcaktuara dhe të zbatuara përgjegjësitë e programit të përhershëm të bashkëpunimit me pronarë të pyjeve private	1	1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët

Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Maleve të Sharrit

Veprimtaria	Prioriteti	Treguesi	V 2022	V 2023	V 2024	V 2025	V 2026	Të autorizuar për zbatim	Burimi i mundshëm i financimit	Relevanca e mbështetjes së jashtme
8.6.5 Krijimi i një programi të përhershëm për komunikimin dhe bashkëpunimin me institucionet dhe partnerët ndërkufitarë në nivel ndërkombëtar	2	Të përcaktuara dhe të zbatuara përgjegjësitë e programit të përhershëm të bashkëpunimit me institucione dhe partnerë ndërkufitarë zbatuara		1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së, ekspertët	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E mesme
8.6.6 Krijimi i një programi të përhershëm për komunikimin dhe bashkëpunimin me SHA EEM për menaxhimin e Sistemit të Ujërave të Sharrit (Sharski Vodi)	1	Të përcaktuara dhe të zbatuara përgjegjësitë e programit të përhershëm të bashkëpunimit me SHA EEM	1	1	1	1	1	Struktura e Menaxhimit të ZM-së	Buxheti i menaxhimit të Parkut Kombëtar, UNEP-it, UNDP-së, BE-së, GIZ-it dhe të tjera	E ulët

## 6. Menaxhimi dhe Qeverisja

### 6.1. Plani për menaxhimin dhe qeverisjen

Ministria e Mejdosit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për të gjithë zonat e mbrojtura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të Ligjit për shpalljen e pjesës së Maleve të Sharrit Park Kombëtar (Gazeta Zyrtare e RM nr. 175/2021), zona e mbrojtur do të menaxhohet nga Institucioni Publik i Parkut Kombëtar të Maleve të Sharrit.

Një parakusht për menaxhimin e suksesshëm të një parku kombëtar është bashkëpunimi i fuqishëm ndërmjet organit të përcaktuar qeverisës dhe përfshirjes aktive të tij, të të gjitha komunave përkatëse, banorëve lokalë dhe të gjithë aktorëve të ndikuar. Të gjithë këto grupe duhet të miratojnë Planin e propozuar të Menaxhimit dhe të kontribuojnë bashkërisht në zbatimin e tij.


#### 6.1.1. Struktura menaxhuese

Institucioni Publik i PKMSH u krijua me anë të një vendimi të qeverisë (Gazeta Zyrtare 175/2021). Në bazë të këtij vendimi, struktura menaxhuese dhe qeverisëse përfshin organet e mëposhtme:

- Bordin e menaxhimit
- Drejtorin operativ të bordit
- Bordin e ekspertëve
- Bordin për menaxhimin operativ dhe financiar

Kompetencat, struktura, organizimi, dhe përgjegjësitë e këtyre organeve përcaktohen në Statutin e IP PKMSH (2021), në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligjin për Shpalljen e Maleve të Sharrit Park Kombëtar.

IP PKMSH menaxhohet nga drejtori operativ i bordit, i cili menaxhon punën e institucionit, merr vendimet, prezanton dhe përfaqëson institucionin dhe është përgjegjës për aspektet ligjore të PK-së. Ky drejtor emërohet nga Qeveria në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe Statuti i IP PKMSH dhe ka një mandat katërvjeçar.



**Organogram i Institutit Publik**

IP PKMSH krijon një bord ekspertësh që përbëhet nga një numër anëtarësh (që do të vendosen nga qeveria), Drejtori dhe një përfaqësues nga secili sektor, që emërohen apo shkarkohen nga Drejtori. Ky bord ekspertësh është përgjegjës për detyrat e mëposhtme:

1. Punën e ekspertëve të institucionit publik;
2. Vendimet në lidhje me çështjet e ekspertëve në pajtim me kriteret e përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Statutin e Parkut Kombëtar dhe dokumente të tjera ligjore;
3. Përcakton fushën e ekspertizës për programin vjetor dhe zhvillimin e tij;
4. Këshillon drejtorin në lidhje me organizimin e punës, kushtet e punës dhe zhvillimin e ardhshëm të planifikuar;
5. Propozon anëtarët për në Bordin e Menaxhimit në bazë të kompetencave dhe ekspertizës së kërkuar;
6. Propozon masa të jashtëzakonshme në situata emergjence;
7. Organizon dhe zbaton trajnimin për shërbimin e rojeve të pyllit, dhe për shuarjen e zjarreve dhe fatkeqësive natyrore;
8. Zbaton veprime të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statutin e IP PKMSH.

IP PKMSH do të krijojë këshillat shkencore dhe të aktorëve të përfshirë. Këto kanë role këshillues për menaxhimin e zonës së mbrojtur dhe për vendimmarrjen mbi çështjet operative dhe janë të rëndësishëm për nxitjen dhe ruajtjen e bashkëpunimit të mirë ndërmjet të gjitha aktorëve përkatës.



### 6.1.2. Mekanizmat dhe procedurat për pjesëmarrjen e aktorëve të përfshirë

Zonat e mbrojtura janë pasuri publike dhe si të tilla pjesëmarrja publike është thelbësore për sigurimin e mbrojtjes së duhur të tyre dhe gëzojnë mbështetje të fuqishme publike. Dëshira për përfshirje më të madhe të publikut në vendimmarrjen e qeverisë është shprehur qartë në diskutimet e konsultimit publik në rajonin e PKMSH-së.

Sigurimi i pjesëmarrjes bashkëpunuese të publikut është një proces i dyanshëm nga i cili mund të mësojnë dhe përfitojnë menaxhimi i parkut kombëtar dhe aktorët e përfshirë.


Disa avantazhe të rëndësishme të përfshirjes së publikut në menaxhimin dhe udhëheqjen e Parkut kombëtar Mali Sharr:

- Përmirësimi i të kuptuarit për pritshmëritë e turistëve dhe nevojave të grupeve të përdoruesve
- Përmirësimi i të kuptuarit lidhur me çështjet për ruajtjen
- Mbështetje për monitorimin dhe përkrahjen e mbrojtjes së biodiversitetit
- Mbështetje për luftën kundër veprimtarive të jashtëligjshme
- Ndërhyrje të menjëhershme për shuarjen e zjarreve
- Njohuri teknike në rritje të stafit të PK dhe anëtarëve të komunitetit
- Besueshmëri në rritje e menaxhimit të PK-së brenda komunitetit
- Cilësi e përmirësuar e vendimmarrjes së menaxhimit të PK
- Pajtueshmëri më e madhe e komunitetit përmes zotërimit në rritje të zgjidhjeve
- Akses më i madh ndaj aftësive dhe njohurive të komunitetit

Disavantazhe të mundshme të përfshirjes së publikut:

- Merr kohë më të gjatë
- Nevoja për trajnim dhe krijim të kapaciteteve të stafit të menaxhimit të PK për komunikimin
- Vështirësi lidhur me arritjen e debatit konstruktiv në rastet kur grupe me interesa të ndryshme, mbajnë qëndrime të forta.

Zona e PKMSH ka një larmishmëri të madhe të grupeve të ndryshme të interesit. Grafiku i mëposhtëm paraqet një pasqyrë të përgjithshme të aktorëve kryesorë të cilët ishin ftuar dhe/ose përfshirë në procesin e hartimit të këtij plani menaxhimi, përmes konsultimeve të shumta:



Pasqyra e përgjithshme e grupeve të identifikuara të aktorëve të përfshirë të cilët mund të kenë përfshirje direkte ose indirekte në Planin e Menaxhimit të PKMSH:

- Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH)
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU)
- Ministria e Kulturës
- Delegacioni i BE-së (BED)
- GIZ (Deutsche Gesellschaft für International Zusammenarbeit)
- Parku Kombëtar Sharri, Kosovë
- Qendra për Edukim dhe Zhvillim në Tetovë (QEZH)
- Ndërmarrja Publike e Pyjeve të Maqedonisë
- Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Kullotave
- AD ESM (Sharski Vodi)
- ELEM Macedonia dhe rezorti i skive Kodra e Diellit
- Operatorët turistikë lokalë
- Komuna e Tetovës
- Komuna e Gostivarit
- Komuna e Bogovinjës
- Komuna e Tearcës
- Komuna e Vrapçishtës

- Komuna e Mavrovës dhe Rostushës
- Komuna e Jegunovcës
- Komunitetet lokale
- Mbajtësit e koncesioneve të gjuetisë
- Pronarët e hoteleve
- Universitetet dhe institucionet shkencore
- Klubet e alpinizmit
- Organizatat e shoqërisë civile

Rekomandohet fuqimisht që Institucioni Publik i Parkut Kombëtar të Maleve të Sharrit të zhvillojë një strategji të qartë të angazhimit të aktorëve për të drejtuar pjesëmarrjen publike dhe për të monitoruar bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të përfshirë dhe Parkut Kombëtar.

Tematikat dhe mekanizmat e propozuara për konsultim dhe pjesëmarrje të aktorëve (lista nuk është përfundimtare):

Grupi i aktorëve të përfshirë	Aktorët që do të përfshihen	Tematikat	Frekuenca	Mekanizmat
Turizmi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Operatorët turistikë</li> <li>Ofruesit e shërbimeve turistike</li> <li>Klubet e ngjitjes dhe klube të tjera sportive</li> <li>Rezorti i skive</li> <li>Menaxhimi i natyrës së egër (kafshëve të egra)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Promovimi i PK-së tek vizitorët</li> <li>Sistemi i monitorimit të vizitorëve dhe ndikimi i turizmit</li> <li>Zhvillimi i rezortit të skive</li> </ul>	Dy herë në vit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Platforma për bashkëpunimin dy herë në vit</li> <li>Panairi i përvitshëm i turizmit ndërkombëtar në PK</li> </ul>
Komunat dhe përfaqësues të komuniteteve lokale	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të gjitha komunat</li> <li>Përfaqësues të fshatrave në PK</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Parandalimi i veprimtarive të paligjshme</li> <li>Menaxhimi i mbetjeve</li> <li>Mirëmbajtja e rrugëve</li> <li>Mirëmbajtja e furnizimit me rrymë elektrike</li> <li>Përdorimi i burimeve natyrore (dru, bimë, ujë, etj.)</li> <li>Menaxhimi i rrezikut (erozioni, zjarret, vërshimet e papritura, orteqet, etj.)</li> </ul>	Katër herë në vit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Platforma për bashkëpunimin</li> <li>Grupi i punës për zgjidhjet inovatore për ngrohje</li> <li>Udhëtime studimore në vende të tjera për sisteme inovatore për ngrohje</li> </ul>
Mirëmbajtja e sistemit të Ujit të Sharrit	<ul style="list-style-type: none"> <li>AD ESM</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mirëmbajtje, monitorim dhe ndërhyrje e rregullt</li> </ul>	Katër herë në vit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Platforma për bashkëpunimin</li> </ul>
Komuniteti shkencor	<ul style="list-style-type: none"> <li>Universitetet</li> <li>OJQ-të</li> <li>Konsulentët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hulumtimi shkencor</li> <li>Monitorimi i llojeve dhe habitateve</li> <li>Edukimi</li> </ul>	Një herë në vit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Konferenca shkencore për çështje të veçanta</li> </ul>
Parqe fqinje dhe kombëtare	<ul style="list-style-type: none"> <li>PK i Mavrovës</li> <li>PK Sharri (Kosovë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i bashkëpunimit të rregullt kufitar</li> </ul>	Dy herë në vit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Platforma për bashkëpunimin</li> <li>Statusi ndërkufitar i PK</li> </ul>

Grupi i aktorëve të përfshirë	Aktorët që do të përfshihen	Tematikat	Frekuenca	Mekanizmat
	<ul style="list-style-type: none"> <li>PK Korab Koritnik (Shqipëri)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Financim ndërkufitar</li> <li>Parandalim i veprimtarive të paligjshme</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Shkëmbimi</li> <li>Udhëtime studimore me ZM të tjera ndërkufitare</li> </ul>
Blegtoaria, bujqësia dhe mbledhja e bimëve të egra	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kullotat e IP</li> <li>Mbajtësit e koncesioneve të kullotave</li> <li>Mbledhësit/grumbulluesit e bimëve të egra</li> <li>Fermerët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdorimi dhe zhvillimi i staneve</li> <li>Prodhimi blegtoral</li> <li>Kullotja dhe turizmi</li> <li>Marketingu i produkteve</li> </ul>	Dy herë në vit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Platforma për bashkëpunimin</li> <li>Udhëtime studimore në ZM të tjera me kushtet dhe veprimtaritë e ngjashme</li> <li>Pjesëmarrja aktive në panairin e përvitshëm të turizmit</li> </ul>
Shoqatat dhe grupet kulturore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Grupet lokale të përfshira në ruajtjen e traditave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Promovimi i traditave dhe kulturës lokale</li> <li>Organizimi i ngjarjeve kulturore</li> </ul>	Dy herë në vit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Platforma për bashkëpunimin</li> <li>Organizimi i ngjarjeve të përvitshme për traditat lokale me partnerë të rajoneve të tjera</li> </ul>

### 6.1.3. Administrimi i planit të menaxhimit

Në bazë të Nenit 98, paragrafi (7) të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Institucioni Publik Kombëtar i Maleve të Sharrit është përgjegjës për vlerësimin e zbatimit të Planit të Menaxhimit dhe paraqitjes së përfundimeve të tij në raportin vjetor. Raporti duhet të paraqitet pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor deri më 31 janar të vitit pasues. Autoriteti i menaxhimit siguron raportet e mëposhtme:

- Raporte çdo gjysëm viti për veprimtaritë;
- Raport për zbatimin e veprimtarive të planit vjetor të punës;

Në bazë të Nenit 99, paragrafi (2) të të njëjtit ligj, në fund të vitit të pestë dhe përfundimtar të zbatimit të planit të menaxhimit, duhet të kryhet një vlerësim i rezultateve. Në bazë të këtij vlerësimi, Institucioni Publik i PKMSH-së do të redaktojë dhe amendojë Planin e Menaxhimit dhe të konsultohet me publikun. Procedura e përgatitjes së një PM të ri duhet të fillojë të paktën një vit përpara skadimit të planit aktual.

## 6.2. Plani për burimet njerëzore dhe burime të tjera

### 6.2.1. Burimet njerëzore

Për zbatimin e menaxhimit të përgjithshëm të Parkut Kombëtar dhe programeve të tij operative, IP PKMSH duhet të pajiset me burimet e duhura njerëzore. Struktura organizative e Institucionit Publik Parku Kombëtar Mali Sharr vendoset në përputhje me natyrën e veprimtarisë për të cilën është themeluar dhe të cilën e kryen, me qëllim të arritjes së menaxhimit dhe organizimit efektiv të funksionimit dhe realizimit të interesit publik në menaxhim.

Në bazë të nenit 17, paragrafit 7, të Ligjit për të punësuarit publikë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 15 të Statutit të institucionit publik "Parku Kombëtar Mali Sharr", Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut, drejtori i institucionit më 05.5.2022 ka miratuar Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në IPPKMSH.


Sipas Rregullores për organizimin e brendshëm të IP PKMSH, institucioni ka katër njësi organizative – Departamente, si në vijim:

1. Departamenti për Çështje Juridike, ekonomike dhe të përgjithshme
2. Departamenti për mbrojtjen e natyrës
3. Departamenti për shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore,
4. Departamenti për aktivitete alternative dhe edukim mjedisor.

Çdo departament ka një udhëheqës dhe të punësuar. Numri i paraparë i ekzekutuesve, kushtet e veçanta të nevojshme për kryerjen e punëve dhe detyrave të punëve të caktuara, si dhe përshkrimi i vendeve të punës sipas detyrave dhe pjesëve organizative përcaktohen me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në IP PKMSH.

Prej këtu në departamentin për çështje juridike, ekonomike dhe të përgjithshme janë të parapara 12 vende pune, në departamentin për mbrojtje të natyrës 19 vende pune, në departamentin për shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore janë siguruar 13 vende pune ndërsa në departamentin për veprimtari alternative dhe ekologjike janë paraparë

gjithsej 5 vende pune. Duke pasur parasysh mungesën e përvojës paraprake në numrin e nevojshëm të punonjësve për të cilët në të njëjtën kohë institucioni do të mund të sigurojë financim të përhershëm, si për fillim IPPKMSH do të funksionojë me pesëdhjetë punonjës. Nëse gjatë punës shfaqet nevoja për të rritur numrin e punonjësve për të cilët institucioni do të jetë në gjendje të sigurojë financimin e duhur, ky numër mund të rritet.



Paraqitja e departamenteve dhe numrin e punonjësve



Në departamentin për çështje juridike, ekonomike dhe të përgjithshme kryhen këto aktivitete:

- çështjet juridike
- çështjet financiare, ekonomike
- prokurimet publike dhe punët tregtare,
- punët e përgjithshme ()

Departamenti i Mbrojtjes së natyrës përfshin:

- mbikëqyrjen teknike profesionale dhe ruajtjen e parkut,

Departamenti për Shfrytëzimin e Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore është i organizuar në:

- njësitë hapësinore pyjore (gjashtë sh.p.e.),
- punime ndihmese-teknike (mekanizimi)

Departamenti i aktiviteteve alternative dhe edukimit mjedisor përfshin:

- edukim mjedisor
- turizëm
- marketing

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (neni 136), të punësuarit në shërbimet profesionale të institucionit publik - parku kombëtar të cilët kryejnë veprimtari me interes publik lidhur me mbrojtjen e specieve të egra, mbrojtjen e biodiversitetit dhe peizazheve, menaxhimin e zonave të mbrojtura, si dhe kryerjen e të gjitha veprimtarive që dalin nga ligjet në fushën e mjedisit jetësor, dhe janë me rëndësi për zonën e mbrojtur të përcaktuar në përputhje me të njëjtin ligj, kanë statusin e nëpunësit shtetëror.

### **Fusha e punës së pjesëve organizative**

Në kuadër të departamentit për çështje juridike, ekonomike dhe të përgjithshme kryhen këto aktivitete:

➤ *çështjet juridike;*

- monitorimin dhe zbatimin e rregulloreve normative-juridike, ligjeve, akteve nënligjore, rregulloreve dhe procedurave për funksionimin e IPPKMSH-së,
- përgatitjen e dokumentacionit ligjor dhe raporteve,
- organizon dhe zbaton procedurat për dhënien e kontratave të prokurimit publik.
- ofron mbështetje profesionale dhe operative në kryerjen e procedurave për

përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore dhe materiale.

➤ *Çështjet financiare dhe të kontabilitetit;*

- ndjekjen dhe zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore, rregulloreve dhe procedurave të kontabilitetit dhe financiar,
- organizon dhe përgatit dhe përgjigjet për dokumentacionin financiar - kontabël

dhe raportet e PINP-së.

- Departamenti është përgjegjës për të gjitha çështjet financiare si dhe për kontrollin e punëve financiare nëpërmjet kryerësve përkatës sipas vendeve të

punës si dhe për menaxhimin e fondeve të IPPKMSH-së përmes menaxhimit të buxhetit të IPPKMSH-së,

- Bën të gjitha pagesat dhe arkëtimet që kanë të bëjnë me thesarin,
- Paraqet raporte mujore, gjashtëmujore dhe vjetore
- Bën evidentimin dhe pagesën e kompensimeve,
- Bashkëpunon me departamente të tjera për arkëtimin e detyrimeve,
- Bën llogaritjen dhe pagesën e pagave dhe punën e rregullt të thesarit si dhe bën rregjistrimin e rregullt të mjeteve dhe pajisjeve në magazinë.

➤ *Prokurimet publike dhe punët komerciale*

*Siguria dhe shëndeti në punë dhe punët e përgjithshme*

- kujdeset për sigurinë dhe shëndetin në punë përmes zbatimit të rregulloreve përkatëse, asistencës dhe udhëzimeve profesionale dhe çështje të tjera të përgjithshme,
- sigurimin e punonjësve dhe objekteve afariste,
- mirëmbajtjen e higjienës në objektet afariste dhe në ambiente dhe zona të tjera.

Në departamentin për mbrojtjen e natyrës punimet kryhen përmes:

➤ *Mbikëqyrja teknike profesionale dhe ruajtjen e parkut,*

- kryen mbrojtjen e IPPK Mali Sharr si zonë e mbrojtur përmes aktiviteteve të planifikimit të vazhdueshëm, organizimit, marrjes së masave, monitorimit dhe analizës së aktiviteteve në fushën e mbrojtjes së natyrës të parashikuara me Planin e udhëheqjes, ligjet dhe aktet e tjera të IPPK Mali Sharr.
- kryen mbikqyrjen dhe ndjekjen e vazhdueshme të kushteve në territorin e parkut kombëtar dhe kryen veprimtari që janë kompetencë e parkut në lidhje me mbrojtjen e florës dhe faunës në përputhje me programet për mbrojtjen e natyrës dhe bën mbikëqyrjen e zbatimit të veprimtarive të lejuara në zonën e mbrojtur.
- është përgjegjës për mbajtjen e shënimeve dhe dokumentimin e vlerave dhe bukurive natyrore dhe të tjera në park, vendosjen e regjimit të mbrojtjes dhe kujdeset për mbrojtjen, mbarështimin dhe gjuajtjen e kafshëve të egra, mbrojtjen dhe grumbullimin e llojeve të egra të bimëve dhe kërpudhave dhe frutave të tjera të pyllit , si dhe kultivimin sasior të peshqive dhe peshkimin tradicional.

Në Departamentin për shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore të IPPK Mali Sharr punët bëhen përmes:

➤ *Njësive pyjore-hapësinore;*

- organizimin e aktiviteteve të IPPK Mali Sharr që lidhen me shfrytëzimin e burimeve natyrore në zonën e mbrojtur përmes aktiviteteve të planifikimit të vazhdueshëm, organizim, ndjekje dhe analizim të punëve në fushën e mbrojtjes së natyrës të parapara me Planin për udhëheqje dhe akteve të tjera të IPPK Mali Sharr.

- kryen mbikqyrje dhe ndjekje të vazhdueshme të situatës në territorin e parkut kombëtar dhe kryen veprimtari që janë kompetencë e parkut në përputhje me programet dhe kryen mbikëqyrjen e zbatimit të programeve afatgjata dhe afatshkurtra në kuadër të veprimtarive të lejuara në zonën e mbrojtur për të realizuar Planin e udhëheqjes.
  - kujdeset për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në interes të zhvillimit aktual dhe të ardhshëm pa dëmtuar natyrën dhe ekuilibrin natyror në IPPK Mali Sharr.
- *Punët ndihmëse-teknike (mekanike)*
- mirëmbajtja dhe kujdesi për makineritë dhe automjetet,
  - të dhënat e servisimit dhe konsumit të karburantit dhe lubrifikantëve,
  - mirëmbajtja e rregullt të infrastrukturës në park.

Në Departamentin për aktivitete alternative dhe edukim mjedisor punët bëhen përmes:

- Krijimi i kushteve për zhvillimin e ekoturizmit në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Në të njëjtën kohë, përmes aktiviteteve kulturore, shkencore, arsimore dhe rekreative ruan gjendjen natyrore të Parkut Kombëtar dhe krijon kushte për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionin e vizitorëve, organizon aktivitete për ngritjen e vetëdijes publike dhe procesin edukativ për mbrojtjen e IP PKMSH. Departamenti organizon dhe zbaton promovimin e IP PKMSH dhe koordinon publikimin e botimeve, broshurave dhe të ngjashme.
- *Zhvillimin e shërbimeve turistike;*
- Krijon kushte për zhvillimin e turizmit në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.
  - përmes aktiviteteve kulturore, shkencore, arsimore dhe rekreative ruan gjendjen natyrore të Parkut Kombëtar dhe krijon kushte për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionin e vizitorëve;
  - Mirëmban infrastrukturën e parkut.
- *Zhvillimi i shërbimeve të marketingut dhe komunikimit;*
- organizon aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut dhe procesin edukativ për mbrojtjen e IP PKMSH.
  - organizon dhe zbaton promovimin e IP PKMSH dhe koordinon publikimin e botimeve, broshurave, etj.
  - departamenti, përveç qëllimeve edukative dhe trajnuese, organizon aktivitete rekreative duke u kujdesur për qëndrueshmërinë e gjendjes natyrore të parkut kombëtar,
  - ndërton dhe mirëmban infrastrukturën dhe objektet në park.

**Nevoja për njohuri dhe aftësi specifike për menaxhimin e zonës**

Institucioni i ri publik Parku Kombëtar Mali Sharr ka një mundësi unike për të punësuar staf të përshtatshëm i cili do t'u përgjigjet të gjitha përgjegjësiave dhe do t'u përgjigjet plotësisht detyrave të përcaktuara për vendin e punës përkatës të përshkruara në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në IPPKMSH. Institucioni formalisht përgatit planin për trajnimet e nevojshme për punonjësit sipas kërkesës së MSHIA-së dhe u referohet punonjësve administrativë sipas ligjit përkatës. Gjithashtu, në Programin Vjetor që parku përgatit dhe dërgon për miratim në MMJPH, parashikohen trajnime të ndryshme për monitorimin, menaxhimin e zjarreve etj., të cilat zakonisht realizohen në kuadër të aktiviteteve të ndryshme të projektit. Pjesë e trajnimeve të ndryshme të planifikuara për punonjësit, si ato profesionale ashtu edhe ato të trajnimeve në lidhje me funksionimin e përditshëm të Institucionit janë:

- Trajnim bazë (kompjuter, anglisht ose gjuhë të tjera, kontabilitet, siguri në punë);
- Trajnimi profesional (GIS, komunikimi me palët e interesuara, përdorimi/mirëmbajtja e faqeve të internetit dhe mediave sociale, monitorimi i specieve dhe habitateve të rëndësishme, planifikimi dhe monitorimi i menaxhimit, masat e ruajtjes për habitatet dhe speciet e caktuara, edukimi për H2000).

#### 6.2.2. Pajisjet dhe infrastruktura

Për të qenë plotësisht funksionale, institucioni publik Parku Kombëtar duhet të jetë e furnizuar së paku me:

- Ndërtesë qendrore të parkut kombëtar, me hapësira dhe ambiente të përshtatshme për punonjësit. Rrjedhimisht, në lidhje me objektin administrativ duhet të merret parasysh mundësia e ndërtimit të objektit me kushte të përshtatshme - zyra të mjaftueshme për punonjësit, sallë mbledhjesh etj. Për mbarëvajtjen e punës është e nevojshme blerja e një serveri dhe pajisje kompjuterike për punonjësit në objektin administrativ, të cilat do të jenë të lidhura në rrjet dhe do të ofrojnë kushtet e përshtatshme për ruajtjen/informacionin e të dhënave dhe mbrojtjen e tyre.
- Qendra e Informacionit të vizitorëve, e cila do të ishte më mirë të punësohte njerëz gjatë periudhave më të ngarkuara.
- Disa objekte terreni për stafin në zona të ndryshme që do të shërbejnë si strehë, kontroll dhe ruajtje.
- Depo/magazina me pajisje për: menaxhimin, monitorimin, parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, si dhe mundësinë e vendosjes së rezervuarëve të ujit në disa lokacione.
- Pajisje me të paktën 10 automjete të përshtatshme terreni, shumica e të cilave duhet të jenë të përhershme në terren në zonën e mbrojtur. Prokurimi duhet të bëhet gradualisht gjatë një periudhe disavejeçare. Për mirëmbajtjen e tyre duhet të ndahen mjete të përshtatshme, por është i nevojshëm edhe rinovimi i rregullt i tyre dhe prokurimi i pajisjeve shtesë. Në këtë mënyrë, aktivitetet në terren për monitorimin e specieve dhe habitateve, zbatimin e mbrojtjes së drejtpërdrejtë të parkut, ruajtjen dhe mbrojtjen nga zjarri do të zhvillohen pa probleme. Disa automjete duhet të jenë në gjendje të përshtatshme me mbrojtjen nga zjarri.
- Pajisjet e tjera në terren përfshijnë: pajisje personale për shërbimin e sigurisë, uniforma për të gjithë punonjësit, pajisje të përshtatshme zjarrfikëse, kamera për monitorim të rregullt, drone me sensorë të veçantë për paralajmërimin e hershëm të zjarrit dhe softuer të ofruar për analizën e zjarrit, dylbi, teleskopë fiks vëzhgimi për

përdorim turistik , stacione matëse meteorologjike dhe të tjera të vogla që do të ishin të lehta për t'u mirëmbajtur etj.

### 6.2.3. Fondet dhe plani i financimit për zbatimin e planit të menaxhimit

Tabela e mëposhtme paraqet një vështrim të përgjithshëm të stafit të propozuar (në bazë të programeve, /nën-programeve dhe/veprimtarive të propozuara) dhe të pagave të tyre mujore, në bazë të supozimit që institucioni publik është i zhvilluar dhe është funksional:

Vështrim i përgjithshëm i shpenzimeve të rregullta operative:

Pozicionet në funksionet e rregullta	Vlera	Shpenzim i për njësi MKD	Shuma totale MKD / vit	Shpenzi met totale EUR /vit
Paga / anëtar i stafit x * muaj (900 EUR)	50	60,000	36,000,000	585,365
Hapësirëzyre (12m <sup>2</sup> ) për individ + PC + artikuj të ndryshëm. (300 EUR/muaj)	40	20,000	9,600,000	156,097
Automjete (600 EUR/muaj)	15	36,000	6,480,000	105,365
Uniforma + pajisje për roje pylli (30 EUR/muaj)	20	2,000	480,000	7,804
Shpenzime të tjera (3000 EUR/ muaj)	1	180,000	2,160,000	35,121
<b>Shuma totale / vit</b>			<b>54,720,000</b>	<b>889,752</b>

Vlerësimi i shpenzimeve për ekspertët e jashtëm:

Projekte me bashkëpunim të jashtëm	Nr. i Veprimtarive	Shpenzime t mesatare EUR/ vit	Shpenzimet tolale MKD / vit	Shpenzime totale EUR / vit
Projektetëprioritetit 1 me mbështetje të jashtme	35	15,000	32.287,500	525,000
Projekte të prioritetit 2 me mbështetje të jashtme	70	15,000	64.575,000	1,050,000
Projekte të prioritetit 3 me mbështetje të jashtme	25	15,000	23.062,500	375,000
<b>Shuma totale / vit</b>				<b>1,950,000</b>

Aktivitetet shtesë për të cilat nuk llogariten kosto, por që lidhen me detyrimet e parkut janë si më poshtë:

- shpenzimet për mirëmbajtjen e rrugëve lokale;
- mirëmbajtjen e shtigjeve malore etj. vende pikniku;
- kostot që lidhen me sigurinë e vizitorëve (ndërtimi i strehimoreve, mirëmbajtja e tyre dhe shpëtimi i vizitorëve);
- mbrojtjen dhe menaxhimin nga zjarri;
- menaxhimi i mbetjeve (veçanërisht mbetjet e ngurta në vendet më të vizituara turistike, vendosja e kontejnerëve me mbrojtje nga kafshët e egra).

Në mënyrë që të ofrojë akses adekuat për turistët dhe vizitorët në park, administratës shpesh do t'i duhet të përdorë një ekskavator për t'i pastruar ato. Gjithashtu, për mirëmbajtjen e shtigjeve të ecjes duhet kushtuar vëmendje blerjes së makinerive të rënda (traktor,

ekskavator etj.) ku do të kryheshin pastrime të rregullta, kositje, heqje bore etj. Nëse institucioni nuk ka makineritë e nevojshme të rënda, mund të merret me qira nëse është e nevojshme.

Infrastruktura ekzistuese e vizitorëve duhet të përmirësohet dhe mirëmbahet rregullisht. Ai përfshin strehë të ndryshme, kulla vrojtimi, stola, resorte etj., përgjatë shtigjeve malore dhe shtigjeve të çiklizmit si dhe vende të tjera për vizitorët.

Parku kombëtar duhet të ketë kufij të shënuar qartë dhe tabela informuese të vendosura në të gjitha pikat e hyrjes, një shpjegim të aktiviteteve të lejuara dhe të ndaluara sipas zonave si dhe një rrjet të shënuar shtigjesh për aktivitete të ndryshme.

Burimet të mundshme të financimit për funksionimin e Parkut Kombëtar:

- Fondet kombëtare (qeveria)
- Pagesat e shërbimeve të ekosistemeve: Tarifat e mbledhura nga përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore sipas Planit të menaxhimit si dhe tarifat nga subjektet që ofrojnë shërbime në territorin e PK (operatorët turistikë, hidrocentralet e vogla, linjat e rrymës elektrike, hotelet, operatorë turistikë, shërbimet e skive, etj.
- PONT
- Programi IPA i BE-së
- Programi ndërkufitar i BE-së
- GIZ
- GEF
- UNDP
- UNEP
- SIDA
- USAID
- Programi zviceran për bashkëpunim
- Donatorë të tjerë ndërkombëtarë
- Sponsorizimi nga sektori privat

### 6.3. Programi vjetor për mbrojtjen e natyrës

Programet vjetore duhet të përgatiten nga menaxhimi i Parkut Kombëtar.

### 6.4. Përgatitja e planit vijues të menaxhimit

Në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, pas periudhës së parë pesëvjeçare plani i menaxhimit do të rishikohet dhe rinovohet për periudhën vijuese.

## 7. Dokumentacioni / Shtojca

### 7.1. Pamjet në hartë në formatin GIS

### 7.2. Referencat

Melovski L., Jovanovska D. and Hristovski S. (2019): Landscape diversity in North Macedonia, Macedonian Journal of Ecology and Environment (<http://www.mjee.org.mk/>).

Strengthening the Capacities for implementation of Natura 2000 in Macedonia on central and local level (2016-2017). EU-IPA Project.

UNEP Regional Office in Vienna (2020): Valorization Study on Sharr Mountain.

Appleton, M.R. (2016). A Global Register of Competences for Protected Area Practitioners. Gland, Switzerland: IUCN

DEKONS-EMA Skopje. Socio-economic Study for the proposed protected area National Park Shar Mountains. 2020. Italian Ministry of Environment, land and sea project: "Support to the Western Balkan countries for the implementation of multilateral environmental agreements by strengthening the institutional framework and capacity building" and supported implementation through GEF/UNEP/MOEPP project "Achieving Biodiversity Conservation through Creation and Effective Management of Protected Areas and Mainstreaming Biodiversity into Land Use Planning".

UNEP Regional Office in Vienna. Shar Mountains Valorization Study, harmonized version. p. 688. 2020. GEF/UNEP/MOEPP project "Achieving Biodiversity Conservation through Creation and Effective Management of Protected Areas and Mainstreaming Biodiversity into Land Use Planning".

### 7.3. Lista e hidrocentraleve të vogla (statusi Janar 2021)

Dokument më vete: Shtojca 3 - 2020-12-20 Analiza e hidrocentraleve të vogla.pdf

### 7.4. Vlerësimi METT4

Dokument më vete: METT4MasterFile V4-1 PK Malet e Sharrit 2021-11-17.xlsm